# Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit

## Plani për menaxhim 2019-2028



**Shkup-Ohër-Strugë-Debërcë, 2019**

## Përmbajtja

1. Parathënie **Error! Bookmark not defined.**

2. Hyrje **Error! Bookmark not defined.**

2.1. Historiku i mbrojtjes së Rajonit të Ohrit ...................................... **Error! Bookmark not defined.**

2.2. Deklarata për vlerën e jashtëzakonshme universale .................... **Error! Bookmark not defined.**

2.3. Vlera e jashtëzakonshme universale............................................ **Error! Bookmark not defined.**

2.4. Kriteret për regjistrim të Rajonit të Ohrit në Listën e trashëgimisë botërore .... **Error! Bookmark not defined.**

2.5. Integriteti ...................................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

2.6. Autenticiteti .................................................................................. **Error! Bookmark not defined.**

2.7. Kufijtë e të mirës........................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

2.8. Zona e kontaktit ............................................................................ **Error! Bookmark not defined.**

2.8.1 Propozim kufijtë e zonës së kontaktit............................................ **Error! Bookmark not defined.**

2.8.1.1. Propozim 1: Kufiri i zonës së kontaktit i cili është identik me kufirin e zonës kalimtare të rezervatit të biosferës Ohër-Prespë.......................................................................................... 15

2.8.1.2. Propozim 2: Kufiri i zons së kontaktit që e përfshin Liqenin e Prespës ................................... 17

2.8.1.3. Propozim 3: Kufiri i zonës së kontaktit me theks kryesor në integritetin e Parkut Kombëtar Galiçica .......................................................................................................................... 18

3. Vlerat 19

3.1. Vlerat natyrore.............................................................................. **Error! Bookmark not defined.**

3.2. Vlerat kulturore............................................................................. **Error! Bookmark not defined.**

3.3. Vlerat shoqërore ........................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

3.4. Vlerat shkencore-arsimore ........................................................... **Error! Bookmark not defined.**

4. Metodologjia dhe procesi i përpunimit të Planit për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit **Error! Bookmark not defined.**

4.1. Nevoja për miratimin e Planit për menaxhim me trashëgiminë botërore ... **Error! Bookmark not defined.**

4.2. Metodologjia e përpunimit të Planit për menaxhim .................... **Error! Bookmark not defined.**

4.3. Procesi i përpunimit të Planit për menaxhim ............................................................................. 35

5. Menaxhimi me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit 37

5.1. Korniza strategjike ........................................................................................................................ 37

5.2. Korniza juridike ............................................................................................................................ 38

5.3. Korniza institucionale.................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

5.3.1. Pronësi ......................................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

5.4. Sistemi për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit .......... **Error! Bookmark not defined.**

5.4.1. Planifikimi dhe shfrytëzimi i tokës ................................................ **Error! Bookmark not defined.**

5.4.1.1. Planet hapësinore ................................................................ **Error! Bookmark not defined.**

5.4.1.2. Planet urbanistike ................................................................ **Error! Bookmark not defined.**

5.4.1.3. Institucionet kompetente për menaxhim me zhvillimin hapësinor dhe urbanistik në Rajonine Ohrit .................................................................................................................. 46

5.4.2. Menaxhimi me trashëgiminë natyrore ..................................................................... 47

5.4.3 Menaxhimi me trashëgiminë kulturore ........................................................................ 48

5.4.4 Komisioni për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit .............. 50

6. Rreziqet dhe vlerësimi i rrezikimit të vlerës së jashtëzakonshme universale **Error! Bookmark not defined.**

6.1. Rreziqet dhe rekomandimet e përcaktuara në Raportin e Misionit reaktiv të UNESKO-s ............. 52

6.2. Transformimi bregor dhe kërcënimet për lokalitetet me vlera natyrore ....................................... 53

6.3. Rreziqet sipas klasifikimit të Bashkimit Ndërkombëtar për mbrojtjen e natyrës (IUCN) dhe vlerësimi ndërkombëtar global i ujërave (GIWA) .................................... **Error! Bookmark not defined.**

6.3.1. Faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujërave në pellgun e Liqenit të Ohrit .................................... 58

6.4.1. Urbanizimi dhe objektet e ndërtuara pa leje ............................................................................. 64

6.5. Rreziqet tjera mbi ruajtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit ................................................................................................ 66

6.5.1. Objektet infrastrukturore ....................................................................................................... 67

6.5.2. Objektet e sapondërtuara në qendrat e vjetra të qytetit ............................................................ 74

7. Vizioni dhe qëllimet e mbrojtjes 76

7.1. Vizioni ........................................................................................................................... 76

7.2. Qëllimet ......................................................................................................................... 76

8. Zonimi dhe masat mbrojtëse në kufirin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit **Error! Bookmark not defined.**

8.1. Nevoja për vendosjen e zonave mbrojtëse në kuadër të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit ........................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

8.1.1. Cilësitë e vlerave si bazë për zonimin ............................................ **Error! Bookmark not defined.**

8.2. Funksionaliteti bregor i Liqenit të Ohrit si kriter për mbrojtjen më të rreptë ................................ 79

8.3. Kriteret për përcaktimin e kufijve të zonave të mbrojtura ................ **Error! Bookmark not defined.**

8.4. Masat e mbrojtjes në zonat e vendosura në kuadër të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit ........................................................................... **Error! Bookmark not defined.**

8.4.1. Masat e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore në Rajonin e Ohrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

8.4.2. Masat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Rajonin e Ohrit ................................................ 89

9. Plan veprimi 104

10. Implementimi i Planit për menaxhim dhe zbatim të masave dhe aktiviteteve për mbrojtje 104

11. Plani për monitorim 106

12. Plani për menaxhim me vizitorët 108

13. Programi për edukim 109

13.1 Edukimi i të rinjve........................................................................................................109
13.2 Ngritja e vetëdijes publike e grupeve tjera qëllimor....................................................................111
13.2.1 Trajnimi i shoqëruesve turistikë...............................................................................111
13.2.2 Trajnimi i nëpunësve administrativë dhe i të punësuarve në sektorin publik..........................111
13.2.3 Trajnimi i bujqve për prodhim të pranueshëm ekologjik ..................................................112
13.3 Mekanizmat për përfshirje të qytetarëve......................................................................113
13.3 Mekanizmat për ngritje të vetëdijes përmes mediave sociale ...........................................114
Shtojca 1: Vlerat natyrore 120
Shtojca 2: Vlerat kulturore 126
Bibliografia 131

**Përmbajtja dhe fotografitë:**

*fotografia 1 Vlera e jashtëzakonshme universale e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit* ..... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 2. Kufiri i të mirës tejkufitare me zonën e definuar të kontaktit në anën e Shqipërisë* ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 3. Rezervati i biosferës Ohër-Prespë* ........................................................ ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 4.Kufiri i zonës kalimtare të rezervatit të biosferës Ohër-Prespë, kufiri i zonës së mbrojtur dhe kufiri i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit* ............................................ ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 5.Kufiri i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit dhe propozimi për zonën e kontaktit që është më e vogël se zona e kontaktit të rezervatit të biosferës*.................................. ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 6.Kufiri i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit dhe propozim për zonën e kontaktit që është më e vogël se zona e kontaktit të rezervatit të biosferës Ohër-Strugë por nuk e përfshin Liqenin e Prespës* ........................................................................................................................ ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 7.Liqeni i Ohrit*............................................................................................ ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 8.Zona karstike e Galiçicës*........................................................................ ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 9.Burimet sublakostrike në Kalishtë* ......................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 10.Habitati i zambakut të verdhë në Kalishtë*............................................ ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 11.Brezi më i madh i kallamit në Podmolje*................................................. ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 12.Habitati i revitalizuar i zambakut të verdhë në Mazijal*......................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 13.Moçali i Studençishtes* ......................................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 14.Burimet sublakustrike në Veli Dab*..........................................................................................24
*fotografia 15.Burimet sublakustrike në Velja Pesh*...................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 16.Burimet sublakustrike Sveti Petar*......................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 17.Burimet te Shën Naumi* ......................................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 18.Lokalitete me vlera natyrore në Rajonin e Ohrit*.................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 19.Lokalitete me vlera kulturore në Rajonin e Ohrit*...................................................................27
*fotografia 20.Trashëgimia kulturore në qytetin e Ohrit sipas periudhës së krijimit* ...... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 21.Qendra e vjetër urbane e Ohrit*.............................................................. ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 22.Qyteti i Ohrit* ......................................................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 23.Trashëgimia kulturore në qytetin e Strugës sipas llojeve* ....................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 24.Qyteti i Strugës* ..................................................................................... ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 25. Harta e trashëgimisë kulturore në Rajonin e Ohrit-Prespës* .................. ***Error! Bookmark not defined.***
*fotografia 26. Muri i betonit në brezin Strugë-Kalishtë dhe shtëpiza e montueshme Radozhdë*...............................54

*fotografia 27.Deponimi i materialit ndërtimor në brezin e kallamit te Struga ....54*
*fotografia 28.Sipërfaqe të punueshme në brezin e kallamit para Rodozhdës ....55*
*fotografia 29.Lym i deponuar në rrjedhën e lumit Sateska dhe ndryshimet gjatë viteve (incizim me satelit nga Google Earth)....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 30. Shtiget ujore nga Liqeni i Prespës dhe ujërat e shiut që derdhen nga mali Galiçica në Liqenin e Ohrit (Popovska dhe Bonaçi 2007)....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 31. Shkalla e lidhshmërisë së rrjetit të kanalizimit me Sistemin e kolektorit (burim: Sutidmi për mbledhje të të dhënave për përmirësim të mjedisit jetësor të Liqenit të Ohrit dhe teknika për realizimin e sistemit të kolektorit, XHAJKA, viti 2015) ....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 32. Pamja e Liqenit të Ohrit kur niveli është nën nivelin e lejuar natyror minimal (majtas) dhe mbi nivelin e lejuar natyror maksimal (djathtas) ....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 33.Modelimi hidrologjik i vërshimit të ujërave sipërfaqësore....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 34.Modelimi hidrologjik i vërshimit nga ujërat nëntokësore (majtas) dhe vërshimit të bregut nga ardhja e Liqenit (djathtas)....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 35. Ndryshimi i shfrytëzimit të tokës (Burim: www.land.copernicus.eu/pan-european/corine-land-cover) ....66*
*fotografia 36.Ndikimi/rreziqet nga projektet e planifikuara infrastrukturore....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 37.Trasetë e analizuara të hekurudhës Kërçovë-Linë ....* **Error! Bookmark not defined.**
*fotografia 38. Trasetë e shqyrtuara alternative Trebenishtë-Strugë (burim: VNMJ për projektin) ....71*
*fotografia 39.Rreziqet potenciale për vlerat e jashtëzakonshme universale ....74*
*fotografia 40.Indeksi i bregut të Liqenit të Ohrit ....80*
*fotografia 41. Infrastruktura me turizmin (Shtrirja: 0 =asnjë deri në 1 = 100% përgjatë gjithë gjatësisë) (0,1 = korsi këmbësorësh; 0.2 = një hotel; 0,5 = korsi biçikletash pranë liqenit; 1 = plazhi ose infrastruktura turistike) ....81*
*fotografia 42.Dedikimi i shfrytëzimit të brezit të bregut të liqenit (0 deri në 50 metra nga bregu) ....82*
*fotografia 43.Zonat mbrojtëse në kufijtë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Liqenit të Ohrit ....85*
*fotografia 44.Zonat mbrojtëse (trashëgimia kulturore) ....101*
*fotografia 45. Zonat e mbrojtëse në Qendrëne vjetër të qytetit të Ohrit (trashëgimia kulturore) ....102*
*fotografia 46.Zonat mbrojtëse në Qendrën e vjetëre të qytetit në Strugë (trashëgimi kulturore) ....103*

## Përmbajtja e tabelave:

*Tabela 1. Plani hapësinor i RM-së: pasqyra e zonave të mbrojtura dhe të propozuara për mbrojtje në Rajonin e Ohrit....* **Error! Bookmark not defined.**
*Tabela 2. Planet hapësinore dhe urbanistike dhe institucionet kompetente për miratimin dhe realizimin e tyre në rajonin e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit. ....46*
*Tabela 3. Pasqyra e sistemit të menaxhimit me trashëgiminë natyrore në Rajonin e Ohrit ....46*
*Tabela 4. Pasqyra e sistemit të menaxhimit me trashëgiminë natyrore në Rajonine Ohrit ....* **Error! Bookmark not defined.**
*Tabela 5. Ndikimet/rreziqet, niveli i njohjes së shkaktarëve dhe përshkrimi i shkaktarëve....55*

***EKIPI I PUNËS:***

Për përpilimin e Planit për menaxhim me trashëgimin natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit u formuan Trupa koordinues dhe Grupe pune të cilat u inkuadruan në aktivitetet e përgjithshme në periudhën e përgatitjes së Planit:

**Koordinator i procesit të përgatitjes së Planit për menaxhim me trashëgiminë kulturore të Rajonit të Ohrit:**

**mr. Zoran Pavlov,** Udhëheqës i Sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar, dokumentacion dhe digjitalizim të trashëgimisë kulturore, Ministria e Kulturës - Drejtoria për mbrojtje të trashëgimisë kulturore;

**Grupi i punës/bashkëpunëtorë:**

- **Cvetanka Llaskova,** këshilltare e posaçme e kulturës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Zyra e Kryetarit të Qeverisë, **anëtare;**
- **mr– Kristina Biceva,** Këshilltare për koordinim të bashkëpunimit ndërkombëtar, Drejtoria për mbrojtje të trashëgimisë kulturore;
- **mr. Ana Aleksova,** Bashkëpunëtore e re për ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, Drejtoria për mbrojtje të trashëgimisë kulturore;
- **Tanja Buntasheska Paskali,** arkitekte, Enti dhe Muzeu - Ohër,
- **Goran Patçev,** arkitekt, Enti dhe Muzeu - Ohër,
- **Vesna Ilievska,** Këshilltare shtetërore për punë juridike, Ministria e Kulturës;

**Bashkëpunëtorë;**

- **Millço Georgievski,** Enti dhe Muzeu – Ohër;
- **Elena Koçkoska,** Enti dhe Muzeu – Ohër;
- **Goce Angeliçin,** Enti dhe Muzeu – Ohër;
- **dr. Boshko Angellovski,** Ministria e Kulturës;
- **Antonio Baleski,** komuna e Ohrit;

**Koordinator i procesit të përgatitjes së Planit për menaxhim me trashëgiminë kulturore të Rajonit të Ohrit:**

**Ana Petroska,** Sekretare shtetërore e mjedisit jetësor, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

**Grupi i punës/bashkëpunëtorë**

- **Dragan Jovanov,** këshilltar i posaçëm i mjedisit jetësor, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Zyra e Kryetarit të Qeverisë, anëtar;
- **mr. Vllatko Tërpeski,** Udhëheqës i sektorit natyra, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Valentina Çavdarova,** Udhëheqëse e seksionit për rregullim të hapësirës në zonat e mbrojtura dhe biodiversitet, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

- **Nebi Rexhepi,** Ndihmës udhëheqës sektori për planifikim hapësinor, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Dejan Gaxhovski,** Bashkëpunëtor i ri për realizim të planeve hapësinore rajonale, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Ilber Mirta,** Udhëheqës i sektorit për ujëra, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Lupka Zajkova,** Ndihmës udhëheqëse sektori për ujëra, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Melita Goçevska,** Udhëheqëse seksioni për koncesione dhe bashkëpunim ndërresorial, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Arijan Ganiji,** bashkëpunëtor i ri për leje, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, **anëtar;**
- **Shpresa Fetahu,** ndihmës udhëheqëse e sektorit për urbanizëm, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, **anëtare;**
- **Ana Gjorgjioska,** ndihmës udhëheqëse e sektorit për dokumentim dhe menaxhim me tokë ndërtimore, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, **anëtare;**

**Bashkëpunëtorë;**

- **Antonio Gavrillovki,** Komuna e Ohrit, **anëtar;**
- **Lile Jonoska,** Komuna e Ohrit, **anëtare;**
- **Branko Arnaudovski,** Komuna e Ohrit,
- **Vera Raunik,** Komuna e Ohrit, **anëtare;**
- **Dashmir Nasufi,** komuna e Steugës, **anëtar;**
- **Branko Arnaudovski,** Komuna e Ohrit,
- **Igor Martinoski,** komuna e Debërcës, anëtar;
- **Natmir Nexhipi,** Komuna e Strugës;
- **Gjorgji Dishlioski,** Komuna e Strugës.

Në përgatitjen e Planit, u përfshinë edhe konsultues nga Instituti Ndërtimor "Makedonija" SH.A. Shkup të cilët gjithashtu janë edhe përpilues të Strategjisë për vlerësim të mjedisit jetësor nga implementimi i Planit dhe atë:

- **Martina Blinkova Donçevska -** ekolog i diplomuar, ekspert i autorizuar i VSMJ-së,
- **mr. Suzana Kasovska Georgieva -** arkeolog i diplomuar dhe historian i artit.
- **Mario Batkovski –** arkitekt i diplomuar,
- **Ivica Arsov –** gjeolog i diplomuar – ekspert SIGJ.

Metodologjia për përgatitjen e Planit për menaxhim bazohet në standardet ndërkombëtare, e veçanërisht në Principet evropiane për mbrojtje të trashëgimisë së patundshme kulturore dhe Rekomandimet e UNESKO-s, IKROM-it dhe IKOMOS-it.

# 1. Parathënie

Konventa për mbrojtje të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore e UNESKO-s (Paris, 1972) është instrumenti më gjithëpërfshirës ndërkombëtar për mbrojtje të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Vendet anëtare, nënshkruese të Konventës për mbrojtje të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore, janë të obliguar të arrijnë standard më të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore të UNESKO-s.

Pasi të regjistrohet një rajon/lokalitet/përmendore në Listën e trashëgimisë botërore të UNESKO-s, nevojitet që të vendoset mekanizëm adekuat për menaxhim që do të vendosë balancë ndërmjet qëllimeve të mbrojtjes, zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve zhvillimore të të mirës së mbrojtur.

*"Udhëzuesi operativ për zbatim të Konventës për trashëgimi botërore"* e përcakton nevojën për përpunim të Planit për menaxhim për çdo rajon/lokalitet/monument të cilat janë regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore, me të cilën do të sigurohet mbrojtje e vlerës së jashtëzakonshme universale. Planet për menaxhim me instrumentin qendror të planit për mbrojtje, shfrytëzim, konservim dhe zhvillim të qëndrueshëm të të mirave, por edhe mbrojtje të autenticitetit dhe integritetit të tyre dhe bartje te gjeneratat e ardhshme.

***Plani për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit*** do të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së vlerës së jashtëzakonshme universale të rajonit. Ai përbën bazë për miratimin e vendimeve zhvillimore nga të gjitha palët e prekura me ç'rast sigurohet balanca ndërmjet mbrojtjes së të mirës dhe shfrytëzimit të saj.

Me qëllim për të siguruar sinergji ndërmjet Planeve kombëtare për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, gjatë përpunimit të Planit, është bërë një konsultim i gjerë me palët e prekura, ku u përfshinë institucionet dhe organizatat kompetente nga Shqipëria.

# 2. HYRJE

## 2.1 Historiku i mbrojtjes së Rajonit të Ohrit

Deri në vitin 1912 Liqeni i Ohrit ka qenë i mbrojtur me rregulla juridike të Perandorisë Otomane, e nga viti 1912 deri në vitin 1941 me rregulla juridike nga Mbretëria e Jugosllavisë. Aktvendimi i parë për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit pas Luftës së dytë botërore u miratua në vitin 1944 në mbledhjen e parë të KAÇKM-it. Me Aktvendim nr. 08-267 në vitin 1963, Enti republikan për mbrojtjen e monumenteve kulturore e shfuqizon aktvendimin paraprak dhe Liqenin e mbron në kategorinë monument natyror.

Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë në vitin 1977 miratoi Ligj për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, Prespës dhe Dojranit (“Gazeta zyrtare e RMV" nr. 45/77) me të cilin Liqeni i Ohrit u shpall si zonë e mbrojtur në kategorinë “Monument natyror", me sipërfaqe prej $200 km^2$.

Për shkak të vlerës së jashtëzakonshme dhe para së gjithash për shkak të përqendrimit të të mirave kulturore me Aktvendim nr. 07-57/1 nga 28.03.1968 Enti për mbrojtje të monumenteve kulturore – Ohër e mbron Qendrën e vjetër të qytetit të Ohrit si kompleks monumental me masa mbrojtëse.

## 2.2 Deklarata për vlerën e jashtëzakonshme universale[1]

Në Konferencën e përgjithshme në Paris (16 nëntor 1972) UNESKO e miratoi Konventën për mbrojtje të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore e cila parasheh ***identifikim, mbrojtje, konservim[2] dhe prezantim të të mirave kulturore dhe natyrore me “Vlerë të jashtëzakonshme universale”***[3].

Konventa për mbrojtje të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore definon dy lloje të ndryshme të trashëgimisë botërore: kulturore dhe natyrore. Të mirat e kombinuara, përkatësisht të përziera i përmbajnë elementet e të dyja llojeve të trashëgimisë.

Pas regjistrimit në Listën e trashëgimisë botërore, gjendjen me mbrojtjen e të mirave e ndjek Qendra për trashëgimi botërore të UNESKO-s me trupat e saj këshillëdhënëse - IKOMOS, IUCN dhe IKROM.

Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore u ratifikua nga ish-RSFJ në vitin 1974, ndërsa Republika e Maqedonisë e ratifikoi përmes sukcesionit në vitin 1997 (me vlefshmëri retroaktive nga viti 1991).

## 2.3 Vlera e jashtëzakonshme universale

***“Vlera e jashtëzakonshme universale”*** e trashëgimisë botërore e UNESKO-s bazohet në tre shtyllat vijuese:

1. Rajoni/lokaliteti/monumenti/ të përmbushë së paku një prej kritereve të përcaktuara me Udhëzuesin operativ për zbatim të Konventës për trashëgimi botërore;
2. Rajoni/lokaliteti/monumenti t’i përmbushë kushtet për autenticitetin dhe integritetin;
3. Zona/lokali/monumenti t’i përmbushë kushtet për mbrojtje të dhe menaxhim me trashëgiminë botërore;

[1] Deklarata për vlerën e jashtëzakonshme universale e miratuar në sesionin e 39-të të Komitetit për Trashëgimi Botërore të UNESKO-s (Bon, Gjermani 2015, Vendimi 39 COM 8E);

[2] Aktivitetet konservatore përfshijnë hulumtim, dokumentim, trajtim dhe ndërhyrje preventive me metoda shkencore.

[3] Vlera e jashtëzakonshme universale u atribuohet rajoneve që posedojnë vlera natyrore dhe kulturore të cilat i tejkalojnë kufijtë territoriale dhe për atë shkak janë të rëndësishme për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme të gjithë njerëzimit. Prandaj mbrojtja e vazhdueshme e këtij trashëgimi ka rëndësi më të lartë për gjithë komunitetin ndërkombëtar.

***Rajoni i Ohrit posedon vlerë të jashtëzakonshme universale si kombinim i dukurive natyrore me cilësinë dhe diversitetin e trashëgimisë kulturore – materiale dhe jomateriale (fotografia 1).***

## 2.4 Kriteret për regjistrim të Rajonit të Ohrit në Listën e trashëgimisë botërore

Me ***Udhëzuesin operativ për zbatimin e Konventës për trashëgiminë botërore***[4], mes tjerash, definohen kriteret sipas të cilave rajoni/lokaliteti/monumenti i caktuar, krahas autenticitetit dhe integritetit, duhet t'i përmbushë ato duke e theksuar vlerën e vet e jashtëzakonshme universale, si kusht që të regjistrohet në Listën e trashëgimisë botërore. Deri në vitin 2005 u vendosën gjatë kritere për trashëgiminë kulturore dhe katër kritere për trashëgiminë natyrore; pas vitit 2005 u vendosën dhjetë kritere, ndërsa rajoni/lokaliteti/monumenti i cili është nominuar për regjistrim në Listën e trashëgimisë botërore duhet të përmbushë së paku një kriter.

***Rajoni i Ohrit është regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore*** *për shkak të* ***vlerave natyrore në vitin 1979,*** (sipas kriterit (iii), përkatësisht tani ***kriteri (vii).*** Në rekomandimet nga vlerësimi i realizuar nga ana e IUCN[5] në vitin 1979 është cekur se regjistrimi në Listën e trashëgimisë botërore duhet të bazohet edhe në vlerat kulturore. Prandaj **në vitin 1980** është bërë zgjerim i nominimit me plotësim të ***kritereve për vlera kulturore (i), (iii) dhe (iv)*** dhe e mira është regjistruar me emrin *"Rajoni i Ohrit me aspektet e tij kulturore dhe historike dhe mjedisi i tij historik dhe natyror".*[6]

Duke e parë gjendjen me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në vitin 2005, u konstatua nevoja për revidim të kufirit rajonit dhe ndryshim i emrit me të cilin është regjistruar e mira në Listën e trashëgimisë botërore. Me propozim të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Kulturës emërtimi i ri i të mirës – **Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit** u pranua në sesionin e 30-të të Komitetit për trashëgimi botërore, në korrik 2006 në Villnus, Lituani (Vendimi 30 COM 8B.9). Në sesionin e 33-të të Komitetit për trashëgimi botërore të UNESKO-s (21-30 qershor 2009, Sevilja, Spanjë), e duke u nisur nga raportet e vlerësimit të IKOMOS dhe IUCN u pranua edhe modifikimi i propozuar i kufijve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit (Vendimi 33 COM 8B.40).

Rajoni i Ohrit paraqet edhe pjesë e **Rezervatit tejkufitar të biosferës Ohër-Prespë.** Nominimi i Ohrit-Prespës për rezervatin e biosferës u shqyrtua zyrtarisht në mbledhjen e Komitetit MAB të UNESKO-s në qershor 2014 dhe Komiteti solli vendim të njëzëshëm që rajoni i Ohrit-Prespës të shpallet si rezervat tejkufitar i biosferës[7].

Regjistrimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit (që e përfshin territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut) bazohet në katër prej dhjetë kritereve për regjistrim në Listën e trashëgimisë botërore:

- *Kriter (i): E mirë kulturore që paraqet kryevepër e frymës kreative të njeriut: qyteti i Ohrit është një ndër lagjet më të vjetra në Evropë.* Janë të pranishëm gjetje të ruajtura arkeologjike nga Periudha e Bronzit deri në Mesjetë, arkitektura fetare nga shekulli VII-XIX, si arkitekturë urbane autentike nga shekulli XVIII-XIX. Këto objekte dhe mbetje kanë vlera historike, arkitektonike, kulturore dhe artistike. Për shkak të përqendrimit të gjetjeve arkeologjike dhe strukturave urbane në qendrën e vjetër urbane të Ohrit, pranë bregut të Liqenit të Ohrit dhe në rrethinën e drejtpërdrejtë, u krijua një ansambël i jashtëzakonshëm dhe harmonik, që e bën këtë rajon me të vërtetë unik.

[4] https://whc.unesco.org/en/guidelines/

[5] Unioni ndërkombëtar për mbrojtjen e natyrës (International Union for Conservation of Nature (IUCN);

[6] Sesioni i 4-të i Komitetit për trashëgimi botërore – Paris 1980 (CONF 016 V.13);

[7] Sesioni i 26-të i Këshillit koordinues ndërkombëtar për programin MAB, Jonkoping-Suedi 2014 (SC-14/CONF.226/8/REV);

- *Kriteri (iii): të posedojë dëshmi të vetme ose së paku dëshmi të jashtëzakonshme për traditën kulturore të civilizimit të caktuar ekzistues ose të zhdukur: kjo trashëgimi botërore është dëshmi e Artit bizantin, që është paraqitur në më shumë se 2.500m$^2$* afreske prej 800 ikonash. Kisha Shën Sofje (shek. XI), Shën Mëria Peribleptos (shek. XIII) dhe Shën Gjon Kaneo (shek. XIV) prezantojnë nivel të lartë të arritjeve artistike në afresket dhe prezantimet teologjike të cilat janë përpunuar nga artistët vendorë dhe të huaj. Vlerat estetike të arkitekturës fetare, afresket dhe ikonat kanë kontribuar që ky rajon të bëhet qendër e rëndësishme fetare dhe kulturore nëpër shekujt.
- *Kriter (iv): të paraqesë shembull të jashtëzakonshëm të ndërtimit, ansambël teknologjik ose peizazh i cili i pasqyron epokat e rëndësishme të historisë së njeriut:* Në qytetin e Ohrit është themeluar Manastiri më i vjetër sllloven dhe Universiteti i parë slloven në Ballkan i cili ka kontribuar në zhvillimin dhe përhapjen e arsimit dhe kulturës në botën e vjetër sllovene. Qendra e vjetër e qytetit të Ohrit (emri antik i të cilit është Lihnidos) është kompleksi i vetëm i ruajtur autentik me zgjidhje arkitektonike të planit – forum, objekte publike, banesore dhe sakrale me infrastrukturën e nevojshme të cilat me strukturën e vet harmonike përputhen në vijën bregore dhe terrenit në rrethinë. Arti i krishterimit të hershëm nga shekulli IV deri në shekullin VI, me bazilika të gjera me dysheme të zbukuruara me mozaikë, me të cilin lidhet Arti bizantin (shek. IX-XIV), me numër të madh të objekteve të ruajtura fetare nga llojet e ndryshme, në pjesën e brendshme të pasuruar me zbukurime afreskesh, ikonash dhe mobile kishtare, paraqesin një karakteristikë të veçantë të periudhës së krijimit të tyre. Vend të veçantë në trashëgiminë e ndërtimtarisë së Ohrit zë arkitektura e vjetër e qytetit, veçanërisht për faktin që është ruajtur pamja tipike e shtëpisë orientale të qytetit nga shekulli XVIII dhe XIX që është zhvilluar në një variant origjinal, lokal. Hapësira e kufizuar për murosje ka diktuar edhe formim të rrugicave shumë të ngushta.
- Kriter (vii): përmban fenomene natyrore superlative ose vende me bukuri të veçantë natyrore dhe rëndësi estetike: Liqeni i Ohrit i cili daton nga periudha paraakullnajore është fenomen i jashtëzakonshëm natyror. Si rezultat i izolimit të tij gjeografik dhe aktivitetit të pandërprerë biologji, Liqeni i Ohrit është habitat i shumë llojeve endemike dhe relikte të florës dhe faunës të ujit të ëmbël. Në ujërat oligotrofike të liqenit jetojnë mbi 200 lloje endemike – flora dhe fauna bentonite, veçanërisht algat, diatometë, krimbat, kërmijtë dhe llojet tjera, si dhe 17 lloje endemike të peshqve. Në Rajonin e Ohrit, gjithashtu hasen 87 lloje të zogjve.

## 2.5 Integriteti

Edhe krahas ndryshimeve të bëra të vogla të kufirit në vitin 2009, nuk u përfshinë të gjitha elementet që e caktojnë vlerën e jashtëzakonshme universale të rajonit, sepse u mbrojtën vetëm dy e treta e Liqenit të Ohrit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe vetëm një pjesë e pellgut të liqenit.

Në shkurt 2018, Shqipëria e paraqiti dosjen dominuese për zgjerim të kufijve dhe regjistrim të pjesës së Rajonit të Ohrit që shtrihet në territorin e Shqipërisë në Listën e trashëgimisë botërore të UNESKO-s. Pjesa e Shqipërisë e Liqenit të Ohrit përfshin zona të rëndësishme siç janë vendi në gadishullin Linë dhe fshati Linë, vendi në pjesën veriore të Linit, ku gjenden lagje të lashta të Ilirëve, dhe burimet Drilon. Në korrik 2019 Komiteti për trashëgimi botërore i UNESKO-s e pranoi zgjerimin e kufijve të së mirës dhe territorit të Shqipërisë, me ç’rast është përmbushur një prej komponentëve kryesore të vlerës së jashtëzakonshme universale, e kjo është ruajtja e integritetit të liqenit më të vjetër dhe më të pasur me biodiversitet në Evropë (Vendimi 43COM 8B.9);

Kërcënimet kryesore për integritetin e të mirës janë zhvillimi i pakoordinuar urban, rritja e popullatës, trajtimi joadekuat i ujërave të zeza dhe mbeturinat e ngurta dhe presionet nga turizmi. Gjithashtu, cilësia e ujërave është e rrezikuar nga ndotja e shkaktuar nga komunikacioni.

Integriteti i të mirës ishte i cenuar deri diku kur disa shtëpi të ndërtuara në shekullin XIX u rrënuan që të prezantohen mbetjet e gërmuara të Teatrit romak. Kompaktësia e përgjithshme e të mirës, përkatësisht përputhja e objekteve në atë vend mund të cenohet lehtë nëse nuk kontrollohen objektet e reja në mënyrë adekuate.

## 2.6 Autenticiteti

Vazhdimësia e gjatë historike e këtij rajoni, e karakterizuar me këmbime kulturore ndërmjet lindjes dhe perëndimit, ka formuar identitet të veçantë në këtë territor të vogël.

Qyteti i Ohrit është relativisht mirë i ruajtur, megjithatë urbanizimi i pakontrolluar pasqyrohet negativisht mbi vlerat: forma e ansamblit monumental, bregu dhe rajoni. Këto vlera rrezikohen për shkak të ndikimeve potenciale nga projektet infrastrukturore dhe ndërhyrjet tjera në hapësirën.

Punë të rëndësishme të konservimit dhe rikonstruktimit të disa objekteve fetare janë realizuar pas vitit 1990 dhe të njëjtat janë hulumtuar dhe dokumentuar në mënyrë thelbësore. Megjithatë, mund të vërehet se disa prej këtyre aktiviteteve pasqyrohen negativisht në autenticitetin e të mirës. Ikonat dhe afresket të cilat ruhen në kishat janë në gjendje të mirë.

Disa objekte me dedikim për banim janë ridedikuar, është ndryshuar edhe brendësia e tyre që të përmirësohen kushtet jetësore. Gjatë rikonstruktimit të objekteve shpesh përdoren materiale burimore të cilat janë shfrytëzuar gjatë ndërtimit, por kohë pas kohe shfrytëzohen edhe materiale të reja, që paraqesin rrezik për autenticitetin e të mirës.

## 2.7 Kufiri i të mirës

Në dosjen dominuese nga viti 1976 nuk u definuan në mënyrë precize kufijtë e rajonit të mbrojtur. Për ato shkaqe në vitin 2009, duke e parë gjendjen reale, është bërë definim i ri i kufijve të rajonit të mbrojtur dhe e njëjta është pranuar nga Komiteti për trashëgiminë botërore në Sevile-Spanjë (Vendim 33 COM 8B.40).

Kufiri i "Trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit" në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut fillon nga kalimi kufitar te Shën Naumi dhe shtrihet në lindje dhe verilindje nëpër vijën kufitare ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë e gjer në shtyllën kufitare F 11/I. Që këtu kufiri kthehet në drejtim të veriut, duke u ngritur në lartësi mbidetare prej 1102 m në Galiçicën e Vjetër, prej ku ngrihet në lartësi më të madhe mbidetare, e pastaj lëshohet nëpër luginën që përfundon te vendi i quajtur Lipova Livada në lartësi mbidetare prej 1568m. Prej këtu kufiri kthehet në drejtim të lindjes dhe nëpër rrugën e asfaltuar shpie deri në vendin Plosi i Poshtëm, prej ku e ndërron drejtimin kah veriu duke u ngjitur në majën Tomoros – p.t. me kuotë 1673m. Kufiri e mban drejtime e njëjtë dhe shkon nëpër lartësinë Presekë – p.t. me kuotë 1633m, Tumba – p.t. me kuotë 1605m, Shagon – p.t. me kuotë 1622, Samar – kuotë 1657, Cërven Kamen - p.t. me kuotë 1660m, Garvanov Kamen, Samernicë - p.t. me kuotë 1346m, Bajçinov Rid - p.t. me kuotë 1380m, e pret rrugën Ohër-Resnjë dhe del në lartësinë Përçishtë - p.t. me kuotë1184 e pastaj në Stogovë - p.t. me kuotë 1327m dhe në Kalipadinje – kuotë 1372m. Prej këtu kufiri shtrihet në drejtim të veriut dhe lëshohet në pikën e lartësisë me kuotë 1268m, kalon përmes kodrës Nikotinev – kuotë 1131m, prej ku lëshohet te vendi Privja Voda – kuotë 899m. Këtu kufiri e ndryshon drejtimin dhe shtrihet në veriperëndim duke i ngjitur në kodrën Gradishte- p.t. me kuotë 1086m. Pastaj kufiri lëshohet dhe kalon përmes pjesëve jugore të Debërcës, pastaj përmes kodrës Gorica - p.t. me kuotë 877m, e pret Sateska Rekën, kalon përmes vendit Tumba e Epërme dhe kota 1270m, përmes lartësisë Kodra Mare - p.t. me kuotë 1436m dhe pikës së lartësisë me kuotë prej 1522m, lëshohet në vendin Grikovec, kalon përmes fshatit Toskë dhe del në pikën e lartësisë 971m. Këtu kufiri e ndryshon drejtimin kah jugu, e pret lumin

Drini i Zi, kalon përmes Suvo Pole, pastaj përmes p.t. 754 m dhe 714 m, e pret bregun Krasta e Poshtme, e pret rrugën f. Vranishtë – f. Oktisi, kalon nëpër pikën e lartësisë 752m dhe përmes pjesëve lindore të Sinje Bërdos, kalon përmes pikës së lartësisë 864m, e pret rrugën Strugë – f. Vishni, kalon përmes kuotës 1026m, pastaj përmes vendeve Bango dhe Conga, pikës së lartësisë 1164, pikave trigonometrike 1144 (Karalishtë), 1103 (Krasje) dhe 1179 dhe del në pikën kufitare Qafëthanë në kufirin Maqedoni-Shqipëri. Pastaj drejtimi i kufirit e ndërron drejtimin kah lindja dhe në gjatësi prej 2.2km shpie në bregun e Liqenit të Ohrit përgjatë kufirit me Republikën e Shqipërisë, e pastaj shtrihet nëpër Liqenin e Ohrit që të përfundojë në pikën kufitare te Shën Naum. **(Shtojcë –***Harta me kufij)*

Territori i cili e përfshin të mirën e mbrojtur – Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit në anën e Maqedonisë është 83,350 ha.

Duhet të theksohet se me zgjerimin tejkufitar të të mirës së mbrojtur që përfshin edhe pjesën e Shqipërisë të Liqenit të Ohrit është dhënë sipërfaqe prej 11,378.6 ha.

## 2.8 Zona e kontaktit

Në periudhën kur e mira ishte e regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore në vitin 1979/1980, e përfshin rajonin më të gjerë rreth Liqenit të Ohrit, por nuk u propozua zona e kontaktit. UNESKO rekomandon se çdo rajon/lokalitet/monument me rëndësi botërore duhet të ketë zonë kontakti rreth të mirës me qëllim mbrojtjen e tij më të mirë. Zona e kontaktit duhet të sigurojë mbrojtje plotësuese të vlerës së jashtëzakonshme universale, autenticitetit dhe integritetit të së mirës. Në zonën e kontaktit vendoset mbrojtje juridike komplementare që parasheh ndalime adekuate në lidhje me mënyrën e shfrytëzimit të tokës, urbanizimin dhe zhvillimin e projekteve infrastrukturore, për shkak të sigurimit të mbrojtjes plotësuese të së mirës[8].

Zona kontaktuese e përfshin mjedisin e drejtpërdrejtë të së Mirës, që t'i mbrojë pamjet nga dhe kah e mira e mbrojtur, ti reduktojë ndikimet e vlerës së saj të jashtëzakonshme universale, si dhe t'i përfshijë vendet të cilat janë funksionalisht të ndërlidhura me zonat e mbrojtura. Ajo përbën pjesë integrale e sistemit të cilin shtetet dhe institucionet e vendosin për shkak të mbrojtjes përkatëse dhe menaxhimit me të mirën e mbrojtur.

Nevoja për vendosjen e zonës së kontaktit u cek edhe në Raportin nga Misioni monitorues reaktiv (2017) me rekomandim që të pranohet edhe Liqeni i Prespës[9].

Gjatë përpilimit të Planit për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit u bënë analiza me qëllim përcaktimin e kufijve alternative të zonës së kontaktit. Njëkohësisht u shfrytëzuan drejtimet nga botimi i UNESKO-s ”Trashëgimia botërore dhe zonat e kontaktit” [10] të cilat i definojnë nevojën dhe rëndësinë nga vendosja e zonës së kontaktit.

Përcaktimi i zonës së kontaktit të rajoneve të mbrojtura është një koncept relativisht i ri në shkencën e mbrojtjes, dhe qasja mund të dallohet në masë të madhe për çdo lokacion.

### 2.8.1 Propozim kufij të zonës së kontaktit

Definimi i zonës së kontaktit për të mirën e mbrojtur, veçanërisht kur bëhet fjalë për të mirën tejkufitare me vlera të përziera (natyrore dhe kulturore) është tejet kompleks).

[8] UNESCO 2017 Operational Guidelines, 103-7;

[9] 20170628_Reactive_Monitoring_mission_report_Ohrid_region.pdf

[10] *"World Heritage and Buffer Zones", UNESCO 2009,* (http://whc.unesco.org/documents/publi_wh_papers_25.pdf)

Prandaj në Planin për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit janë shqyrtuar tre propozime për caktimin e kufirit të zonës së kontaktit dhe atë:

1. Kufiri i zonës së kontaktit i cili është identik me kufirin e **Rezervatit të biosferës tejkufitare Ohër-Prespë;**
2. Kufiri i zonës së kontaktit i cili e përfshin Liqenin e Prespës;
3. Kufiri i zonës së kontaktit ku theksi kryesor është vënë në integritetin e Parkut Kombëtar Galiçica.

Gjatë përcaktimit të kufijve të zonës së kontaktit janë ndjekur struktura lineare e terrenit, qoftë natyrore (relievi, rrjedhat ujore, sipërfaqet ujore etj) ose të krijuara (rrugë, kufi të parcelës kadastrale, kufi të rajonit me shfrytëzim të njëjtë ose të ngjashëm të tokës etj).

Propozim-kufijtë e shqyrtuara të zonës së kontaktit do të diskutohen përmes një procesi të gjerë këshillimor. Kufiri i definuar i zonës së kontaktit, pas pranimit nga ana e Komitetit për trashëgimi botëror (në procedurë të parashikuar me Udhëzuesin operativ për implementim të Konventës për trashëgimi botërore), do të përfshihet në dosjen nominuese. Kufiri i ri do të përshkruhet, do të shënohet në harta kadastrale, do të përcaktohet sipërfaqja e zonës së kontaktit, dedikimi i shfrytëzimit të tokës dhe karakteristikat tjera të zonës.

Duke e pasur parasysh faktin që në korrik 2019 pjesa e Liqenit të Ohrit që i përket Shqipërisë është regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore të UNESKO-s, gjatë shqyrtimit të alternativave për definim të zonës së kontaktit janë respektuar kufijtë e zonës tanimë të definuar nënën e Shqipërisë (fotografia 2).




*Fotografia 1. Kufijtë e të mirës tejkufitare me zonën e definuar të kontaktit në anën e Shqipërisë*

### 2.8.1.1. Propozimi 1: Kufiri i zonës së kontaktit e cila është identike me kufirin e zonës kalimtare të rezervatit të biosferës Ohër-Prespë

Rezervati tejkuftar i biosferës Ohër-Prespë është shpallur në vitin 2014 në sesionin e Komisionit Ndërkombëtar të UNESKO-s me propozim të Komisionit Bilateral të Liqenit të Ohrit dhe ministrave të mjedisit jetësor në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut. Rezervati i biosferës shtritet në territorin e komunave të Ohrit, Strugës, Resnjës, Manastirit, Debërcës, Veçanit, Korçës, Pogradecit, Bilshitit dhe Maliqit, Ceravës, Dardashit, Drenovës, Hiçishtit, Hudenishtit, Bilishtit-Qenderit, Libonikut, Liqenasit, Bullgarecit-Qenderit, Molajit, Pirgut, Buçimasit, Pojanit, Progrerit, Proptishtit, Rajçes, Trebinjes, Vioskopit dhe Vreshtashit.

Sipërfaqja e përgjithshme është 446,244.52 ha, nga të cilat zona qendrore është 14,339.25 ha dhe zona e kontaktit është 140,479.27 ha (fotografia 2).




*Fotografia 2. Rezervati i biosferës Ohër-Prespë*

Zona qendrore në Rezervatin e Biosferës Ohër-Prespë ka të bëjë me zonat rreptësisht të mbrojtura të përcaktuara në rajonet e mbrojtura – Parku Kombëtar Galiçica, Parku Kombëtar Pelister dhe Parku natyror Ezerani. Zona e kontaktit formohet në kufijtë e zonave për menaxhim aktiv dhe shfrytëzim të qëndrueshëm, ndërsa zona kalimtare është e kufizuar me kufij administrative të komunës së Ohrit, Strugës, Debarcës, Resnjës dhe Manastirit.




*Fotografia 3. Kufiri i zonës kalimtare e rezervatit të biosferës Ohër-Strugë, kufiri i zonës së mbrojtur dhe kufiri i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit*

Në kuadër të kufirit potencial të zonës së kontaktit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit që do të jetë identike me kufirin e zonës kalimtare të rezervatit të biosferës Ohër-Prespë, do të përfshihen Komuna e Resnjës dhe Institucioni Parku Kombëtar Pelister.

Ky zgjerim mund ta ndërlikojë modelin drejtues kompleks ekzistues që bazohet në procese të ndërlikuara të cilat i zbatojnë një numër i madh i institucioneve. Zona e përcaktuar e kontaktit e Trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit në territorin e Shqipërisë nuk i ndjek kufijtë e zonës kalimtare të përcaktuar me kufijtë në mënyrë plotësuese, zona e kontaktit e cila është e përcaktuar me nominimin e të mirës nga ana e Shqipërisë është më e vogël se zona kalimtare e përcaktuar me kufijtë e rezervatit të biosferës Ohër-Prespë (fotografia 3).

Për këto shkaqe, miratimi i kufijve të zonës së kontaktit që është identik me atë të parkut të biosferës Ohër-Prespë nuk është i pranueshëm.

### 2.8.1.2. Propozimi 2: Kufiri i zonës së kontaktit i cili e përfshin Liqenin e Prespës;

Me qëllim mbrojtjen plotësuese të së mirës (propozim i përfshirë në Raportin e Misionit monitorues reaktiv të UNESKO-s nga viti 2017) është propozuar kufiri i zonës kontaktuese që lëviz nëpër format natyrore të relievit, përfshin rajone që kanë dedikim të njëjtë ose të ngjashëm të shfrytëzimit që të përmirësohet funksionalizmi i rajonit. Ky kufi ndërlidhet me zonën kontaktuese të Liqenit të Ohrit nga ana e Shqipërisë.




*Fotografia 4. Kufiri i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit dhe propozim për zonën e kontaktit që është më e vogël se zona e kontaktit e rezervatit të biosferës Ohër-Prespë dhe e përfshin Liqenin e Prespës*

Me miratimin e këtij propozimi zona e kontaktit do të përfshihet Komuna e Resnjës gjë e cila mund ta ndërlikojë përsëri modelin drejtues kompleks ekzistues.

Në aspekt të mbrojtjes së nevojshme që duhet ta sigurojë zonën kontaktuese, ky propozim ka volitshmëri sepse me përfshirjen e Liqenit të Prespës njihet lidhshmëria e këtij trupi ujor me Liqenin e Ohrit. Prandaj kjo alternativë nuk do të refuzohet dhe do të shqyrtohet gjatë konsultimit publik me Propozimin 3.

### 2.8.1.3. Propozimi 3: Kufiri i zonës së kontaktit me theks kryesor në integritetin e Parkut Kombëtar Galiçica.

Ky kufi alternativ i zonës kontaktuese në pjesën e vet fillestare është pothuajse identike me alternativën e dytë, por në vend që ta përfshijë Liqenin e Prespës, ajo lëshohet në jug dhe lëviz nëpër kufirin lindor të Parkut Kombëtar Galiçica. Ky kufi, gjithashtu, ndërlidhet me zonën kontaktuese të Liqenit të Ohrit nga ana e Shqipërisë.




*Fotografia 5. Kufiri i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit dhe propozim për zonën e kontaktit që është më e vogël se zona e kontaktit e rezervatit të biosferës Ohër-Strugë por nuk e përfshin Liqenin e Prespës*

Kufiri lindor i Parkut Kombëtar Galiçica e ndjek vijën e bregut të Liqenit të Prespës. Gjithashtu, edhe krahas faktit që në zonën e kontaktit nuk është përfshirë liqeni, me përfshirjen e vijës së bregut në të cilin gjenden kavernat në strukturën karstike të malit Galiçica njihet lidhja hidrologjike ndërmjet Liqenit të Prespës dhe Ohrit.

Pranimi i këtij propozimi të zonës së kontaktit nuk e ndërlikon modelin drejtues kompleks ekzistues. Nga ana tjetër, formohen në mënyrë plotësuese kufijtë e të Mirës, sepse me zonën kontaktuese përfshihet gjithë sipërfaqja e Parkut Kombëtar Galiçica, kundruall kufirit aktual që përhapet në kreshtën e malit.

# 3 Vlerat

Liqeni i Ohrit është një prej liqeneve më të vjetra në Evropë, i rrethuar me rrugë dhe lagje të lashta të cilat mbijetojnë nëpër shekuj. Historia natyrore dhe kulturore në këtë vend të veçantë janë gërshetuar nëpër shekuj duke krijuar një trashëgimi të jashtëzakonshme me specifika të saj të cilat e përfshijnë në trashëgiminë botërore dhe si e tillë duhet të ruhet dhe të bartet te gjeneratat e ardhshme.

Rajoni i Liqenit të Ohrit

- Liqeni i Ohrit gjendet në lartësi mbidetare prej 683m;
- Është i rrethuar me kurora të larta malore në lindje dhe perëndim të cilat arrijnë lartësi mbidetare prej afro 2.250m;
- Ka thellësi maksimale prej 288,7 m dhe thellësi mesatare prej 155 m;
- Ky është një prej liqeneve me vëllim më të madh në Evropë; ka sipërfaqe ujore prej 358km2, nga të cilat afro dy e treta gjenden në Maqedoni dhe një e treta në Shqipëri;
- Sipërfaqja e pellgut të tij të drejtpërdrejtë është 1.129km, ndërsa sipërfaqja efektive e pellgut e përfshin edhe pellgun e Liqenit të Prespës për shkak të lidhjes nëntokësore nëpër karstin;
- Janë gjetur mbi 1.400 lloje autoktone, përfshirë edhe afro 300 lloje të cilat janë endemike për Liqenin e Ohrit;
- Qyteti i Ohrit është një prej lagjeve më të vjetra të njeriut në Evropë; paraqet arritje të rrallë arkitektonike dhe artistike dhe thesar të vlerave arkitektonike, arkeologjike, materiale dhe jomateriale;
- Qyteti i Strugës jeton në bregun e Liqenit të Ohrit dhe në brigjet e lumit Drini i Zi, i cili si fenomen natyror rrjedh nga Liqeni; ka gjetje arkeologjike nga periudha e neolitit, nga epoka e bronzit, periudha maqedonase-heleniste, romake, periudha e mesjetës së hershme;
- Lagjet bregore (Tërpejcë, Peshtan, Radozhdë dhe Kalishtë) dëshmojnë për traditën, arkitekturën rurale dhe paraqesin vend të jashtëzakonshëm kulturor në të cilin objektet janë në harmoni me morfologjinë e terrenit, vegjetacionin dhe pasqyrën ujore të liqenit.

## 3.1 Vlerat natyrore

Liqeni i Ohrit (fotografia 7) një kohë të gjatë njihet si fenomen natyror sipëror. Me historinë gjeologjike dhe biologjike prej 2-5 miliona vitesh, përmendet si liqeni më i vjetër natyror në Evropë dhe një prej liqeneve më të vjetra në botë. Pellgu i liqenit përmban biodiversitet të pasur dhe të rëndësishëm dhe numër të madh të llojeve endemike. Në aspektin shkencor ky ekosistem ujor është një ndër ekosistemet më të rëndësishme ujore, siç janë Liqeni i Bajkalit dhe Tanganjika.




Fotografia 6. *Liqeni i Ohrit*

Ky fenomen natyror sipëror karakterizohet me vlerën e jashtëzakonshme universale, si vijon:

- Me thellësi më të madhe mesatare prej 155m Liqeni i Ohrit është liqeni më i thellë jo vetëm në Gadishullin ballkanik por edhe në Evropë, ndërsa zë vendin e katërmbëdhjetë në botë për nga thellësia.
- Ky është mbetja e fundit nga rajoni i lashtë ujor në Kontinentin euroaziatik para Epokës së akullt dhe sipas historisë së vet gjeologjike dhe biologjike numërohet në mesin e liqeneve më të vjetra në Evropë.
- Ky është vend i jashtëzakonshëm i biodiversitetit me rëndësi globale. Me 212 lloje endemike të florës dhe faunës dhe sipërfaqe prej 358,2 km2, me siguri është liqeni me biodiversitet më të madh në botë, në kuptimin e llojeve të përfaqësuara endemike në njësi sipërfaqe. Fosilet e gjalla dhe llojet endemike janë zhvilluar si rezultat i vetëm i izolimit gjeografik dhe zhvillimit të pandërprerë të aktivitetit biologjik. Ky endemizëm i Liqenit të Ohrit përfshin kërmij, krimba, turbellaria, numër i madh i relikteve prej algave dhe diatomeve, sfungjerëve liqenorë, algave, peshqve si dhe 87 lloje zogjsh. Mbetje nga vegjetacioni gjithashtu janë të pranishëm në vegjetacionin e moçalit me prejardhje akullnajore, si shembull i vetëm i Gadishullit Ballkanik, si dhe në botën bimore ujore (p.sh. Algat silikate).
- Në mungesë të fazave kryesore të akullnajës në Pleistocenin, janë krijuar kushte për ekosisteme të caktuara (në veçanti ekosisteme të shpellës dhe ujore) dhe elementet e faunës që janë pjesë e këtyre ekosistemeve të mbijetojnë në periudha më të gjata. Grupet e lashta (llojet relikte të faunës), janë përhapur përmes procesit të evoluimit ku prej një lloji krijohen dy ose më shumë lloje (specie) të pavarura gjenetike që ka rezultuar në lloje të shumta endemike lokale.



*Fotografia 7 Rajoni karstik i Galiçicës*

Gjatë vlerësimit të hapësirës rëndësi të veçantë u është dhënë specifikave gjeomorfologjike dhe topografike, pamjeve, atraktivitetit të rajonit dhe specifikave të veçanta klimatike. Prej maleve vend qendror në rajon zë vargmali Galiçica me majën Magaro (2.275 m), ndërsa mali Jablanica paraqet kufi perëndimor të rajonit me disa maja mbi 2000 m. Diversiteti gjeografik i malit Galiçica është paraqitur me të gjitha llojet e formave të relievit që janë tipike për zonën karstike (fotografia 8).

- Liqeni i Ohrit, Parku kombëtar Galiçica dhe Liqeni i Prespës si kompleks paraqesin zonë me një biodiversitet shumë të pasur, shkallë të lartë të aspektit heterogjen dhe endemik, dhe në atë kuptim konsiderohet si lokacion me të vërtetë mbresëlënës në Evropë (Gaston & David, 1994)[11].
- Në Parkun kombëtar Galiçica janë zbuluar mbi 30 taksona bimore dhe ato paraqesin shenjë mbrojtëse të malit. Këtu janë të pranishëm edhe 19 taksona nga Lista e kuqe botërore e bimëve të prekura të IUCN që kanë status "raritet" (R-rare). Numri i përgjithshëm i taksave nga fauna deri më tani janë vërejtur në territorin e Parkut është mbi 3.150 ha, që paraqet një diversitat jashtëzakonisht të lartë në zonën prej vetëm 25.000 ha.

Në rajonin e Ohrit si trashëgimi botërore janë identifikuar më shumë lokalitete me vlera natyrore:

1. **Shën Mëria Kalishka –** burime sublakustrike



*Fotografi 8. Burime sublakustrike në Kalishtë*

2. **Kalishta –** habitat i vetëm natyror i zambakut të verdhë (*Nupharlutea*) në Liqenin e Ohrit;



*Fotografia 9. Habitati i zambakut të verdhë në Kalishtë*

3. **Podmole –** brez më i përhapur me kallam (*Phragmites australis*) në Liqenin e Ohrit, habitat natyror i llojeve të rrezikuara të zogjve dhe vend për lëshimin e vezëve të krapit;

[11] Gaston, K.J. & David, R. (1994). Hotspots across Europe. Biodiversity Letters, 2: 108 - 116.



*Fotografia 10. Brezi më i madh i kallamit në Podmole*

4. **Mazi –** habitat i revitalizuar natyror i zambakut të verdhë (*Nuphar lutea*), vend për lëshimin e vezëve të krapit dhe habitat dhe fole zogjësh;



*Fotografia 11. Habitat i revitalizuar i zambakut të verdhë në Mazijal*

5. **Moçali i Studençishtes –** vegjetacioni makrofitik dhe vend pllenim të krapit;



*Fotografia 12. Moçali i Studençishtes*

6. **Veli Dab –** burimet sublakustrine, vend pllenimi i troftës dhe biodiversiteti i faunës bentike;



*Fotografia 13. Burime sublakustrike në Veli Dab*

7. **Vela Pesh –** burimet sublakustrine, vend pllenimi i troftës dhe biodiversiteti i faunës bentike;



*Fotografia 15. Burime sublakustrike në Vela Pesh*

8. **Sveti Petar -** burime bregore dhe sublakustrike, vend për lëshim të vezëve të troftës dhe biodiversiteti i faunës bentike;



*Fotografia 15. Burime sublakustrike Sveti Petar*

9. **Burime të Shën Naumit –** burim më i pasur i Liqenit të Ohrit, vend për lëshim të vezëve të troftës dhe krapit të faunës bentike.



*Fotografia 16. Burimet te Shën Naumi*




*Fotografia 17. Lokalitetet me vlera natyrore në Rajonin e Ohrit*

## 3.2 Vlera kulturore

Kontinuiteti i gjatë historik i kësaj hapësire dhe këmbimi i kulturave ndërmjet lindjes dhe perëndimit ka formuar identitet të veçantë në këtë territor të vogël siç nuk ekziston në hapësirën më të gjerë të Ballkanit.




*Fotografia 18. Lokalitetet me vlera kulturore në Rajonin e Ohrit*

Arkitektura karakteristike e cila është e pasur me specifikat e saj të njohura dhe të vetme dhe realizimi i suksesshëm i njëjtësisë ndërmjet qyteteve, lagjeve, mjedisit natyror dhe liqenit e bëjnë këtë vis autentik, dhe si rrjedhojë edhe jashtëzakonisht i vlefshëm.

Duke i pasur parasysh vlerat e pasura kulturore-historike, arkitektonike, arkeologjike dhe etnologjike të cilat rajonit i japin karakter të veçantë, unik, reprezentativ, autenticitet, me ruajtjen e tyre, diversitetin

dhe karakterin e tyre integral, janë krijuar mundësi që rajoni të paraqesë të mirë me rëndësi më të lartë kombëtare me vlera universale për njerëzimin dhe historinë, kulturën, artin dhe shkencën e tij.

E mira e shënuar i përfshin qendrat historike të qytetit të Ohrit dhe Strugës me matricën e tyre arkitektonike-urbanistike, disa lagje bregore pranë Liqenit të Ohrit, mbi 250 lokalitete arkeologjike që përfshijnë periudhë prej mbi 5000 vite, qendrat shpirtërore të krishterimit të hershëm dhe manastiret, objektet nga periudha bizantine dhe otomane etj.

- Ohri si kompleks monumental, ka rëndësi shumë të madhe për shkak të kompleksitetit të mbeturinave të shumta arkeologjike, si dhe tërësisë së objekteve të veçanta të cilat i kanë karakteristikat e trashëgimisë kulturore me rëndësi të jashtëzakonshme. Si një prej lagjeve më të vjetra të njeriut në Evropë ai paraqet arritje të rrallë arkitektonike dhe artistike dhe thesar të vlerave arkitektonike, arkeologjike, materiale dhe jomateriale; Qyteti, i formuar në kushte natyrore-gjeografike, historike, etnosociale dhe estetike të jetesës dhe ekonomizimit, në periudhën e kaluar, është ngritur dhe zhvilluar në një harmoni karakteristike, pa tendenca të uzurpimit të hapësirës dhe pamjeve.
- Qendra urbane e Ohrit përfshin objekte dhe struktura tjera që datojnë nga parahistoria, antika dhe antika e vjetër, periudha e krishterimit të hershëm, mesjeta e hershme, periudha otomane, e gjer më sot. I ndërtuar kryesisht ndërmjet shekullit VII dhe XIX, Ohri është me seli në manastirin më të vjetër slloven (Shën Pantelejmon) dhe shtëpi e më shumë se 800 ikonave me famë botërore me stil bizantin të pikturuara ndërmjet shekullit XI dhe XIV. Arkitektura e Ohrit është koleksion më mirë i ruajtur dhe më i kompletuar i arkitekturës urbane nga kjo pjesë e Evropës. Kultura sllovene është përhapur nga Ohri kah pjesët tjera të Evropës. Në qytetin e Ohrit gjendet një prej manastireve më të vjetra, i themeluar nga Shën Kliment i Ohrit në shekullin IX (konsiderohet si “Universiteti” i parë në Ballkan), i cili e ka përhapur shkrim-leximin, arsimin dhe kulturën nëpër gjithë botën e lashtë sllovene. Me hulumtimet arkeologjike deri tani janë zbuluar shtatë bazilika në pjesën e vjetër të Ohrit, që datojnë nga periudha ndërmjet shekullit IV dhe fillimit të shekullit VI dhe përmbajnë tipare arkitektonike dhe dekorative të cilat padyshim tregojnë zhvillimin e fuqishëm dhe famën e lartë të Ohrit antik (Lihnidos). Struktura e qendrës së qytetit është e pasur me numër të madh të lokaliteteve arkeologjike, me theks në bazilikat e krishterimit të hershëm, që kanë dysheme të shumta me të dekoruara me mozaikë.




*Fotografia 19. Trashëgimia kulturore në qytetin e Ohrit sipas periudhës së krijimit*

Si reprezentë më të dalluar me vlerat ekitektonike-urbanistike dhe qendrat shpirtërore veçohen qendrat e vjetra urbane të Ohrit dhe Strugës, kompleksi i manastirit Shën Arhangel Mihaill (Shën Naumi) pjesa jugore e bregut të Ohrit, kompleksi i manastirit Shën Mëria-Zaum, në f. Tërpejcë, kompleksi i manastirit Shën Mëria- Kalishtë në bregun perëndimor të Liqenit të Ohrit dhe Shën Jovan Bogosllov – Kaneo.




*Fotografia 20. Qendra e vjetër urbane e Ohrit Fotografia 21. Qyteti i Ohrit*

- Qyteti i Strugës: megjithëse gjendet përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit, jeta e tij është e përqendruar në brigjet e lumit Drini i Zi, i cili është fenomen natyror i Liqenit. Krijimi i Strugës është i lidhur me lagjet përreth pranë Liqenit të Ohrit. Lokalitetet arkeologjike dëshmojnë për ekzistimin e gjetjeve nga periudha e neolitit, e bronzit, periudha maqedonase-heleniste, romake dhe periudha e mesjetës së hershme. Rëndësinë e Strugës e vërtetojnë



edhe reprezentët e arkitekturës së qytetit të cilat dallohen me vlerat e tyre ambientale, estetike dhe ndërtimore.




*Fotografia 22. Trashëgimia kulturore në qytetin e Strugës sipas llojeve*

- 
- Sipas karakteristikave të relievit komuna e e **Debërcës** numërohet në mesin e komunave kodrinore-malore dhe një pjesë e territorit të saj bën pjesë në kufirin për trashëgimi të mbrojtur natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit. Përqendrimi i lokaliteteve arkeologjike me gjetje të rëndësishme arkeologjike e pasqyrojnë rëndësinë të cilën ky territor e ka pasur në të kaluarën por edhe kontributin në kompletimin e fotografisë për vlerë universale autentike të rajonit. Lokalitetet e konstatuara arkeologjike në teritorin e komunës së Debërcës u përkasin periudhave të ndryshme kohore, nga të cilat do t'i veçojmë: Nekropoli Trebenishkë, Gorenci, shekulli 8-4 p.e.s. (i njohur për nga materiali i pasur arkeologjik –maska të zbuluara prej ari të të vdekurit), Kalaja e Trebenishtës (periudhë antike), Zlla strana, Sredoreçje e epërme (neolit), Kutlinë, Velmej (neolit deri në shekullin e 6-të), Suva Çeshmë, Tri Çeusti dhe Vërtullka, Gorenci (shekulli 8-4 p.e.s), Çerepec, Godivje, shpella Jaorec, Vellmej (gjurma të konstatuara nga komunitete të lashta). Trashëgimia fetare (kisha Si Sveti në f. Leshan nga shekulli 14) dhe disa objekte ekonomike (mulliri në f. Leshan) janë vetëm një pjesë e trashëgimisë së pasur të cilën e posedon ky rajon





*Fotografia 24. Kisha Shën Mëria, f. Zlesti dhe kisha Si Cveti, f. Leshan*

Lagjet bregore (Tërpejcë, Peshtan, Radozhdë dhe Kalishtë):

- *Tërpejca:* me shekuj popullata është marrë me peshkim si burim kryesor të ardhurave. Rol të rëndësishëm ka edhe blegtoria, ndërsa bujqësia është e kufizuar në sipërfaqe të vogël të punueshme me fushën e thatë të Tërpejcës. Fshati ka 370 banorë. Në afërsi të fshatit gjendet kisha më e vjetur e ruajtur Shën Mëria-Zaum nga shekulli XIV.
- *Peshtani:* banorët e këtij vendi janë marrë gjithmonë me peshkatari dhe blegtori, por dekadat e fundit janë fokusuar në zhvillimin e turizmit me veprimtari shërbimi të zhvilluara mirë siç janë tregtia dhe hoteleria. Kjo ka bërë që amvisëritë e vjetra fshatareske të riadaptohen në objekte moderne për nevojat e turizmit dhe hotelerisë dhe paraqesin mjedise të revitalizuara rurale.
- *Radozhda:* paraqet fshat tipik i peshkatarisë, që gjendet në rrafshinën pranë pjesën veriperëndimore të bregut liqenor e cila gradualisht shndërrohet në lagje rurale turistike, me mundësi ideale për zhvillim të turizmit fshataresk. Fshati transformohet gradualisht në një lagje turistike moderne me zhvillim të veprimtarisë së shërbimit: tregtia, hoteleria dhe turizmi. Mbi fshatin gjendet kisha shpellore Ahangell Mihaill me pikturë të vlefshëm të ruajtur.

- *Kalishta:* është fshat tipik që merret me peshkatari, vitet e fundit gjithnjë e më shumë ndërtohen objekte të vogla hotelerie dhe zhvillohet hoteleria dhe turizmi. Në afërsi të drejtpërdrejtë të fshatit gjendet kompleksi i manastirit Shën Mëria me tempullin shpellor Rozhdestvo të Shën Mërisë. Kisha dhe konakët janë ndërtuar në një kohë më të re dhe janë aktivë edhe në ditët e sotme.

## 3.3 Vlerat shoqërore

Vlerat shoqërore të Rajonit të Ohrit janë lidhur me aktivitete shoqërore tradicionale dhe me shfrytëzimin e tij modern, që e përfshin edhe kujdesin dhe vetëdijen e lartë për mjedisin, duke e nxitur procesin e mbrojtjes dhe avancimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Ato kanë rol të rëndësishëm në vendosjen e identitetit shoqëror dhe kulturor, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar. Këto vlera janë krijuar nga vetë trashëgimia kulturore dhe natyrore dhe nga proceset e mbrojtjes së tyre. Harmonizimi ndërmjet mbrojtjes dhe menaxhimit të mirë me Rajonin e Ohrit, janë garanci për zhvillimin e qëndrueshëm.

## 3.4 Vlerat shkencore-arsimore

Ekzistimi i gjatë civilizues i qytetit të Ohrit nëpër shekuj si qendër shpirtërore dhe kulturore ka lënë gjurmë të veçantë edhe në veprimtarinë arsimore me formimin e "universitetit" të parë sllav, përkatësisht me veprimin e shkollës së njohur të letërsisë të Ohrit (Universiteti i Shën Klimentit).

Fondi i pasur i dorëshkrimeve kishtare greke dhe sllave i shpërndarë nga qyteti për shkaqe të ndryshme, gjatë shekullit XVIII, XIX dhe gjysma e parë e shekullit XX e kanë varfëruar seriozisht përmbledhjen e dorëshkrimeve, por megjithatë qyteti posedon një fond të pasur të dorëshkrimeve dhe kopjeve të monumenteve të vjetra të epigrafisë sllave.

Me rënien fuqisë së Perandorisë Otomane, në skenën shoqërore është paraqitur periudha e rilindjes dhe koha e zgjimit kombëtar, si element i kuptimeve të reja evropiane për konceptin e shteteve kombëtare. Vlerat arsimore të Ohrit të shikuara në prizëm e veprave të më shumë intelektualëve dhe krijimtarive në këtë periudhë gjithashtu konsiderohen si pjesë e vlerave shkencore-arsimore të rajonit. Në të kaluarën e Ohrit dinjitarët e mëdhenj të kishës që kanë ardhur nga qendrat e mëdha krishtere si Kostandinopoja ose Thesalia gjithmonë e kanë pasur rolin dominues në proceset lokale për formimin e vlerave shoqërore, arsimore dhe shpirtërore të qytetit. Në këtë kategori hyjnë edhe veprat e tyre kishtare.

Vlerat e cekura të Rajonit të Ohrit ai ka potencial jashtëzakonisht të madh për t'i hulumtuar në sferën e shkencave natyrore, historisë, arkeologjisë, arkitekturës, etnologjisë dhe historisë së artit.

ELHAM

# 4. Metodologjia dhe procesi i përpilimit të Planit për menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit

## 4.1 Nevoja e miratimit të Planit për menaxhimin e trashëgimisë botërore

Qëllimi kryesor i menaxhimit është të sigurohet mbrojtje efikase e të mirave për gjenerata e tashme dhe të ardhshme. Megjithatë, menaxhimi si proces në vete përmban edhe shumë gjëra të tjera: ai është mekanizëm përmes së cilit përpiqemi ta kuptojmë historinë e të mirave dhe përdorimin e tyre dhe vlerave për të tashmen dhe të ardhmen. Menaxhimi i bazuar mbi vlerat e të mirave është parim thelbësor, ndërsa konsultimet, diskutimet dhe ndërtimi i konsensusit, të arritura gjatë procesit të përgatitjes së Planit, do të luajnë rol kryesor në menaxhimin e ardhshëm të suksesshëm me trashëgiminë botërore

Vendet nënshkruese të Konventës për Mbrojtje të Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore (neni 4 i Konventës) janë të obliguara ta garantojnë identifikimin, mbrojtjen, konservimin, avancimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në territorin e vetë, por edhe ta ruajnë origjinalitetin, integritetin dhe vlerën e jashtëzakonshme universale por edhe ta bartin tek gjeneratat që vijnë. Komiteti i Trashëgimisë Botërore i UNESKO-s jep rekomandim të fuqishëm deri te vendet nënshkruese të formojnë korniza për avancim dhe mbrojtje përkatëse ligjore e cila do të sigurojë mbrojtje afatgjate të lokaliteteve të trashëgimisë botërore. Në këtë drejtim Udhëheqësi Operativ për Zbatimin e Konventës e thekson rëndësinë e Planit për Menaxhim si mjet efikas për arritjen e këtyre përpjekjeve. Plani për Menaxhim do t'i mundësojë rajonit të Ohrit të lëviz përpara, duke u mbështetur në vlerat e tij esenciale si rajon i rëndësishëm ndërkombëtar për trashëgiminë.

Ajo është e mundur përmes planifikimit përkatës, zbatimin e masave përkatëse dhe monitorimin e realizimit të tyre. Plani për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit është hapi i parë drejt politikës mirë të menduar për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe promovim adekuat të rëndësisë botërore të rajonit të Ohrit.

Nevoja e Planit për Menaxhim rrjedh jo vetëm nga udhëzimet ndërkombëtare, por edhe nga dispozitat e ligjvënësit nacional i cili ofron zgjidhje për menaxhimin e gjendjes reale të vetë rajonit.[12]

## 4.2 Metodologjia e përpilimit të Planit për Menaxhim

Metodologjia e përpilimit të Planit për Menaxhim e rajonit të Ohrit bazohet në rekomandimet e UNESCO-s, IKOMOS dhe IUCN, si dhe në përputhje me *Drejtimet për menaxhim me lokalitetet e trashëgimisë kulturore botërore* (Bernard M. Filden, Juka Jokileto, 1998)- publikim të përbashkët në IKROM, IKOMOS dhe UNESCO dhe Plane për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore – *udhëheqës praktik* (Brigita Ringbek, 2008) – publikim i Komisionit gjerman për UNESCO-n, por edhe përvojat pozitive nga vendet e tjera gjatë përpilimit të Planit për Menaxhim. Plani për Menaxhim ika parasysh edhe dokumentet tjera siç janë Deklarata e Budapestit për trashëgimi kulturore nga seanca e 26 e Komitetit të Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s e vitit 2002.

[12] Ligji për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Kulturore dhe Natyrore në Rajonin e Ohrit (Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 75/10);

(CONF 202 9)[13] dhe Karta e Stuhisë për mbrojtjen e vendeve me kuptim kulturor (IKOMOS Australi, 1979, e rishikuar më 2013)[14] etj.

Gjatë përpilimit të Planit për Menaxhim me rajonin e Ohrit janë shfrytëzuar të dhëna të shënuara në dokumente strategjike nacionale, analiza dhe raporte, informacione dhe njësi përkatëse bibliografike për trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit të Ohrit.

Udhëheqësi operativ për implementimin e Konventës së Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s, i miratuar nga ana e Komitetit për Trashëgimi Botërore jep rekomandim të fuqishëm për vendet nënshkruese të formojnë kornizë për avancim dhe mbrojtje përkatëse juridike e cila do të sigurojë mbrojtje afatgjate dhe të mirat që janë trashëgimi botërore. Udhëheqësi operativ e thekson rëndësinë e Planit për Menaxhim si mjet efektiv për arritjen e këtyre përpjekjeve dhe më pas i jep drejtimet vijuese:

1. Duke pasur parasysh se çdo zonë/ lokalitet/ monument ka specifikat dhe dallimet e veta, elementet e përgjithshme që duhet të ruhen me qëllim vendosjen e sistemit efikas për menaxhim me trashëgiminë botërore janë këto:
   - Zbatimi i planifikimit pjesëmarrës dhe proces konsultues me qëllim njohjen e të gjithë faktorëve me rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë;
   - Ndjekje të ciklit-planifikimit standard, zbatim, monitorim, vlerësim të suksesit të zbatimit të planit dhe rishikimin e tij;
   - Vlerësimi i ndjeshmërisë së trashëgimisë në lidhje me presionet dhe ndryshimet sociale, ekonomike, përfshirë monitorimin e ndikimeve, respektivisht trendët e investimeve të propozuara;
   - Zhvillimi i mekanizmave për koordinim të aktiviteteve të ndërmarra nga ana e palëve të ndryshme të interesuara dhe aktorëve;
   - Alokimi i resurseve të nevojshme;
   - Ndërtimi i kapaciteteve dhe ngritja e vetëdijes dhe;
   - Përshkrim transparent dhe llogaridhënës të funksionimit të sistemit për menaxhim me trashëgiminë botërore;

2. Komiteti rekomandon që vendet anëtare të Konventës t'i përfshijnë edhe aspektet e përgatitjes për rreziqet në planet për menaxhimin me trashëgiminë botërore dhe në planet për trajnim.

## 4.3 Procesi i përpilimit të Planit për Menaxhim

Në vitin 2007 u formua komision ndërresor dhe profesional i cili ka punuar në revidimin e kufijve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit. Njëherazi, u formua edhe grup punues për fillimin e procedurës për përgatitje të Ligjit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore Botërore në Rajonin e Ohrit.

Procesi i përpilimit të Planit që fillon kah fundi i vitit 2018, bazohet në konceptin e punës ekipore dhe qasjes interdisciplinare, që nënkupton udhëheqje të sinkronizuar të disa procedurave hetimore nga ana e një ekipi punues të përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme, në bazë të platformës së përbashkët metodologjike, qëllime që duhen të realizohen dhe koordinimeve të vetme.

---

[13] *Budapest Declaration on World Heritage*, Budapest, Hungari 2002 (https://whc.unesco.org/en/decisions/1217/);

[14] The *Australia ICOMOS Charter for Places of Cultural Significance, The Burra Charter, 2013* (Burra Charter);

Nga 13-16 dhjetori 2009 në Ohër, në organizim të Zyrës së UNESCO-s në Veneci, u mbajt seminar në temë "Implementimi i Planit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit", në të cilin u përcaktuan udhëzime për përpilimin e Planit Veprues si pjesë e rëndësishme e përgatitjes së Planit për Menaxhim.

Procesi i përpilimit të Planit për Menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit zgjati dhjetëra vite. Në vitin 2009, pas pranimit të Informatës për përgatitje të Planit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit nga ana e Qeverisë së RM-së (përfundime nga seanca e 48, nr. 19-3428/1 të datës 08.07.2009), draft-versioni i parë i Planit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit u dorëzua për shqyrtim në Qendrën për Trashëgimi Botërore të UNESCO-s (viti 2010). Pas rekomandimeve dhe vërejtjeve të marra nga trupat këshillues, (IUCN dhe IKOMOS), u ndërmorën hapa drejt revizionit të Draft-Planit për menaxhim. Në vitin 2015 është përpiluar Plan i reviduar për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në rajonin e Ohrit (viti 2016-2025)

Në sesionin e 40 të Komitetit për Trashëgimi Botërore të UNESCO-s (Stamboll, Turqi – viti 2016) duke shqyrtuar brishtësinë e trashëgimisë, u soll Vendim (40COM 7B.68) me të cilin rekomandohet që të zbatohet një Mision monitorues reaktiv nga ana e Qendrës për Trashëgimi Botërore dhe trupave këshillues IUCN dhe IKOMOS. Qëllimi i misionit ishte që të bëhet vlerësimi i gjendjes për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si dhe të sigurohet ndihmë rreth inicimit të përpilimit të Vlerësimit Strategjik të Ambientit Jetësor (VSAJ) të Draft-Planit për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit. Me VSAJ do të vlerësoheshin ndikimet e veçanta dhe kumulative nga urbanizimi dhe zbatimi i projekteve të planifikuara nga fusha e turizmit, infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore mbi vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit.

Nevoja nga revidimi i Draft-Planit ekzistues për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit 2016-2025 është nënvizuar edhe në Raportin e Misionit Monitorues Reaktiv (të zbatuar nga 9 deri më 14 prill 2017).

Ky Plan për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit, që ka të bëjë vetëm me pjesën e të mirave të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazohet në versionin e vitit 2017 dhe njëkohësisht i përfshin komentet dhe rekomandimet nga Raporti i Misionit Monitorues Reaktiv të vitit 2017. Njëherazi, për përpilimin e Planit në vitin 2019, nga ana e Qeverisë është nominuar një grup punues që përfshinë ekspert nga institucionet kompetente kyçe në nivel kombëtar dhe lokal.

Draft-Plani për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit është rezultat i pjesëmarrjes aktive të një numri të madh të palëve të interesuara dhe i njëjti do të jetë objekt i konsultimit të mëtutjeshëm gjithëpërfshirës me publikun që do t'i përfshinte edhe përfaqësuesit nga Shqipëria, duke pasur parasysh nevojën për bashkëpunim ndërkufitar në lidhje me zbatimin e masave mbrojtëse të integruara në rajonin e Ohrit. Teksti përfundimtar i Planit do t'i integrojë kontributet thelbësore që do të arrihen në periudhën 60 ditëshe në të cilën publiku do të ketë mundësi të jep komente.

# 5. Menaxhimi me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit

Qëllimi kryesor i menaxhimit me trashëgiminë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit është vendosja e një baraspeshe ndërmjet mbrojtjes së vlerave të jashtëzakonshme universale, menaxhimit të resurseve natyrore, zhvillimit social dhe rritjes ekonomike në suaza të të mirave të mbrojtura. Menaxhimi i suksesshëm me trashëgiminë botërore duhet të bazohet në të kuptuarit e tërësishëm të të mirave.

## 5.1. Korniza strategjike

Të mirat menaxhohen dhe mbrohen në bazë të një sërë dokumentesh dhe planesh relevante strategjike.

Për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit relevante janë dokumentet vijuese strategjike dhe planore:

- Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë (2004-2020)
- Plani hapësinor për rajonin e Ohrit-Prespës (2005-2020)
- Strategjia për llojllojshmëri biologjike të Republikës së Maqedonisë me Planin veprues;
- Plan për menaxhim me Parkun Kombëtar Galiçicë (2010-2020).
- Strategjia kombëtare për zhvillim të kulturës në Republikën e Maqedonisë (2018-2022);
- Strategjia për menaxhim me mbeturinat në Republikën e Maqedonisë (2008-2020);
- Draft strategjia për bujqësinë dhe zhvillimin rural (2015-2020);
- Strategji kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë (2009-2030);
- Strategjia për zhvillim rajonal në Republikën e Maqedonisë (2009-2019);
- Strategjia për kulturë në komunën e Strugës (2017-2022);

Në nivel lokal, dokumentet e miratuara relevante të Planit për Menaxhim janë:

- Strategji e reviduar dhe Plan Veprues për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe ekonomik në komunën e Ohrit (2013-2014);
- Plan strategjik për zhvillim në komunën e Strugës 2007-2011;

Rrjedhimisht përgatiten këto dokumente strategjike planifikuese:

1. Plan për menaxhim me pellgun e Liqenit të Ohrit (drafti i këtij plani parashikohet të jetë gati në dhjetor të vitit 2019);
2. Plan lokal veprues për mjedisin jetësor (PLEV) për komunën e Ohrit (i filluar, me afat të planifikuar për mbarim në muajin shtator të vitit 2019);
3. Strategji për zhvillim të qëndrueshëm të turizimit në rajonin e Ohrit (në procedurë është procedura e tenderimit);
4. Studim të trafikut për qytetin e Ohrit (i filluar, me afat të planifikuar për mbarim në muajin janar të vitit 2020);
5. Studim për valorizim të Moçalit Studençishko (i filluar, me afat të planifikuar për mbarim në muajin shtator të vitit 2019);
6. Draft-Plan lokal veprues dhe ekologjik (PLEV) për komunën e Debërcës (2019-2026)
7. Strategji nacionale për mbtotje dhe shfrytëzim të trashëgimisë kulturore (2020-2025);

Dispozitat e Planit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në rajonin e Ohrit i respektojnë dhe plotësisht janë të harmonizuara me drejtimet dhe rekomandimet të theksuara në dokumentet

planifikuese strategjike të lartëpërmedura. Pas miratimit të Planit nga ana e Qeverisë, dispozitat e tij do të integrohen në rregullativën ligjore dhe strategjitë e sektorëve që janë relevante për rajonin e Ohrit.

## 5.2. Kornizë juridike

Menaxhimi me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit i bazuar në mekanizmat mbrojtës që janë të theksuar në disa ligje nacionale :

- ***Ligji për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Raojonin e Ohrit*** ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 75/2010), i rregullon të drejtat dhe detyrimet e shtetit, e komunave të Ohrit, Strugës dhe Debërcës, si dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik sa i përket menaxhimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit të shënuar në Listën e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore Botërore të Konventës së UNESCO-s. Gjithashtu, me këtë ligj janë definuar të drejtat dhe detyrimet e Komisionit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në rajonin e Ohrit. Komisioni, në përputhje me këtë ligj, bën koordinim të masave për menaxhim. Në këtë ligj definohet nevoja e sjelljes së Planit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore Kulturore dhe Botërore në rajonin e Ohrit. Me fjalë të tjera, me këtë ligj në mënyrë të preliminuar përcaktohet përmbajtja, procesi i përpilimit dhe miratimit të Planit, si dhe organet përgjegjëse për zbatimin e tij.

Është përpiluar *Ligj i ri për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore Botërore në rajonin e Ohrit* i cili është miratuar nga Qeveria në muajin korrik të vitit 2019 (në procedurë të miratimit të plotë). Ky ligj ka për qëllim të instalohet sistem më efikas për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore botërore nga ana e organeve shtetërore dhe lokale, si dhe të mundësohet pjesëmarrje më direkte në këto procese të organizatave profesionale dhe qytetare.

- ***Ligji për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore*** („Gazeta Zyrtare e RM-së " nr.20/04, 71/04, 115/07, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 44/14, 199/14, 104/15, 154/15, 192/15, 39/16, 11/18 dhe 20/19) dhe aktet përkatëse nënligjore i rregullojnë çështjet lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

- ***Ligji për shpalljen e qendrës së qytetit të vjetër të Ohrit si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë*** ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 47/11 dhe 154/15 i përcakton kufijtë e tërësisë së mbrojtur monumentale Qendra e qytetit të vjetër të Ohrit dhe kufijtë e zonës së tij, si dhe regjimi për mbrojtje i cili është i rregulluar në mënyrë të veçantë për tërësinë dhe kontakt zonën e tij.

- ***Ligji për mbrojtjen e natyrës*** ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.67/2004, 14/2006 dhe 84/2007, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16 , 63/16 dhe 113/18) e rregullon mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit, si dhe mbrojtjen e trashëgimisë në zona të mbrojtura dhe jashtë tyre. Në përputhje me Ligjin për Mbrojtje të Natyrës, subjektet që janë përkatëse për mbrojtje dhe menaxhimin me zona të mbrojtura miratojnë plane për menaxhim dhe programe vjetore për mbrojtje të natyrës, pas pëlqimit paraprak nga Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

- ***Me ligjin për ambient jetësor*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 39/16, 99/ 18) rregullohen të drejtat dhe detyrimet e shtetit, të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë dhe fizikë, në sigurimin e kushteve për mbrojtje dhe për përmirësimin e ambientit jetësor, për realizimin e të drejtës së qytetarëve për një ambient jetësor të shëndetshëm.

- ***Me Ligjin për ujërat*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 87/08, 06/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16) rregullohet statusi ligjor i ujërave dhe mënyra dhe kushtet për menaxhimin me ujërat.
- ***Me Ligjin për lundrim të brendshëm*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 55/07, 26/09, 22/10, 23/11, 53/11, 155/12 dhe 15/13, 137/13, 163/13, 42/14, 166/14, 146/15, 193/15 dhe 31/16) rregullohet lundrimi i brendshëm dhe siguria e lundrimit në ujërat e brendshëm në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit, mirëmbajtja dhe mbrojtja e rrugëve lundruese, limanet, rrjedhat e lumenjve dhe plazhet.
- ***Me ligjin për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, Prespës dhe të Dojranit*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 45/77, 8/80, 51/88, 10/90 dhe 62/93) Liqeni i Ohrit u shpall si rajon i mbrojtur në kategorinë "monument i natyrës".
- ***Ligji për shpalljen e zonave pyjore të malit Galiçicë për Park Kombëtar*** ("Gazeta Zyrtare e RPM" Nr. 31/58 dhe 16/65) dhe ***Ligji për shpalljen e një pjese të malit Galiçicë për Park Kombëtar*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 171/10) i përcaktojnë kufijtë dhe regjimet për mbrojtjen e Parkut Kombëtar Galiçicë.
- ***Ligji për pyjet*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr**.** 64/09, 24/11, 53/11, 25/13, 79/13, 147/14, 160/14, 33/15, 44/15, 147/15 dhe 39/16) rregullon planifikimin, udhëheqjen, menaxhimin, kultivimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin, ruajtjen e pyjeve si pasuri natyrore dhe tokën pyjore, realizimin e funksioneve të përgjithshme të dobishme të pyjeve, të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzimit të pyjeve, financimin si dhe çështje të tjera me rëndësi për pyjet dhe tokën pyjore bazuar në parimin biologjik, ekonomik, social dhe ekologjik.
- ***Ligji për kullotje*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 3/98, 101/00, 89/08, 105/09, 42/10, 116/10, 164/13, 193/15 dhe 215/15) rregullon menaxhimin, avancimin dhe shfrytëzimin e kullotjeve që janë në pronësi shtetërore.
- ***Ligji për planifikimin hapësinor dhe urban*** ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18) e përkufizon hierarkinë e planifikimit, llojet e planeve hapësinore dhe urbane, mënyrën e përpunimit dhe miratimit të tyre si dhe pjesëmarrjen e publikut.
- ***Ligji për tokë ndërtimore*** ("Gazeta Zyrtare e RM Nr. 15/15, 44/15, 98/15, 193/15, 226/15, 30/16 dhe 31/16) me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrimet sa i përket tokës ndërtimore, rregullimin e tokës ndërtimore, kushtet dhe mënyrën e disponimit me tokën ndërtimore, si dhe çështje të tjera nga fusha e tokës ndërtimore.
- ***Ligji për ndërtim*** ("Gazeta Zyrtare e RM Nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 59/11, 13/12, 39/12, 144/12, 25/13, 70/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16 dhe 31/16, 39/16, 71/16, 132/16,35/1864/18 dhe 168/18) rregullon ndërtimin, kërkesat themelore të ndërtimit, dokumentacionin projektues të nevojshëm për marrjen e miratimit për ndërtim, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në ndërtim, mënyrën e përdorimit dhe të mirëmbajtjes së ndërtimit, si dhe çështje të tjera me rëndësi për ndërtimin.
- *Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij* ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 46/05 – seanca e 99, 10.06.2005)

## 5.3. Korniza institucionale

Bartës të aktiviteteve për përpilimin dhe ndjekjen e zbatimit të Planit për menaxhimin e rajonit të Ohrit siç është trashëgimia natyrore dhe kulturore botërore janë ***Ministria e Kulturës – Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore*** – për pjesën e trashëgimisë kulturore dhe ***Ministria e mjedisit jetësor dhe***

***planifikim hapësinor – Drejtoria e ambientit jetësor*** – për trashëgiminë natyrore, të caktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

***Ministria për Transport dhe Lidhje*** është organ kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës dhe si i tillë, jep pëlqim për planet urbanistike të përpiluara në formë propozim-plani, me të cilat vërtetohet se planet janë përpiluar në përputhje me dispozitat e Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik dhe sipas rregullave të sjella në bazë të të njëjtit ligj. Ministria për Transport dhe Lidhje miraton program vjetor për financimin dhe përpilimin e planeve urbanistike.

***Qendra konservuese kombëtare – Shkup*** në koordinim me ***Entin për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe Muzeun – Ohër,*** kujdeset për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit. ***Institucioni kombëtar Muzeu "Dr Nikolla Nezllobinski" – Strugë***, është kompetent për mbrojtjen e trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe për trashëgiminë natyrore në territorin e Strugës.

Për menaxhimin me një pjesë të trashëgimisë natyrore të rajonit të Ohrit, është përgjegjës ***Institucioni publik Parku kombëtar Galiçicë*** e cila në mënyrë integrale menaxhon me trashëgiminë natyrore dhe kujdeset për parandalimin e degradimit të trashëgimisë natyrore dhe zonës së parkut kombëtar të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të personave të tjerë juridikë dhe fizikë, në suaza të parkut kombëtar.

Monitorimin, kërkimet shkencore të llojllojshmërisë biologjike dhe sigurimin e materialit gjenetik të llojeve të Liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij, në suaza të rajonit të Ohrit e kryen ***Institucioni shkencor publik – Instituti hidrobiologjik – Ohër***.

***SHA Elektranat e Maqedonisë*** për prodhimin e energjisë elektrike mund të menaxhojë në lartësinë minimale (693,10 lmd) dhe lartësinë maksimale të Liqenit të Ohrit (693,75 lmd), përmes kontrollit të rrjedhës së lumit Drini i Zi. Lartësia maksimale dhe minimale janë të përcaktuara me lejen e ekonomisë së ujërave të lëshuar nga Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor.

Koncesioneri ***"LTDPTU LETNICA-BELVICA Millorad, SHPKNJP Import-eksport Strugë"*** nga Ohri menaxhon me Liqenin e Ohrit në përputhje me bazën e peshkimit të përpiluar nga Instituti i blegtorisë nga Shkupi, sipas së cilës, sasia maksimale e lejuar për të peshkuar në një ditë në zonën e peshkimit Sliv në Liqenin e Ohrit është gjithsej 2 kg prej të cilave: deri 3 peshq të llojit troftë, deri 15 peshq të llojit barbel i zi, deri 6 peshq të llojit skobust, deri 6 peshq të llojit klen, deri 10 peshq të llojit pendëkuq, deri 1 peshk të llojit krap si dhe deri 1 peshk të llojit ngjalë.

***Kapitenia e porteve – Ohër (Ministria për Transport dhe Lidhje)*** i ka kompetencat vijuese: kujdeset për sigurinë e objekteve lundruese, mban Regjistër të objekteve lundruese dhe barkave; përkohësisht mund ta kufizojë apo ndalojë lundrimin dhe përdorimin e rrugës lundruese, të porteve, shtëpizat e dimrit**,** të vendeve për hedhjen e spirancave, të plazheve për larje si dhe të ndalojë lundrimin e objekteve lundruese jo të rregullta; kërkon të hiqen objekte lundruese të dëmtuara, të përmbysura ose të fundosura që e pengojnë apo rrezikojnë sigurinë e lundrimit ose që paraqesin rrezik për ndotje, jep mendime për planet e detajuara urbanistike për pjesët e bregut dhe hapësirës ujore të ujërave të brendshëm në të cilat mund të ndërtohen porte, shtëpiza dimri, vende për hedhjen e spirancave dhe vend larjeve dhe të vendosen objekte lundruese dhe notuese etj. Nëse në një objekt lundrues ndodh diçka që paraqet rrezik për sigurinë e anijes apo mjetit lundrues, nëse ndodh ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme në anije, udhëtarëve dhe ngarkesës, ose nëse vërehet ndonjë ndotje nga vajra apo kimikalje në rrugën e lundrimit, udhëheqësi i anijes obligohet që një gjë të tillë menjëherë ta shënojë në regjistrin e anijes dhe Kapitanerisë t'i dorëzojë raport për ngjarjen më së voni në afat prej 24 orësh.

***Komunat Ohër, Strugë dhe Debërc***, në pajtim me rregullativën ligjore, nuk kanë kompetencë në pjesën e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, përveç mundësisë për të iniciuar shpallje të rajoneve të mbrojtura në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës. Megjithatë, komunat, me zbatimin e

kompetencave të tyre në raport me veprimtaritë komunale, planifikimin urban dhe zhvillimin lokal ekonomik, mund të ushtrojnë ndikim mbi vlerat e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit.

***Organizatat qytetare*** i ndjekin proceset dhe aktivitetet që mund të ndikojnë negativisht ndaj vlerës së jashtëzakonshme universale që ka rajoni dhe të reagojnë në publik, duke ushtruar trysni ndaj institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal dhe ndaj sektorit sektor, që t'i respektojnë dispozitat e ligjeve që i rregullojnë çështjet për mbrojtjen e ambientit jetësor, të ujërave, të natyrës, të trashëgimisë kulturore dhe të menaxhimit me mbetjet.

### 5.3.1. Pronësia

Trashëgimia kulturore dhe të mirat, për të cilat me arsye supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore që do të gjenden në tokë apo ujë, konsiderohen pronë shtetërore. Trashëgimia si dhe toka ku ndodhet trashëgimia natyrore në rajonin e Ohrit mund të jetë në pronësi shtetërore, në pronësi të njësive të vetëqeverisjes lokale në territorin e së cilës ndodhet trashëgimia natyrore dhe në pronësi private (personave fizikë, bashkësive fetare). Të emëruarit - përgjegjës për trashëgiminë kulturore në rajonin e Ohrit janë përgjegjës për mirëmbajtjen, ruajtjen, respektimin dhe shfrytëzimin e drejtë të saj.

Llojet e mbrojtura të florës dhe faunës si dhe ambienti i tyre janë në pronësi shtetërore, pa marrë parasysh pronësinë e tokës në të cilën gjendet trashëgimia natyrore. I emëruari që është përgjegjës për trashëgiminë natyrore në rajonin e Ohrit mund ta shfrytëzojë në mënyrë dhe me kushte të caktuara me ligj. Pronari i tokës në të cilën ndodhet trashëgimia natyrore obligohet të kujdeset për llojet dhe ambientin e tyre në mënyrën e rregulluar me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe me ligjet nga fushat përkatëse. Për arritjen e qëllimeve të mbrojtjes dhe zbatimit të regjimeve të mbrojtjes, është e mundur të kryhet eksproprijimi i tokës që është pronë private.

## 5.4. Sistemi për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit

Sistemi për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit mbështetet në tri shtylla themelore edhe atë:

1. Planifikim dhe shfrytëzim të tokës
2. Menaxhim me trashëgiminë natyrore
3. Menaxhim me trashëgiminë kulturore

### 5.4.1. Planifikimi dhe shfrytëzimi i tokës

Planifikimi dhe shfrytëzimi i tokës në rajonin e Ohrit sigurohet me përpilimin, miratimin dhe zbatimin e planeve hapësinore dhe urbane të cilat harmonizohen ndërmjet tyre.

Dokumentet planifikues që e orientojnë zhvillimin hapësinor të rajonit janë: Plani hapësinor i RM, gjegjësisht Plani hapësinor i rajonit të Ohrit-Prespës, Planet e Përgjithshme Urbanistike (PPU) ty qytetit të Ohrit dhe Strugës, Planet e Detajuara Urbanistike (PDU), planet urbanistike për fshatin, planet urbanistike jashtë vendbanimeve (PUJV), planet urbanistike për rajonet dhe ndërtimet me interes shtetëror, dokumentet urbanistike-planifikuese për ndërtimet me interes të veçantë, dokumentet planifikuese urbanistike shtetërore (DPUSh), dokumentet planifikuese urbanistike lokale (DPUL), dokumentet planifikuese urbanistik për zonat turistike-zhvillimore (DPUZTZh), dokumentet planifikuese urbanistike për autokampe dhe për projekte infrastrukturore në rajonin e Ohrit.

### 5.4.1.1. Plane hapësinore

Planet hapësinore ekzistuese në bazë të të cilëve menaxhohet me qëllimin dhe shfrytëzimin e tokës në kufijtë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit janë:

1. Plani hapësinor i RM (2004-2020);
2. Plani hapësinor për rajonin e Ohrit-Prespës (2005-2020),
3. Plani për rregullimin hapësinor të Parkut kombëtar Galiçicë (1988)

Plani hapësinor i komunës së Ohrit është miratuar në vitin 1988 por vlefshmëria e tij ka skaduar.

Projekt-plani hapësinor për Parkun kombëtar Galiçicë (2010-2020) ende nuk është përpunuar deri në fund.

**Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë**

Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë i vitit 2004 është dokumenti planifikues më i lartë afatgjatë dhe integral për hapësirën e shtetit, me të cilin jepen udhëzime për qëllimin, shfrytëzimin, mbrojtjen, organizimin dhe rregullimin e hapësirës në territorin e shtetit dhe për rregullimin e asaj hapësire. Me planin hapësinor të RM, përpunimi i trashëgimisë natyrore dhe i trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit, nuk bëhet ndarazi. Llojllojshmëria biologjike dhe mbrojtja e saj, trajtohet në përputhje me Ligjin e vjetër për raritetet natyrore. Në kapitullin ku trajtohet trashëgimia natyrore, janë të përcaktuara rajonet e parashikuara për mbrojtje, si dhe llojet e veçanta brenda dhe jashtë rajoneve të mbrojtura (Tabela 1).

*Tabela 1. Plani hapësinor I RM-së: kontroll të zonave të mbrojtura dhe të propozuara për mbrojtje në rajonin e Ohrit*

| Kategoria | Emri | Komuna | Statusi i mbrojtjes |
|---|---|---|---|
| Parku Kombëtar | Galiçica | Ohër | I mbrojtur |
| Rezervat hulumtues- shkencor | Osoj | Ohër | Propozim |
| Simbol i natyrës | “Makedonski dab” | Ohër | I mbrojtur |
| Simbol i natyrës | Shpella “Samoska dupka” | Ohër | Propozim |
| Simbol i natyrës | Shpella Jaorec | Ohër | Propozim |

| Kategoria | Emri | Komuna | Statusi i mbrojtjes |
|---|---|---|---|
| Simbol i natyrës | Pllatan- çinar | Ohër | Propozim |
| Simbol i natyrës | Trungjet e pishave | Ohër | I mbrojtur |
| Simbol i natyrës | Pisha alpine | Ohër | I mbrojtur |
| Simbol i natyrës | Shakull – f. Kosel | Ohër | I mbrojtur |
| Simbol i natyrës | Çinar | Strugë | I mbrojtur |
| Simbol i natyrës | Shpella Mleçnik | Strugë | I mbrojtur |
| Simbol i natyrës | Burimet e Vevçanit | Vevçani | I mbrojtur |

Pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 2005, kategoritë e zonave të mbrojtura u ndryshuan, respektivisht u harmonizuan me kategoritë e përcaktuara nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës - IUCN. Në të njëjtën kohë, qasja e konservuese bazuar në rrallësi natyrore brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura janë ndryshime në drejtim të mbulimeve përfaqësuese të llojeve të vendbanimeve dhe ekosistemeve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. **Në këtë drejtim, Plani Hapësinor i RM-së nuk ofron udhëzime adekuate për menaxhim me trashëgiminë natyrore në rajonin e Ohrit.**

Trashëgimia kulturore, sipas Planit Hapësinor të RM-së, klasifikohet në dy grupe themelore: zona monumentale dhe monumente individuale. Më pas është identifikuar "zona natyrore dhe kulturore e Ohrit me pjesën e vjetër të qytetit të Ohrit, Liqenin e mbrojtur të Ohrit dhe Parkun Kombëtar të Galiçicës si një zonë me vlera të përziera, me vlera të veçanta natyrore, historike, kulturore dhe artistike të krijuara nga njeriu përgjatë shekujve". Me Planin Hapësinor janë bërë përpjekje të bëhet inventarizimi i zonave monumentale dhe monumenteve individuale, por nga të dhënat e pjesshme në terren, për periudhën 1998-2003, është konstatuar një rënie e trashëgimisë kulturore të patundshme, në veçanti në arkitekturën e vjetër të qytetit.

Plani Hapësinor miraton objektiva përkatëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, siç janë: sigurimi i kushteve të planifikimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme, integrimi hapësinor dhe përdorimi aktiv i monumenteve të kulturës në ekonominë dhe shërbimet e turizmit dhe përcaktimi i metodologjisë, kritere dhe procedurë unike për valorizimi i trashëgimisë kulturore të patundshme.

**Plani Hapësinor për rajonin e Ohrit-Prespës**

Me Plani Hapësinor për Rajonin e Ohrit-Prespës (2005-2020) parashikon mbrojtje e pasurisë natyrore dhe trashëgimisë kulture-historike si kapital më i rëndësishëm hapësinor dhe ndalimin e degradimit urban.

Sa i përket mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, është zbatuar koncept i ngjashëm si në Planin Hapësinor të RM-së, respektivisht trashëgimia natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit të shënuara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s nuk trajtohet si një tërësi integrale hapësinore.

Në kuadër të këtij Plani Hapësinor, janë shënuar në harta vendet me rëndësi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit (f. 25).




*Fotografia 25. Harta e trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit-Prespës*

(Trashëgimia kulturore dhe historike Harta A2110817)

(Legjenda Monumente individuale)

(Tërësi monumentale) (Të mbrojtura (numri) ) (Të pambrojtura (numri) )

Të mbrojtura arkitekturë e qytetit të vjetër arkitekturë e qytetit të vjetër

Të pambrojtura

(Tërësi monumentale rurale)

Të mbrojtura

Të pambrojtura

(Të mbrojtura (numri) ) (Të pambrojtura (numri) ) (Të mbrojtura (numri) ) (Të pambrojtura (numri) )

Kisha Kisha Arkeologji Arkeologji

Arkitekturë islame Arkitekturë islame

Mbrojtje e shkallës së parë

Mbrojtje e shkallës së dytë

Mbrojtje e shkallës së tretë

### 5.4.1.2. Planet Urbanistike

Për zbatimin e planeve të hapësinore janë miratuar plane të detajuara urbanistike të përgjithshme, dhe lloje tjera të dokumentacionit të planifikimit urbanistik.

**Planet e Përgjithshme Urbanistike (PPU)**

6. Plani i Përgjithshëm Urbanistik i Ohrit (1989 dhe 2006)
7. Plani i Përgjithshëm Urbanistik i komunës së Strugës (2007)
8. Plani i Përgjithshëm Urbanistik i hapësirës së bregut të liqenit të Komunës së Ohrit (1989);
9. Plani i Përgjithshëm Urbanistik i hapësirës së bregut të liqenit të komunës së Ohrit në Zonën Lindore 1, Lagadin - Pestani, ndryshime dhe plotësime (1997);
10. Plani për realizimin e kompleksit turistik "Shën Stefani - Ohër "(1983)
11. Plani i Përgjithshëm Urbanistik për pjesë të hapësirës së bregut të liqenit, lokalitet turistik Gorica-Shën Stefani-Metropol (2001)
12. Ndryshim i pjesës së PPU-së për hapësirën e bregut të liqenit të komunës së Ohrit (Zona Veri - Lokaliteti Turistik "Andon Dukov" (2001)
13. PDU për hapësirën e bregut të liqenit “Kaneo - Studençiçta” (2001)
14. PDU për hapësirën e bregut të liqenit Grashnicës - një pjesën e rëndësishme.
15. **Planet e Detajuara Urbanistike (PDU)**
16. PDU për kompleksin e vilave "Lagadin" (1987)
17. PDU për lagjen Trpeica (1990)
18. Ndryshime dhe plotësime në pjesën e PDU-së "Shën Stefani-Ohër" -Blloku 1 (1999)
19. Ndryshime dhe plotësime në kompleksin turistik "Shën Stefani-Ohër" (objekt hotelierik) (1999)
20. PDU për lëvizjen Lagadin-Peshtani (1999)
21. PDU për hapësirën e bregut të liqenit “Kaneo-Studençishta” (2001)
22. PDU për hapësirën e bregut të liqenit Grashnica - Daljan (2001)
23. **Dokumentacioni Urbanistik për Vendbanim (DUV)**
24. DUV për Ljubanishtën (1999)
25. DUV për Podmoljen (1999)
26. DUV për Eleshanin
27. DUV për Peshtanin
28. Plan Urbanistik Jashtë Vendbanimit (PUJV)
29. PUJV për një pjesë të lokalitetit turistik Gorica-Shën Stefani-Hotel Metropol, pjesë e bllokut 2 (2008)
30. PUJV për një pjesë të lagjes turistike Goricë - Lindje (2008)
31. PUJV për Lagadinin - Peshtani pjesa e PU 9 (2008)
32. **Plane të përpunuara urbanistike për fshatra/komuna Akte për vendet në territorin e Komunës së Debërcës të cilat janë brenda kufijve të së mirës së mirave të mbrojtura:**
33. - Botun
34. - Leshani
35. - Mesheishta
36. - Trebenishta
37. - Gorenici
38. - Ovornik
39. **Planet e Përgjithshme Urbanistike të qyteteve të Ohrit dhe Strugës**

40. Plani i Përgjithshëm Urbanistik (PPU) për qytetin e Ohrit ka qenë i vlefshëm nga viti 2006 - 2016, ndërsa PPU për qytetin e Strugës ka qenë i vlefshëm për periudhën 2007-2017. Në vitin 2013, u inicua përpilimi i një PPU të ri për qytetin e Strugës, por ky proces u ndalua nga Institucioni Kombëtar Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut-Ohër deri në përpilimin e bazave mbrojtëse konservuese për përfshirjen e planifikimit.Në vitin 2015, përsëri është bërë përpjekje për të rivendosur miratimin e një PPU të ri për qytetin e Strugës, duke pasur parasysh se ndërkohë janë përgatitur disa baza mbrojtëse konservuese për planet e detajuara urbanistike, respektivisht është bërë një inventarizim i plotë i objekteve që janë të mbrojtura. Në vitin 2018 ka filluar përpilimi i një PPU të ri për qytetin e Strugës. Përpilimi i një PPU të ri për qytetin e Ohrit është planifikuar të fillojë.
41. ***E nevojshme është të miratohen Plane të reja të Përgjithshme Urbanistike për qytetet e Ohrit dhe Strugës në mënyrë që të zbatohet Konventa e UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore dhe të parandalohen aktivitetet që ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore***

#### 5.4.1.3. Institucione përkatëse për menaxhim me zhvillimin hapësinor dhe urban në rajonin e Ohrit.

Për miratimin dhe zbatimin e planeve përkatëse hapësinore dhe urbanistike në rajonin e Ohrit me trashëgiminë e tyre natyrore dhe kulturore botërore, kompetente janë më shumë institucione (tabela 2):

*Tabela 2. Plane hapësinore dhe urbanistike dhe institucione kompetente për miratimin dhe zbatimin e tyre në rajonin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit*

| Organi/Institucioni | Qëllimi | Plani |
|---|---|---|
| - Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor | - Zonimi i vendeve të mbrojtura<br>- Zonimi i tërësive monumentale | - Plani hapësinor i RM-së<br>- Plan hapësinor për rajonit e Ohrit-Prespës<br>- Plan hapësinor për parkun kombëtar Galiçicë |
| - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve | - Qëllimi i përdorimit të tokës së parcelave ndërtimore përgjatë rrugëve shtetërore<br>- Menaxhim të infrastrukturës së rrugëve, hekurudhave, energjisë, ekonomizimit të ujërave dhe infrastrukturës telekomunikuese | - DSHPU<br>- Projekt për infrastrukturë |
| - Komuna e Ohrit<br>- Komuna e Debërcës<br>- Komuna e Strugës | - Qëllimi i përdorimit të tokës në rajon ndërtimor, bllokut urbanistik katër etj.<br>- Rregullim i parcelave ndërtimore brenda dhe jashtë rajonit ndërtimor, përgjatë rrugëve me rëndësi lokale | - , PPU, PDU, PUJV, PUZTZH, DPUD |

Planifikimi dhe përdorimi i tokës është një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në rajonin e Ohrit. Për këtë arsye, për planet me të cilat në mënyrë potenciale mund të rrezikohen këto pasuri në mënyrë të obligueshme zbatohet Vlerësim Strategjik i Mjedisit Jetësor sipas Ligjit për Mjedis Jetësor dhe Dekretit për Strategji, Plane dhe

Programe, përfshirë ndryshimet e tyre, për të cilat në mënyrë të obligueshme ka procedurë për vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedisin jetësor dhe mbi jetën dhe shëndetin e njerëzve. Për projektet e infrastrukturës, e në varësi të llojit të infrastrukturës së planifikuar, zakonisht zbatohet edhe procedurë e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedisin Jetësor, në përputhje me Ligjin për Mjedisin Jetësor.

Dispozitat e rëndësishme për menaxhimin e urbanizimit në rajonin e Ohrit, përfshirë edhe dispozitat sipas të cilave Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor zbaton procedurat e duhura administrative janë të përfshira në disa rregulla ligjore në fushën e mbrojtjes së natyrës, mjedisit jetësor, planifikimit urbanistik, etj.

### 5.4.2. Menaxhimi me trashëgiminë natyrore

Trashëgimia natyrore në kufijtë e trashëgimisë botërore në rajonin e Ohrit është e përqendruar në Parkun Kombëtar Galiçicë dhe Simbolin e Natyrës Liqenin e Ohrit, përfshirë këtu edhe Moçalin e Studençishtës. Institucioni publik Parku Kombëtar Galiçicë menaxhon me trashëgiminë natyrore të Parkut Kombëtar në përputhje me Planin për Menaxhim të Parkut Kombëtar Galiçicë (2010-2020) .

Me trashëgiminë natyrore të Liqenit të Ohrit menaxhojnë disa institucione dhe organizata (Tabela 3), për sa i përket rregullimit të ngritjes së liqenit përmes rrjedhjes së lumit Drini i Zi, menaxhimit me fondin e peshkimit (përfshirë edhe shumimin e peshqve), monitorimit të cilësisë së ujërave, rregullimit të brendshëm të lundrimit etj.

*Tabela 3. Kontrollim të sistemit të menaxhimit me trashëgiminë natyrore në rajonin e Ohrit*

| Të mirat | Organi/Institucioni | Ligji | Plan ose program |
|---|---|---|---|
| Parku Kombëtar "Galiçicë" | - NPPK Galiçicë | - Ligji për Mbrojtjen e Natyrës<br>- Ligji për shpalljen e një pjese të malit Galiçicë si Park Kombëtar<br>- Nominime për: "Emerald Zonë", "Zonë e rëndësishme bimore", "Zonë primare për flutura" dhe "Zonë potenciale NATURA 2000" | - Plan për menaxhim me Parkun Kombëtar Galiçicë (2010-2020) |
| Pyjet jashtë Parkut Kombëtar | - NP Pyjet e Maqedonisë | - Ligji për Pyje | - Baza ekonomike pyjore |
| Simboli i natyrës Liqeni i Ohrit | - Komuna e Ohrit, Strugës dhe Debërcës | - Ligji për Mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, Prespës dhe Dojranit | - Nuk është përpiluar Plan për Menaxhim me simbolin e natyrës Liqeni i Ohrit |
| | - Enti hidrobiologjik - Ohër | - Ligji i Ujërave<br>- Ligji për Mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, Prespës dhe Dojranit | - Program për monitorim të Liqenit të Ohrit dhe Prespës |

| Të mirat | Organi/Institucioni | Ligji | Plan ose program |
|---|---|---|---|
| (përfshirë edhe Moçalin e Studençishtës)[15] | - ELEM | - Ligji për Energjetikë<br>- Leje për Menaxhim me Ujërat | - Menaxhim me rrjedhën e lumit Drini i Zi dhe me hidroakumulimet e Drinit të Zi |
| | -Letnica – Belvica Milorad | - Ligji për Peshkatari dhe akuakulturë | - Baza e peshkimit të Liqenit të Ohrit |
| | - Qendra e Shëndetit Publik Ohër | - Ligji i Ujërave<br>- | - Program për monitorimin e cilësisë së ujit për notim |
| | - MTL Kapedania e porteve - Ohër | - Ligji për Lundrim të Brendshëm | - Regjistër për objektet e notimit dhe varka;<br>- Kufizim apo ndalim të lundrimit<br>- Raport për ndotje nga vajrat dhe kimikaljet të linjës lundruese |

Ende nuk është përgatitur Studim mbi Rivlerësimin e Simbolit të Natyrës Liqenit të Ohrit dhe Moçalit të Studençishtës, si bazë për miratimin e Ligjit për Shpalljen e këtyre Zonave të Mbrojtura, respektivisht Planeve përkatëse për Menaxhimin e tyre. Sipas kësaj, nuk është përcaktuar as institucioni që do të jetë përgjegjës për menaxhimin me Liqenin e Ohrit dhe Moçalin e Studençishtës.Në vitin 2018, gjithashtu është përgatitur një proces-propozim-dosje për shpalljen e Liqenit të Ohrit dhe Moçalit të Studençishtës sipas Konventës së Ramsarit, ku me shpalljen si vende të ramsarit rajoni i Ohrit duhet t'i ketë përparësi më të madhe.

***Duke pasur parasysh se për menaxhimin e Simboleve të Natyrës Liqeni i Ohrit dhe Moçali i Studençishtës nuk janë përcaktuar organe përkatëse menaxhuese, mund të ketë eksploatim të mëtejshëm të pakontrolluar të burimeve natyrore dhe humbje të biodiversitetit dhe llojllojshmërisë së peizazhit në këtë rajon.***

### 5.4.3. Menaxhimi me trashëgiminë kulturore

Trashëgimia kulturore brenda kufijve të së mirës së mbrojtur është e përqendruar në qytetet e Ohrit dhe Strugës, vendbanimet përskaj bregut të liqenit Trpejcë, Peshtan, Radozhdë dhe Kalishtë dhe rripin e bregut. Institucionet kombëtare - Qendra Kombëtare e Konservimit - Shkup dhe Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut - Ohër janë përgjegjës për ndërmarrjen e masave konservuese mbrojtëse të Trashëgimisë Kulturore Botërore në rajonin e Ohrit secila sipas kompetencave të veta.

[15] Akoma nuk është themeluar trup për menaxhim

Muzeu “Dr Nikolla Nezlobinski” – Strugë është përgjegjës për ndërmarrjen e masave për mbrojtje të trashëgimisë së tundshme kulturore dhe natyrore e cila është pjesë përbërëse e përmbledhjes së këtij muzeu.

Shërbimet për mbrojtje janë të përfshira edhe në urbanizimin e hapësirës, në mënyrë që para fillimit të përpilimit të çfarëdo dokumenti planifikues, secili urbanizim është i kushtëzuar për përpilim të bazave konservuese mbrojtëse të cilat janë drejtime për urbanizim të mëtejshëm të hapësirës së rajonit të Ohrit. Ata përfshijnë indentifikimin, inverteriztimin, kufijtë e trashëgimisë së patundshme me kontakt zonën, masat mbrojtëse, nevojën për intervenime, revitalizim dhe potencialin për shfrytëzim të qëndrueshëm të të mirave.

*Tabela 4. Kontrollim të sistemit të menaxhimit me trashëgiminë natyrore në rajonin e Ohrit*

| Të mirat | Organ/institucion | Ligji | Plan ose program |
|---|---|---|---|
| Trashëgimi e tundshme kulturore | - Muzeu “Dr Nikolla Nezlobinski” - Strugë<br>- IK Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe Muzeut – Ohër | | - Programi i punës |
| Trashëgimi e patundshme kulturore | - IK Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe Muzeut – Ohër<br>- Qendra Kombëtare e Konservimit - Shkup | - Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore | - Programi i punës-Bazat mbrojtëse-konservuese për dokumentacion adekuat urban-planor |
| | - Persona juridik dhe fizik – posedues të trashëgimisë kulturore<br>- Kisha ortodokse maqedonase<br>- Bashkësia Fetare Islame | | |
| Qendra e vjetër e qytetit të Ohrit | - IK Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe Muzeut – Ohër<br>- Komuna e Ohrit | - Ligji për shpalljen e qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë | - PDU |
| Trashëgimi e patundshme kulturore në pronësi shtetërore | - Drejtori për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | - Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore | |
| | | - Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore; | |

| Të mirat | Organ/institucion | Ligji | Plan ose program |
|---|---|---|---|
| Qendra e vjetër e qytetit të Ohrit | - IK Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe Muzeut – Ohër<br>- Komuna e Ohrit | - Ligji për shpalljen e qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë | |
| Qendra e vjetër e qytetit të Strugës | - IK Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe Muzeut – Ohër<br>- Komuna e Strugës | - Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore; | |

### 5.4.4. Komisioni për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit

Menaxhimi i Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore Botërore në rajonin e Ohrit është komplekse dhe përfshin shumë faktorë dhe disiplina. Në të njëjtën kohë, është i nevojshëm koordinim i sistemeve ekzistuese për planifikimin dhe menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Gjatë viteve të kaluara është promovuar dialogu ndërmjet faktorëve të ndryshëm, me qëllim të gjenden mënyrat më të përshtatshme për menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Me Ligjin për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në rajonin e Ohrit, është formuar v e cila kujdeset për parandalimin e aktiviteteve, zbatimi i të cilave mund të ketë një ndikim negativ në vlerën e jashtëzakonshme universale, me qëllim lënien e tyre brezave të ardhshëm. Komisioni ka 21 anëtarë.

Me Propozim-ligjin e ri për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit (i cili është në proces të miratimit në procedurë parlamentare) do të krijohen parakushte formale-ligjore për të parandaluar dhe forcuar aktivitete që ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, si dhe të ndërmerren masa për përfshirjen e tij aktive në jetën e bashkësisë, si një faktor i zhvillimit të qëndrueshëm. Për këtë qëllim, Propozim-ligji parashikon Komision të vazhdueshëm për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Ohrit të transformohet në Këshill për Monitorim dhe Koordinim të Menaxhimit të Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit (në tekstin e mëtejmë: "Këshill"), në të cilin do të jenë 14 anëtarë ekspertë të jashtëm dhe zyrtarë administrative - përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Kulturës, e Transportit dhe Lidhjeve, komunat e Ohrit, Strugës dhe Debarcës, Instituti Kombëtar Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe Muzeut - Ohër, institucion Shkencor Publik Enti Hidrobiologjik- Ohër, Institucioni Publik Parkut Kombëtar Galiçica dhe organizatat e shoqërisë civile në fushën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Kompetencat e Komisionit kanë për qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të vlerave natyrore dhe kulturore të të mirave përmes:

- Integrimin dhe zbatimin e planifikimit në të gjitha nivelet;

- Bashkëpunimi ndërsektorial dhe ndërinstitucional;
- Përfshirja e Organizatave Civile në planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve të duhura strategjike dhe planifikuese;

# 6. Rreziqet dhe vlerësimi i rrezikimit të vlerës së jashtëzakonshme universale

## 6.1. Rreziqet dhe rekomandimet e identifikuara në Raportin e Misionit Reaktiv të UNESCO-s

Me Raportin e Misionit të Monitorimit Reaktiv (2017) nënvizon rreziqet dhe kërcënimet mbi vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore të rajonit të Ohrit me rekomandime për heqjen ose zvogëlimin e tyre:

1. Ndërtimi i Hekurudhës, Korridori Evropian VIII : Rekomandohet të identifikohen trasetë alternative (përfshirë edhe trasenë të propozuar nga ICOMOS) që nuk hyjnë në Kufijtë e Trashëgimisë Botërore, gjegjësisht nuk afrohen shumë afër brigjeve të Liqenit të Ohrit (veçanërisht për t'u shmangur zona natyrore në kufirin shqiptaro-maqedonas afër vendbanimit Lin) dhe studimi i traseve alternative të dorëzohet në Qendrën e Trashëgimisë Botërore.
2. Ndërtimi i autostradës seksioni A2 Trebenishtë - Strugë , Korridori Evropian VIII: Rekomandohet të sigurohet një numër i mjaftueshëm vendkalimesh për njerëz dhe kafshë, si dhe të kohen parasysh vendet e mundshme arkeologjike gjatë ndërtimit.
3. Rekomandohet të vlerësohen ndikimet kumulative të hekurudhës dhe autostradës, respektivisht ndikimet mbi mjedisin jetësor të secilit prej projekteve individuale duke kryer vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor. Ato duhet të analizohen gjatë zbatimit të Vlerësimit Strategjik të Ndikimit të Planit për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit.
4. Ndërtimi i autostradës A3: Realizimi i kësaj rruge është i papranueshëm sepse do të shkaktojë dëme të pakthyeshme në vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore.
5. Ndërtimi i Qendrës së Skijimit Galiçicë : Në bashkëpunim me projektet e tjera zhvillimore dhe ndryshimet e deritanishme të vendbanimeve dhe rripit të bregut, projekti do të shkaktojë dëme të pakthyeshme në vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore.
6. *Projekte turistike zhvillimore/zona:* Zonat turstike zhvillimore Krastë, Gradishtë, Lubanishtë 1 dhe 2, si dhe objektet turistike me përmasa të mëdha me rëndësi të turizmit të kongresit konsiderohen si kërcënime, pa u analizuar paraprakisht ndikimet individuale dhe kumulative nga këto projekte. Të njëjtat duhet të analizohen gjatë zbatimit të Vlerësimit Strategjik të Ndikimit të Planit për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit.[16]

Ndryshimet e shkaktuara nga urbanizimi janë identifikuar gjithashtu si faktorë që paraqesin rrezik për vlerën e jashtëzakonshme universale të trashëgimisë botërore të rajonit të Ohrit (rreziqe të konstatuara edhe nga Misionet e UNESCO-ICOMOS-IUCN në vitit 1998, misioni i ICOMOS-it në vitin 2013 dhe Misioni Monitorues Reaktiv i Qendrës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe organeve këshilluese (IUCN dhe ICOMOS) të vitit 2017).

Misioni i vitit 2017 gjithashtu zbuloi se gjendja e përgjithshme e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore të përzier të rajonit të Ohrit është nën kërcënimin e një numër faktorësh që mund të

[16] Në vitin 2018 është sjellë Vendim nga ana e Qeverisë që të anulohen projektet për seksionet (a) dhe (e) të rrugës ekspres A3 si dhe realizimi i qendrës së skijimit të Galiçicës, dhe të zonave zhvillimore turistike Krastë, Gradishtë, Lubanishtë 1 dhe 2.

rezultojë me zbatimin e alineve 179 dhe 180 të Udhëzuesit operativ, që do të nënkuptojë se origjinaliteti dhe integriteti i kësaj trashëgimie mund të rrezikohet.

- Me Vendimin e Komitetit të Trashëgimisë Botërore (43SOM 7V.36) i miratuar në seancën e 43-të (Baku, Azerbajxhan, 30 qershor - 10 korrik 2019) është shënuar përparim në zbatimin e një pjese të rekomandimeve të Misionit Reaktiv në lidhje me anulimin e qendrës së skijimit, zonave zhvillimore turistike dhe rruga A3, si dhe huazimet që Qeveria ua ka deleguar institucioneve kompetente, megjithatë të nënvizuara janë rreziqet dhe nevojat e mbetura që duhet t'i tejkalojë vendi, respektivisht t'i përmbushë edhe atë:
- Të analizohen trasetë alternative të Korridorit VIII, të cilat do të shkojnë përtej kufijve të zonës së mbrojtur në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të cilat do të lidhen me trasenë e propozuar të hekurudhës në Shqipëri që kalon përtej zonës së mbrojtur në Shqipëri;
- Të bëhet vlerësim i ndikimeve mbi trashëgiminë kulturore të trasesë A2 seksioni Trebenishtë - Strugë;

- Të vendoset moratorium për transformimin urban dhe të bregut të liqenit deri në miratimin e dokumenteve të duhura të planifikimit dhe miratimin e mekanizmave ligjorë dhe kontrollues që garantojnë mbrojtjen e nevojshme;
- Të përgatitet inventarizim i ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme; të bëhet vlerësim i ndikimit mbi trashëgiminë kulturore dhe vlerësim mbi ndikimin e mjedisit jetësor për këto objekte dhe t'i qasen prishjes së objekteve që kanë ndikim negativ; të kryhet mbikëqyrje përkatëse për të parandaluar paraqitjen e mëtejshme të ndërtesave pa leje;
- Të plotësohet Plani për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit dhe të dorëzohet propozim- Plan deri tek Qendra e Trashëgimisë Botërore dhe organeve këshilluese para se i njëjti të finalizohet dhe miratohet;
- Të zbatohen të gjitha rekomandimet e tjera të Komitetit të UNESCO-s të përfshira në Raportin e Misionit Reaktiv 2017;

## 6.2. Transformimi i bregut të liqenit dhe kërcënimet për vendet me vlera natyrore

Përmes monitorimit të ndryshimeve të incizimeve satelitore është analizuar transformimin i bregut të liqenit për periudhën 2012-2018, që ka të bëjë me ndërtesat rreth bregut të liqenit dhe instalimin e platformave në liqen, si dhe ndryshime (zvogëlimin) e arealit të kallamishteve (Fotografia 23).

Ndryshimet e regjistruara në rripin e kallamishteve gjatë vitit 2011 janë për shkak të rritjes së komplekseve të mëparshme më të vogla dhe zgjerimi i tyre madje edhe në tokë, dhe për faktin që ish-komplekset e kallamishteve tani janë më të dendura. Prandaj, numri i përgjithshëm i komplekseve të kallamishteve në vitin 2011 (80) është më i ulët se ai i regjistruar 25 vjet më parë (105), ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e rripit të kallamishteve është rritur. Ndryshe, sipas matjeve të vitit 2011, sipërfaqja e përgjithshme e rripit të kallamishteve nga Liqeni i Ohrit është 77.15 ha, që është 2.8 ha më e madhe se ajo e matur 25 vjet më parë (edhe krahas shkatërrimit të pakontrolluar të kallamishteve duke i prerë, djegur, shkulje, grumbullim të dheut dhe mbeturina ndërtimore).

Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të vitit 2019 në rripin e kallamishteve dhe inspektimet e kryera nga Enti Hidrobiologjik - Ohër vihet re se në disa zona kallami është shkatërruar në mënyrë të pakontrollueshme nga faktori njeri me prerje, djegie, shkulje, grumbullim të dheut dhe mbeturinave ndërtimore me qëllim që të fitojnë të ashtuquajturat "hapësira të dobishme" për qëllime të ndryshme

(toka të punueshme, vende për deponim të dheut dhe mbeturinave ndërtimore, plazhe, komplekse hotelierike dhe objektet e tjera të akomodimit, parkingje, etj).



*Fotografia 26. Murrë prej betoni në rripin Strugë – Kalishtë dhe shtëpizë montuese Radozhdë*



*Fotografia 27.Deponim i mbeturinave ndërtimore në rripin e kallamishteve në Strugë*



*Fotografia 2. Hapësira punuese në rripin e kallamishteve para Radozhdëz*

Vendet me vlera natyrore që janë të rrezikuara:

- Podmolje, Komuna e Ohrit ; rreziku: prerja dhe djegia e kallamishteve, urbanizimi i mundshëm, turizmi, ndotja e mundshme;
- Moçali i Studençishtës, Komuna e Ohrit; rreziku: mosvalorizimi, fragmentimi, grumbullimi i plehrave dhe mbeturinave ndërtimore;
- Burimet e Shën Naumit, Komuna e Ohrit ; rreziku: turizëm masiv, uzurpim i hapësirës me ndërtimin e objekteve hotelierike, ndotje e mundshme e ushqimit të peshkut në rasatin e improvizuar të peshqve, ujërat e zeza, udhëtime me varka;

## 6.3. Rreziqet sipas klasifikimit të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN) dhe Vlerësimi Global Ndërkombëtar i Ujërave (GIWA)

Vlerësimi i rreziqeve është bërë në përputhje me udhëzimet e publikuara nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN) dhe Vlerësimi Global i Ujërave Ndërkombëtar (GIWA).Klasifikimi i rekomanduar nga IUCN ka të bëjë me rreziqet ndaj specieve të rrezikuara të florës dhe faunës, ndërsa rreziqet e identifikuara nga ana e GIWA aplikojnë qasje ekosistemi.

Rreziqet e pranishme në Liqenin e Ohrit përfshijnë:

- ndikimet në cilësinë e ujit brenda pellgut të Liqenit të Ohrit;
- ndotje difuze, erozion dhe ndryshime në hidrologji nga bujqësia dhe pylltari e paqëndrueshme;
- presion mbi zonat e mbrojtura nga turizmi i paqëndrueshëm;
- prezantimi i specieve aloktone;
- ndryshimi i vendbanimeve dhe humbjet;
- peshkatari e paqëndrueshme, dhe
- ndryshime klimatike.

Efektet nga ndikimet / rreziqet në Liqen mund të përfshijnë shqetësime në cilësi, ndryshime në hidrologji, humbje të vendbanimeve dhe shumëllojshmërisë biologjike, etj., që mund të reflektohen në aspektet ekonomike dhe sociale. Veçanërisht e rëndësishme është të theksohet se këto rreziqe dhe efekte janë të pranishme në të gjithë liqenin (Shqipëria dhe Maqedoninë e Veriut).

Në tabelën 5 identifikon ndikimet dhe rreziqet që ndodhen në pellgun e Liqenit të Ohrit, shtrirjen e hulumtimit / detektimit të shkaqeve të këtyre dukurive dhe një përshkrim të faktorëve.

*Tabela 5. Ndikime/rreziqe, niveli i detektimit të faktorëve dhe përshkrimi i faktorëve*

| Ndikimet | Rreziqet kryesore | Detektimi i faktorëve | Përshkrimi i faktorëve |
|---|---|---|---|
| 1. Ndikimet në cilësinë e ujit në pellgun e Liqenit të Ohrit | Futja e nutrientëve | Mirë të njohura | Lumi Sateska dhe Liqeni i Prespës |
| | Futja e sedimenteve | Mirë të njohura | Degët e lumenjve më Liqenin e Ohrit<br>(Lumi Sateska dhe Koselska) |
| | Ujërat e zeza | Mirë të njohura | Sistem i kolektorëve i pambaruar dhe në gjendje të keqe;<br>Stacion i vjetruar dhe stacion i dimensionuar në mënyrë jo të duhur për pastrimin e ujërave të zeza në Vranishtë |
| | Ndotja nga metalet e rënda | Jomjaftueshëm të njohura | Lëshimi i ujërave të zeza nga industria dhe minierat në kontekst ndërkufitar |
| 2. Ndotje difuze, erozion dhe ndryshime në hidrologji nga bujqësia dhe pylltari e paqëndrueshme | Bujqësia intensive | Të panjohura | Pesticidet bioakumuluese tek peshqit |
| | Ujitja | Të njohura | SHM Lubanishtë – Uji për ujitje tek ky sistem merret me pompimin e ujit nga burimet e Shën Naumit |
| | Marrja e ujërave | Të njohur | Marrje të ujit për ujitje nga lumi Sateska që kanë ndikim në fondin e peshqve |

| Ndikimet | Reziqet kryesore | Detektimi i faktorëve | Përshkrimi i faktorëve |
|---|---|---|---|
| | Prerja e pemëve | Të panjohur | Prerja e paligjshme e pemëve në Velgoshtë |
| | Zjarre | Të panjohur | Zjarre të shkaktuara në mënyrë antropogjene në Galiçicë;<br>Djegia e rripit të kallamishteve |
| 3. Presion mbi zonat e mbrojtura nga turizmi i paqëndrueshëm; | Ndërtimi i shtëpive, vilave, hoteleve | Të njohur | Ndërtimi i vilave në infrastrukturën e zonave të mbrojtura në PK Galiçicë dhe ndërtimi i hoteleve në rripin e bregut si dhe mbajtjen e "Gjirit të Kockave" |
| | Rregullimi i plazheve | Mesatarisht të njohur | Ndërtime jokompatibile e prishin zonën e rripit të bregut të liqenit |
| | Sporte ujore | Mirë të njohur | Shkatërrimi i vendeve për shumimin e peshqve cipirinide<br>Rrjedha e naftës |
| | Ndotja | Mirë të njohur | Mbingarkimi i sistemit të kolektorëve dhe stacioni i pastrimit |
| 4. Prezantimi i specieve aloktone | Konkurrencë me llojet autoktone | Mesatarisht të njohur | Trofta e Kalifornisë është rrezik për troftën e Ohrit |
| | Ndryshime të popullsisë | Jo mjaftueshëm të njohur | *Elodea canadensis* në bashkësitë makrofite |
| 5. Ndryshimi i vendbanimeve dhe humbjet | Transformim të bregut të liqenit | Mirë të njohur | Fragmentimi i Moçalit të Studençishtës; urbanizimi në zonën e bregut të liqenit |
| | Fragmentim të vegjetacionit makrofit të bregut të liqenit | Mesatarisht të njohur | Rripi mikrofit në Peshtani dhe Tërpejcë |
| | Ndryshime dhe uzurpime të burimeve | Të njohur | Uzurpimi i burimeve të Shën Naumit (ndërtimi i objekteve hotelierike) si dhe marrja e ujit nga burimet për ujitje |
| | Mbyllja e burimeve | Mirë të njohur | Mbyllja e burimit Bej Bunar |
| | Eutrofikim | Jo mjaftueshëm të njohur | Ndryshimi i mikrobiofilmit dhe bashkësive algale posaçërisht në brigjet shkëmbore |
| | Peshkim i tepruar | Mirë të njohur | Peshkim i paligjshëm i troftës së Ohrit |

| Ndikimet | Rreziqet kryesore | Detektimi i faktorëve | Përshkrimi i faktorëve |
|---|---|---|---|
| 1. Peshkatari e paqëndrueshme | Lëshimi i llojeve të peshqve alohton dhe invaziv | Jo mjaftueshëm të njohur | Lloje aloktone të detektuara që janë kërcënim direkt për llojet autoktone të peshqve |
| 2. Ndryshime globale | Rritja e temperaturave mesatare | Jo mjaftueshëm të njohur | Eutrofikacion i intensifikuar i pasuar me anoksi në shumë pjesë të liqenit duke shkaktuar murtajë të peshqve |

### 6.3.1. Faktorët që ndikojnë në cilësinë e ujit në pellgun Liqenin e Ohrit

Lumi Sateska ka ndikim të vërtetuar negativ në vazhdimësi në cilësinë e ujit të Liqenit të Ohrit, si dhe në bashkësitë e kafshëve dhe bimëve që banojnë në litoralin e tij. 5.28% ose 53,96 km 2 të territorit janë të mbuluara me nivele të larta të erozionit (Blinkov dhe sor .2004) që kontribuon lumi Sateska për të deponuar më shumë se 100.000 m3/ sediment në vit. Në total prej 38.1 ton nga ky material është fosfori, i cili grumbullohet afër grykës së lumit. Sedimenti i akumuluar në Liqen e ndryshon plotësisht formën e literalit në grykëderdhjen e lumit (Fotografia 29).




*Fotografia 29. Mbartje të deponuara të lumit Seteska dhe ndryshimet zbatimet gjatë vitit (incizim satelitor nga Google Earth)*

Këto sasi të sedimenteve të grumbulluara nga gryka deri tek fshati Podmolje janë gjithashtu një kërcënim i madh për fondin e peshkut në Liqen, pasi që peshqit nuk i lëshojnë vezë, ndërsa sedimenti futet në gushat e peshqve të rinj dhe ata ngordhin.

**Liqeni i Prespës** mund të ndikojë në futjen e mundshme të fosforit në Liqenin e Ohrit përmes lidhjes hidraulike të kryqëzuar midis këtyre dy liqeneve (Fot. 30); fosfori i transportuar nga liqeni eutrofik mund të rrezikojë cilësinë e ujit në Liqenin e Ohrit (Matzinger et al., 2006a).




*Fotografia 30. Rrjedha uji nga Liqeni i Prespës dhe ujëra nga shirat që derdhen nga mali Galiçicë në Liqenin e Ohrit (Popovska dhe Bonaçi 2007)*

**Bujqësia** mund të jetë burim i ndotjes difuze me komponime të ndryshme kimike dhe metale të rënda. Gjatë prodhimit bujqësor përdoren kimikate të ndryshme që nuk janë të kontrolluara mirë. Hulumtimet e bëra tregojnë gjurmët e pesticideve të ndaluara që gjenden në mostrat e indeve të peshkut, që do të thotë se ato gjithashtu mund ta rrezikojnë shëndetin e njerëzve. Përdorimi i pakontrolluar dhe i tepërt i plehrave shkakton futje të nutrientëve dhe kështu edhe eutrofikim.

Cilësia e ujërave në Liqenin e Ohrit rrezikohet nga derdhja e drejtpërdrejtë e ujërave të zeza komunale, ujërave të zeza industriale që derdhen pjesërisht dhe në lumin Grashnica, nga sedimenti eroziv përmes lumit Sateska që gjithashtu përmban edhe ndotje organike nga shtresat e kalbura të tokës që përmbajnë plehra artificiale dhe mjete kimike për mbrojtje nga insektet.

**Ujërat e zeza** nga vendbanimet, industria dhe objektet turistike kryesisht grumbullohen me sistem grumbullimi dhe pastrohen në stacionin e pastrimit të ujërave të zeza Vrishta. 35% e ujërave të zeza të krijuara në zonën e Ohrit - Strugës nuk trajtohen ose derdhen direkt në liqen. Sistemi i kolektorit është i paplotësuar (Fotografia 31) dhe gjithashtu mirëmbajtja e tij j e duhur ka çuar në dëmtimin e tubave dhe pajisjeve, gjë që ndikon më tej në funksionalitetin e tij.




*Fotografia 31. Shkalla e lidhshmërisë së rrjetit të kanalizimit me Sistemin Kolektor (burimi: Studimi për mbledhjen e të dhëna për përmirësimin e mjedisit jetësor të Liqenit të Ohrit dhe mekanika për rehabilitimin e sistemit kolektor XHAJKA viti 2015)*

(RREZIQET PËR ZONËN E UNESCO-S NGA SISTEMI I PAMBARUAR)
(LEGJENDA)

(KOLEKTORI)

(KUFIRI I UNESCO-S)

Stacioni për pastrimin e ujërave të zeza është gjithashtu në gjendje të keqe dhe nuk mund të arrijë një nivel të kënaqshëm të trajtimit të ujërave të zeza. Pjesërisht ujërat e zeza të pastruar derdhen në lumin

Drini i Zi. Kapaciteti i stacionit nuk është i mjaftueshëm dhe kërkohet mbindërtim urgjent. E domosdoshme është të ndërtohen 44 km kanalizim dhe të rikonstruktohet stacioni i trajtimit të ujërave të zeza.

Në shumicën e vendbanimeve në zonat rurale përreth liqenit, nuk është ndërtuar asnjë sistem i kanalizimeve fekale dhe atmosferike. Gjatë reshjeve të dendura të shiut, vjen deri tek përzierja të ujërave të zeza fekale dhe atmosferike, dhe për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të sistemit të kanalizimit, vjen deri tek përmbytja e ujërave të zeza nga pusetat dhe kështu edhe deri tek përmbytja e vendbanimeve. Gjithashtu, gjatë rasteve të tilla vjen deri tek mbingarkimi i kolektorit të Sistemit për Mbrojtje të Liqenit të Ohrit, gjë që bën që ujërat e zeza të derdhen në liqen. Në Podmolje ujërat e zeza fekale e nxisin rritjen e kallamit por gjithashtu shkaktojnë ndotje të liqenit dhe erë të pakëndshme.

Mbeturinat e grumbulluara nga personat juridikë dhe familjet në Ohër nga Ndërmarrja Publike "Komunalec Ohër" depozitohen në deponinë komunale jostandarde Bukovo. Ajo funksionon që nga viti 1972; Sipërfaqja është 60,000 m 2 dhe ndodhet rreth 25 km nga qendra e Ohrit. Sipas Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave (2009-2015) kjo deponi konsiderohet me rrezik të lartë për mjedisin dhe për këtë arsye duhet të mbyllet më së voni deri në vitin 2020. Lumi Koselska mund të transportojë ndotje në Liqenin e Ohrit që mund të barten nga deponia "Bukovo" e cila nuk i plotëson standardet.

Peshkimi i paqëndrueshëm i liqenit zvogëlon rezervat e peshkut, me çka shumë specie të vlefshme rrezikohen, të tilla si trofta endemike e Ohrit ( Salmo letnica ).

Kapacitetet industriale në komunat e Ohrit dhe Strugës nuk prodhojnë një sasi të madhe të ujërave të zeza industriale. Në përgjithësi ujërat e zeza nga këto kapacitete derdhen në gropa septike. Prandaj, konsiderohet se ujërat e zeza nga industria nuk ushtrojnë presion të konsiderueshëm në cilësinë e ujërave të Liqenit të Ohrit.

Bilanci vjetor hidrologjik arrihet duke rregulluar derdhjen e lumit Drini i Zi dhe duke ia ndërruar rrjedhën lumit Sateska. Rrjedha e liqenit të Ohrit rregullohet në përputhje me lartësitë e harmonizuara të liqenit - minimumi natyror prej 693m l.M. dhe maksimum 694m l.M.

Megjithëse Liqeni i Ohrit është shpallur Trashëgimi Natyrore Botërore e UNESCO-s, ai me dekada përdoret si akumulues i gjenerimit të energjisë nga SH.A ELEM në bazë të lejes së marrë për ekonomizim me ujërat.

Kompania për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike SH.A ELEM është përgjegjëse për rregullimin e nivelit të ujit të Liqenit të Ohrit. Rregullimi i ujit bëhet duke lëshuar ujin nga liqeni në lumin Drini i Zi ku akoma përdoret me dorë me ndalesa prej druri.

Përgjatë lumit Drini i Zi ka dy hidrocentrale në territorin e RMV-së. , HC “ Shpilje” - Komuna e Dibrës dhe HC “Glloboçicë” afër Komunës së Strugës, dhe tre hidrocentrale në territorin e Republikës së Shqipërisë. Luhatje të mëdha në nivelet e ujit të liqenit, të cilat shpesh janë rezultat i menaxhimit jo të duhur, kanë efekte negative në ekosistemin e Liqenit të Ohrit për shkak të tërheqjes së ujit dhe ndikimet përkatëse mbi shumëllojshmërinë biologjike (Fotografia 32), respektivisht dalja e liqenit nga shtrati që ndodhë nga niveli i lartë i ujit dhe pastrimi i plehrave dhe pesticideve nga zonat bujqësore.



*Fotografia 32. Dukja e Liqenit të Ohrit kur niveli është nën kotën minimale të lejuar natyrore (majtas) dhe mbi kotën e maksimale të lejuar natyrore (djathtas)*

Të dhënat e luhatjes së nivelit të ujit në Liqenin e Ohrit për periudhën 1951–2000 (Popovska dhe Bonicci 2007) tregojnë ndryshime të nivelit prej 1.6 m, ku lartësia e liqenit lëviz midis 693.0 m dhe 694.6 m mbi nivelin e detit. dhe lartësia mesatare prej 693.5 m mbi nivelin e detit.

Nivelimi i liqenit për herë të fundit është bërë në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, gjë që tregon qartë nevojën për një analizë tjetër. Me riorientimin e shtratit të lumit Sateska në Liqenin e Ohrit, kanë ndryshuar lëkundjet natyrore të ujit në liqen për rreth 50 centimetra. Kotat që janë vendosur në fillim të viteve 1960 duhet të rishikohen, pasi ajo të njëjtat në periudhën e kaluar kanë mundur të ndryshojnë me çka nuk dihet efekti nga ndryshimet e mundshme. Gjithashtu, nevojitet të rishikohet edhe marrëveshja me Shqipërinë për lëshimin e një sasie të caktuar të uji për nevojat e saja energjetike.

Për nevojat e Vlerësimit preliminar të rrezikut nga përmbytja për pellgun e lumit Drin / Drin-Buna / Bojana [1] (në kuadër të projektit "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në menaxhimin ndërkufitar me rrezikun nga përmbytja për Ballkanin Perëndimor", GIZ, Eschborn, Germany), janë bërë modelime hidrologjike të përmbytjes së rajonit nga ujërat sipërfaqësorë (Fot. 33), përmbytje nga ujërat nëntokësore dhe përmbytja e bregut të liqenit (Fot. 34).



*Fotografia 33. Modelim hidrologjik i përmbytjes nga ujërat sipërfaqësore*



*Fotografia 34. Modelim hidrologjik i përmbytjes nga ujërat nëntokësore (majtas) dhe përmbytja e bregut të liqenit nga rritja e nivelit të ujit (djathtas)*

Niveli i liqenit paraqet një faktor thelbësor për gjendjen e **Moçalit të Studençishtës**. Nuk ka dyshim se ujërat e Moçalit komunikojnë me Liqenin dhe pikërisht niveli i Liqenit është rregullator i nivelit të ujërave nëntokësore në këtë Moçal. Është e vërtetë se nivelet e larta të ujit të Liqenit krijojnë një barrierë më të madhe për derdhjen e ujit në të dhe rrisin nivelin e ujërave nëntokësorë në Moçal, ndërsa gjatë nivele të larta të ujit, siç ishte në vitin 1963 dhe në pranverën e vitit 2010, ai bëhet pjesë përbërëse e Liqenit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbijetesa e Moçalit në përgjithësi përbëhet pikërisht nga ajo se si do të ndërtohet lidhja me Liqenin, respektivisht se si do të zgjidhet komunikimi i vazhdueshëm i ujërave të Moçalit me ujërat e Liqenit.

**Ujitja:** ujërat nga degët e Liqenit të Ohrit dhe nga burimi i Shën Naumi përdoren edhe për ujitje.Ujitja e zonave në rajonin e Ohrit bëhet përmes hidrosistemeve të mëposhtme:

7. Sistemet hidromeriolative (SHM) me rrjedha natyrore dhe lumenj

- SHM Leskovec
- SHM Kosel - Lakoçerej
- SHM Velmej
- SHM Leshani
- SHM Sateska (Volinë, Mesheishtë)

2. Sistemi i pompimit të ujit
   - SHM Lubanishtë

3. Sistemi për ujitje me akumulim artificial
   - SHM Slatinë

SHM Labunishtë përdor ujin e ujitjes që merret nga pompimi i ujit nga burimet e Shën Naumit. Uji nxirret në një lartësi prej 15 metrash, dhe më pas ujitja bëhet me anë të gravitetit. Pompimi i ujit për ujitje përbën rrezik për ruajtjen e opulentit dhe vlerën e këtyre burimeve.

## 6.4. Faktorët që rrezikojnë trashëgiminë kulturore dhe vlerat arkitekturore urbane

Trashëgimia kulturore paraqet një komponent të rëndësishëm në vlerat e përgjithshme të rajonit të Ohrit. Ndërtimet arkitekturore të njohura që përbëjnë matricën urbane të qendrave të qyteteve, shtresat e periudhave historike konfirmojnë rolin e trashëgimisë kulturore të patundshme dhe nevojën për mbrojtjen e duhur të saj. Por, edhe krahas numrit të madh të ndërtesave ku janë bërë ndërhyrje të nevojshme për konservim-restaurim, ende ndeshemi me një numër faktorësh që e rrezikojnë trashëgiminë kulturore:

7. Valorizimi jo profesional i zonës dhe mungesa e studimeve për mbrojtjen e trashëgimisë ndërtimore për të gjitha vendbanimet (ka përfunduar valorizimi dhe rivlerorizimi i shumicës së

objekteve të profilizuara, objekteve fetare në territorin e komunave të Ohrit, Strugës dhe Debërcës).

8. Njohuri dhe studime të pamjaftueshme të zhvillimit historik të rajonit, respektivisht, karakteristikat e epokave historike që ndikuan në pamjen dhe kushtëzuan shndërrime të shumta të hapësirës që ndikuan negativisht në mundësinë për të njohur vlerat dhe potencialet;
9. Ndërgjegjësimi i përgjithshëm i pamjaftueshëm për vlerat dhe potencialet e hapësirës në tërësi, si dhe niveli i pamjaftueshëm i vetëdijes për vlerat arkitektonike dhe artistike të ndërtimit dhe trashëgimisë tjetër kulturore;
10. Ndërtimi i një numri të madh objektesh në bregun e Liqenit të Ohrit që çon në një ndryshim të vazhdueshëm të strukturës ekzistuese të vendbanimeve rreth bregut, vetë peizazhit dhe vijës së bregut të liqenit;
11. Mos adaptimi i koncepteve të zhvillimit të degët individuale ekonomike me potencialet hapësinore të rajonit të Ohrit dhe me kufizimet që përcaktojnë kriteret për mbrojtje (trafiku dhe infrastrukturë tjetër, komplekse të mëdha turistike, reparte prodhuese, impiante të ndryshme dhe objekte, stacione, depo);
12. Mospërputhja e mjeteve standarde të planifikimit për përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë së ndërtimit me kriteret e përcaktuara për mbrojtje;
13. Trajnim i pamjaftueshëm dhe numër i pamjaftueshëm profesional për të realizuar planifikimin, hartimin dhe ekzekutimin e ndërtimeve dhe punëve të tjera në rajonin e Ohrit për sa i përket njohjes dhe integrimit të mekanizmave të mbrojtjes së trashëgimisë;
14. Mungesa e përfitimeve ose ndonjë lehtësim dhe ndihmë për pronarët / përdoruesit e sanimit, restaurimit dhe konservimit të objekteve të tyre;
15. Staf i pamjaftueshëm profesional për të kryer punën në teknika tradicionale, teknike.
16. Personeli i pamjaftueshëm profesional për të realizuar punën e studimeve, konservimeve, restaurimeve dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.
17. Mosekzistimi i burimeve të përhershme dhe të sigurta të mjeteve dhe mënyrave të vazhdueshme të financimit të mbrojtjes dhe përmirësimit të gjendjes së ndërtimtarisë dhe trashëgimisë tjetër kulturore.

### 6.4.1. Urbanizimi dhe objektet e ndërtuara pa leje

Urbanizimi i rajonit të Ohrit ka filluar në mesin e shekullit të 20-të, ndërsa urbanizimi është intensifikuar në pjesët e reja të qyteteve dhe komplekseve turistike në pjesën e bregut të liqenit; qendrat historike me ndryshime më të mëdha ose më të vogla a shumë mbeten në kontekstin e tyre historik dhe peizazhin kulturor ekzistues.

Urbanizimi i tepruar dhe i pakontrolluar ndikon negativisht në ruajtjen e: strukturës së qendrave të vjetra të qytetit të Ohrit dhe Strugës me arkitekturën e vjetër të qytetit, strukturën e vendbanimeve të bregut të liqenit dhe zonat e tjera ku gjenden të mirat kulturore.

Gjatë periudhave të ndryshme kohore nga viti 2000 e këndej, intensiteti i ridestinimit të produktivitetit në tokë ndërtimore ndryshon në varësi të mundësive për zhvillim hapësinor që janë në korrelacion me ndryshimin e dispozitave të Ligjit për Planifikim Urban Hapësinor dhe aktet përkatëse nënligjore.

Ndryshimi i përdorimit të tokës në rajonin e Ohrit sipas periudhave, sipas CORINE Land Cover (CLC) [17] është paraqitur në fotografinë 35.




*Fotografia 35. Ndryshimi i shfrytëzimit të truallit (Burimi: [www.land.copernicus.eu/pan-european/corine-land-cover](www.land.copernicus.eu/pan-european/corine-land-cover))*

**(111. Zona të vazhdueshme urbanistike, 112. Zona urbanistike pa vazhdimësi, 121. Njësi industriale ose komerciale, 122. Rrjete hekurudhore dhe rrugore dhe truall i bashkëngjitur, 123. Porte, 124. Aeroporte, 131.Zona për ekstraktimin e mineraleve, 132. Deponi, 211. Truall i punueshëm i pa ujitur, 212. Truall i përhershëm i ujitur, 213.Zona të orizit, 221. Vreshta, 222.Pemë dhe të mbjella, 223.Kopshte me ullinj, 231.Kullota, 241.Kultura vjetore të lidhura me kulturat e vazhdueshme, 242.Modele komplekse të kultivimit, 243.Truall i nxënë kryesisht me bujqësi, zona të rëndësishme me vegjetacion natyror, 244.Zona Agro-pyjore, 311.Pyje me gjethe të gjëra, 312.Pyje mëtrike, 313. Pyje të përzier, 321.Lëndina natyrore, 323.Vegjetacion sklerofil, 324 Pyje natyrore – shkurre, 331.Plazhe, dunë, rërë, 332.Shkëmbinj të zhveshur, 333.Zona me vegjetacion të rrallë, 334. Zona të djegura.)**

Rritja e mbulimeve urbane përmes shndërrimit të tokës prodhuese në tokë ndërtimore është caktuar për seritë kohore (2000-2006; 2006-2012; 2012-2018).Në periudhën 2000-2006 vihet re se një përqindje e madhe e tokës në komunën e Strugës është shndërruar në tokë urbane të ndarë (sipas klasifikimit CLC e nënvizuar me ngjyrë të kuqe), si dhe në tokë bujqësore të ujitur (e shënuar me ngjyrë të verdhë).

Përveç shndërrimit të tokës për qëllime urbanizimi, karakteristike është rritja e dendësisë së popullsisë, respektivisht përqindja e ndërtimeve. Ndryshohet pamja dhe tiparet tradicionale të arkitekturës në zonat urbane.

---

[17] Corine Land Cover është inventar për qëllim të shfrytëzimit të truallit të klasifikuara në 44 klasa. [https://land.copernicus.eu/pan-european/corine-land-cover](https://land.copernicus.eu/pan-european/corine-land-cover)

Është analizuar transformimi i bregut të liqenit për periudhën 2012-2018 duke vëzhguar ndryshimet me imazhet satelitore në lidhje me ndërtimin e objekteve përskaj bregut dhe vendosja e platformave në liqen, si dhe ndryshime (ulje) të zonës së kallamishteve.

Probleme më të mëdha me rritjen e urbanizimit në zonën e bregut të liqenit paraqiten me ndërprerjen e rëndësisë të **Planit të Përgjithshëm Urbanistik për Zonën e Bregut të Liqenit të Komunës së Ohrit**, e cila u shfuqizua në vitin 2005 me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe Urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 51/05), ku për herë të parë është përcaktuar që **Planet e Përgjithshme Urbane miratohen vetëm "për Qytetin e Shkupit dhe qytetet që janë selia e komunave"** .Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të këtij ligji theksohet se Planet e Përgjithshme Urbanistike për komplekse tregtare dhe komplekse të tjera të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen si Plane Urbanistike jashtë vendbanimeve (dhe të njëjtit do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afatit prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të tij).

Më vonë, me miratimin e Ligjit për Planifikim hapësinor dhe Urbanistik të vitit 2009 (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 91/09), erdhi deri tek rritja edhe më e madhe e urbanizimit, e mundësuar nga llojet e dokumentacionit urbanistik si: Dokumentacion Lokal Urbanistik Planifikues, si dhe Dokumentacion Urbanistik Planifikues për zona zhvillimore turistike, Dokumentacionin Urbanistik Planifikues për autokampe etj. Me këtë lloj të dokumentacionit planifikues, dhe në veçanti me Dokumentacionin Urbanistik Planifikues për ndërtime me interes të veçantë, të paraqitura me ndryshimet dhe plotësimet e zgjidhjes ligjore të vitit 2014, (Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Urbanistik Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 199/14), **janë një fragmentim i planifikimit** , sepse planet mund të përpiloheshin dhe miratoheshin pa ndonjë përcaktim paraprak të një kornize të zhvillimit hapësinor të një niveli më të lartë. Neni 50 ( Dokumentacioni Urbanistik Planifikues për ndërtimet me interes të veçantë) më vonë u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese në një seancë të mbajtur më 5 korrik të vitit 2017, por dokumentet e planifikimit të qyteteve të tilla si: Dokumentacionet urbanistike të llojit; dokumentacion lokal urbanistik dhe planifikues shtetëror; dokumentacion urbanistik planifikues për zona zhvillimore turistike; dokumentacion urbanistik planifikues për autokampe dhe dokumentacion urbanistik planifikues për ndërtimet me interes të veçantë, janë ende në fuqi, me Ligjin ekzistues për Planifikim Hapësinor dhe Urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193 / 15.31 / 16, 163/16 dhe 64/18).

Veçanërisht problem të madh shkaktoi Ligji për Veprim me Objektet e Ndërtuara në mënyrë të Paligjshme (i cili pa përjashtim vlen për të gjithë territorin e shtetit) të vitit 2011 ("Gazeta Zyrtare e RM-së " nr. 23/11) me të cilin jo vetëm që është mundësuar legalizimi i ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, por njësitë e vetëqeverisjes lokale ishin përgjegjëse për përfshirjen e tyre në dokumentacionin përkatës të planifikimit, ndërsa me ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 23/11, 54/11, 155/12, 53/13, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15, 31/16 dhe 190/17 ), afatet e legalizimit vazhdimisht shtiheshin, kështu që me ndryshimin e fundit të vitit 2017, parashtrimi i kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të një objekti të paligjshëm është definuar deri më 31.12.2018.

## 6.5. Rreziqe të tjera për ruajtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit

Sistemi për menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit bazohet në kornizë adekuate ligjore dhe institucionale, e cila vazhdimisht po rishikohet dhe përmirësohet. Megjithatë, përkundër faktit që ekzistojnë mekanizma mbrojtës juridik dhe institucional, tiparet e trashëgimisë

natyrore dhe kulturore përkeqësohen për shkak të ndikimeve nga faktorët natyrorë dhe antropogjenikë, si për shembull:

1. Ndërtohen ose planifikohen ndërtime në zonën e bregut të liqenit, gjë që mund ose të çojë në përkeqësimin e hidrologjisë, cilësisë së ujit të liqenit, shumëllojshmërisë biologjike, vlerave të peizazhit dhe të reflerktohet negativisht në ruajtjen e: arkitekturës së vjetër të qytetit, strukturës së vendbanimeve nga vija e bregut të liqenit, struktura e qendrave të vjetra të qytetit të Ohrit dhe Strugës dhe zonave përreth me monumente historike.
2. Me ndërtimin e objekteve të reja nuk mbahet llogari për ruajtjen e tipareve vizuale dhe vlerave arkitektonike; nga ana tjetër, nuk kihet kujdes për objektet individuale të trashëgimisë kulturore të patundshme.
3. Disa prej vendbanimeve nuk janë të lidhura me sistemin e kolektorit, kolektori dhe stacioni i pastrimit të ujërave të zeza janë në gjendje të keqe për shkak të mirëmbajtjes jo përkatëse dhe vjetrimit.
4. Në mënyrë joadekuate veprohet me mbeturinat, në kuptimin e grumbullimit joefikas nëpër vendbanime, respektivisht pastrimin e mbeturinave në deponinë "Bukovo" në mënyrë që është e dëmshme për mjedisin.
5. Trafiku i dendur (sidomos gjatë sezonit turistik) shkakton bllokim, ndotje dhe ndikon negativisht në vlerat ambientale në qytetet e Ohrit dhe Strugës.
6. Për shkak të infrastrukturës së planifikuar rrugore, hekurudhore, të gazit dhe energjisë mund të ndodhë fragmentimi i vendbanimeve dhe shkatërrimi i vlerave natyrore etj.
7. Turizmi masiv në zonat e mbrojtura mund të bëjë presion mbi vlerat e rajonit.

### 6.5.1. Objektet infrastrukturore

Brenda kufijve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit është planifikuar ndërtimi i infrastrukturës së linjës edhe atë:

- Hekurudha Kërçovë - Ohër (kufiri me R. Shqipërisë)
- Autostrada A2, seksioni Trebenishtë-Strugë
- Largpërçues mbitokësor interaktiv 400 kV TS Manastir 2 - Kufiri Maqedonaso-Shqiptar dhe TS 400/110 kV Ohër
- Sistemi Kombëtar të Gazifikimit, seksioni Ohër-Strugë

Nevoja për të realizuar këtë lloj të infrastrukturës është e padiskutueshme, por trasetë, teknologjitë e zbatuara të realizimit dhe mirëmbajtjes, mund të ndikojnë negativisht në vlerën e jashtëzakonshme universale të të mirave (Fotografia 36).




*Fotografia 36. Ndikime/rreziqe nga projektet e planifikuara infrastrukturore*

(400 kv Largpërçuesi Manastir – Elbasan traseja TS Ohër) (Gazsjellësi traseja Ohër – Strugë projekt i ideuar) (Autostrada A2 seksioni Trebenishtë – Strugë) (Hekurudha Kërçovë – Lin kufiri me R. Shqipërisë)

**Linja hekurudhore Kërçovë-Lin** (kufiri me R. Shqipërisë) është përzgjedhur në fazën e studimit parafizibilitative bazuar në kriteret teknike, të trafikut, të eksploatimit dhe kriteret ekonomike, pa analizuar paraprakisht kriteret mjedisore dhe sociale.Janë marrë parasysh dy alternativa (fotografia 37):

- **1 SA 1** - me çka lidhja me R.Shqipërisë arrihet përmes një tuneli të gjatë (ku minimizohen ndikimet mbi shumëllojshmërinë biologjike dhe peizazhin) dhe në distancë më të lartë nga bregu i liqenit (kështu që ndikimet në cilësinë e ujërave të liqenit minimizohen) dhe

- **1 SA 2** - e dyta, me anë të së cilës traseja e hekurudhës afrohet drejt bregut të liqenit, në të njëjtën kohë u lëshuar rrëzë malit Jabllanica (e cila është potencialisht Naturë zona 2000).




*Fotografia 37. Trase të analizuara të hekurudhës Këçovë – Lin*

Gjatë zbatimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisin Jetësor, traseja drejt tunelit nuk është rishikuar; nga dy zgjidhjet alternative (zero alternativë që mos të ndërtohet dhe trase alternative 1 SA 2 e cila lëshohet rrëzë malit të Jabllanicës dhe i afrohet liqenit ) nuk jepet mundësi për zgjidhje objektive, respektivisht kriteret ekologjike nuk përputhen me rëndësinë teknike dhe financiare. Traseja e zgjedhur, së bashku me rrugën Strugë-Qafë Thanë , mund të shkaktojnë prishje të peizazhit dhe përgjithmonë ta çrregullojnë vlerën e jashtëzakonshme universale të mjedisit. Prandaj, para se të vendoset përfundimisht për zgjedhjen e trasesë së hekurudhës që do të financohet nga fondet evropiane (IPA), është e nevojshme të merret në konsideratë një alternative që përmes tunelit e kalon kufirin me Shqipërinë. Rishikimi i të paktën edhe një alternative (e cila do ta përfshijë edhe propozimin e ICOMOS të dhënë gjatë misionit reaktiv në prillit të vitit 2017) mbetet një detyrim që duhet të përmbushet para paraqitjes së raportit në Komitetin e Trashëgimisë Botërore në shkurt të vitit 2020.

Për **autostradën A2, seksioni Trebenishtë-Struga** : është bërë vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor (VNMJ) ndërsa me kërkesë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), janë përgatitur edhe:

- Vlerësimi i shumëllojshmërisë biologjike (Biodiversity Assessment)

- Plan për vlerësimin e ndikimit mbi trashëgiminë kulturore (Heritage Impact Assessment Report)

# BLERIM

Gjatë procesit të përzgjedhjes së lokacionit të trasesë së Autostradës A2 (Korridori Evropian VIII, segmenti rrugor Trebenishtë-Strugë), në studimin e VNMJ-së janë shqyrtuar 3 zgjidhje alternative (alternative nulta - mos të ndërtohet, traseja alternative e majtë dhe e djathtë). Gjatë zgjedhjes së trasesë së fundit, janë marrë parasysh kriteret teknike, ekonomike dhe ekologjike. Nga aspekti i ruajtjes së të mirës, traseja e fundit (e djathtë) paraqet variant më të favorshëm se varianti i majtë i shqyruar, i cili është i pafavorshëm për shkak të afërsisë së Liqenit të Ohrit dhe Lumit të Sateskës, që mund të ndikojë mbi ndotjen e ujërave në rajon që është ekosistemi më i ndjeshëm. Në mënyrë plotësuese, parashihen një numër i mjaftueshëm i kalimeve të kafshëve në rrugë. Në këtë mënyrë, në tërësi është zbatuar rekomandimi i UNESKO-s (fotografia 38).




(LEGJENDA:

Kufiri i përfshirjes së planit

Autostrada e sapoprojektuar

Rrugë rajonale

Rrugë lokale

Urë

Mbikalim

Nënkalim)

*Fotografia 3. Trasetë e shqyrtuara alternative të segmentit rrugor Trebenishtë-Strugë (Burimi: VNMJ për projektin)*

Studimi i VNMJ-së dhe aspektet sociale: largpërçuesi mbitokësor 400 kV interkonektiv TC Manastir 2 - Kufiri Maqedoni-Shqipëri TC 400/110 kV Ohër.

Gjatë përzgjedhjes janë marrë parasysh dy korridoret kryesore strategjike alternative të largpërçuesit.

- Korridori alternativ 1 i largpërçuesit kalon nëpër seksionin e gjatë 11 km nëpërmjet zonave qendrore të PK Galiçicë, i identifikuar gjithashtu si Zona Emerald (në të ardhmen NATURA 2000). Projekti i propozuar i largpërçuesit nuk është në pajtim me statusin e rajonit të mbrojtur - PK Galiçicë.
- Korridori alternativ 2 i largpërçuesit kalon nëpër pjesën veriore periferike të rajonit të shpallur trashëgimi natyrore dhe kulturore botërore nga ana e UNESKO-s - Rajoni i Ohrit, larg zonës së vlerave kryesore natyrore dhe Liqenit të Ohrit. Zona në fjalë kryesisht përbëhet nga toka të punueshme, kullota dhe pyje të përkohshme dhe vendbanime periferike që gravitojnë drejt qytetit të Ohrit dhe qytetit të Strugës dhe i shmanget çfarëdo ndikimi mbi vlerat natyrore ose statusin e tyre të mbrojtur. Korridori alternativ 2 i largpërçuesit u shmanget të gjitha kategorive të zonave të mbrojtura në Ohër, duke përfshirë PK Pelister dhe PK Galiçicë.

Në zonën e lidhjes me Shqipërinë, janë analizuar dy variante (nën-korridore) të korridorit alternativ 2 të largpërçuesit:

- Nën-korridori 2A: korridori i largpërçuesit që kalon në Shqipëri në vendin Qafë Thanë afër vendkalimit kufitar ekzistues. Ai kalon në zonën periferike juglindore të PK-së së propozuar Jabllanicë në përafërsisht 2 km seksionin e gjatë. Zona është e urbanizuar dhe përfshin ndërhyrje të shumta të shkaktuara nga njeriu: vendbanime, rrugë, objekte banimi dhe komerciale, etj. Prandaj, me siguri nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme mbi PK-në e propozuar.
- Nën-korridori 2B: korridori i largpërçuesit që kalon në Shqipëri përmes Malit të Jabllanicës. Ky nën-korridor kalon nëpër zonën qendrore të PK-së së propozuar Jabllanicë në përafërsisht 5 km seksionin e gjatë. Me siguri do të ketë ndikime të konsiderueshme mbi vlerat ekologjike dhe të zonës së PK-së së propozuar. Ky opsion kalon në lartësi mbidetare më të madhe se 1.500 m l.m. duke e bërë qasjen dhe ndërtimin shumë të vështirë, si edhe kontrollin dhe mirëmbajtjen operative.

Varianti 2B i korridorit të largpërçuesit (pika e lidhjes me Shqipërinë në vendin Qafë Thanë, i cili u shmanget zonave qendrore të Malit të Jabllanicës) konsiderohet si alternativa më e favorshme për largpërçuesin e propozuar.

Traseja e gazsjellësit Kërçovë-Strugë-Qafë Thanë dhe Prilep-Manastir-Ohër nuk është përcaktuar ende. Gjatë përkufizimit të tij duhet të merren parasysh ndikimet kumulative me infrastrukturën tjetër dhe strukturat e tjera antropogjene.

Të gjitha kërcënimet e mundshme për zonën janë paraqitur në fotografinë 39/




(KËRCËNIMET E ZONËS SË UNESKO-S

Liqeni i Ohrit

LEGJENDA

Kallami i shkatërruar

Aktivitetet bregdetare

Aktivitetet ndërtimore në ujë

Deponitë

Lumi i Sateskës

Vija hekurudhore

Kolektori

Gazsjellësi

Autostrada

Largpërçuesi

Kufiri i UNESKO-s)

*Fotografia 4. Rreziqet e mundshme për vlerat e jashtëzakonshme universale*

### 6.5.2. Objektet e sapondërtuara në qendrat e vjetra të qytetit

Në Rajonin e Ohrit, urbanizimi modern i zë hapësirat e lira pranë bregut të liqenit, si dhe mbushjen e sipërfaqeve të gjelbra të lira në qendrat e vjetra të qytetit të Ohrit dhe Strugës. Kryesisht ndërtohen shtëpi individuale familjare, shpeshherë janë me dimensione dhe lartësi joadekuate dhe formë arkitektonike të papërshtatshme. Me këto ndërtesa ndryshohet silueta e njohur e qyteteve dhe rrezikohen tiparet e qendrave urbanistike. Kjo çon në prishjen e organizatës hapësinore burimore në kuadër të tërësive tradicionale.

Ndjeshmëria e trashëgimisë kulturore është rritur me humbjen e përhershme të tipareve origjinale të elementeve të veçanta, veçanërisht me:

1. Zëvendësimin e të ashtuquajturës tjegulla e vjetër turke me materiale të tjera për mbuluesit e çatisë;
2. Ndryshimin e pamjes së dritareve dhe dyerve, me ç'rast zdrukthtaria e drurit zëvendësohet me atë të plastikës ose aluminit, duke ndryshuar në mënyrë drastike arkitekturën e objekteve; Përdorimi i materialeve të reja të ndërtimit në realizimin e katit përdhes tradicional prej guri të objekteve, me çka humbet pamja autentike tradicionale e mureve dhe prishet ambienti origjinal;
3. Përdorimin e nuancave të ndryshme gjatë përpunimit të fasadave të objekteve (në vend të ngjyrës karakteristike të bardhë) nga pronarët privatë, si dhe shfrytëzimi i materialeve të ndryshme të papërshtatshme për arkitekturën ekzistuese pa përdorimin e elementeve horizontale dhe vertikale prej druri;
4. Mosrespektimin e formës arkitektonike karakteristike të masave të lëvizshme të mureve ku ndërtimet zakonisht përfundojnë ose me një strehe të zgjatur prej druri ose me një strehe të profilizuar, e cila e pasuron arkitekturën e objektit dhe mbi të cilën drejtpërdrejt fillon konstruksioni i çatisë dhe mbulesa e çatisë;
5. Ndryshimin e shtrimit të pllakave në sheshet dhe rrugët, me materiale të reja bashkëkohore të ndërtimit që nuk përshtaten në ambientin origjinal;
6. Panot e reklamave dhe elementet e tjera të pajisjeve urbane (duke i përfshirë edhe kontejnerët e mbeturinave të vendosura në qendrat e vjetra të qytetit) i shtrembërojnë pamjet drejt objekteve dhe në këtë mënyrë i prishin edhe vlerat ambientale dhe estetike të të mirave;

Faktorët e rrezikut që kontribuojnë në rënien, përkatësisht humbjen e vlerave të trashëgimisë kulturore janë edhe:

1. Rritja demografike dhe migrimi i popullsisë nga zonat rurale në qendrat urbane, që çon në ndryshimet sociale dhe prishjen e qendrave historike ku ndërtesat marrin funksion komercial, ndërsa banesat dhe hapësirat e banimit shpesh janë të mbingarkuara;
2. Rritja e përdorimit të komunikacionit motorik dhe depërtimi i tij në pjesët në të cilat asnjëherë nuk ishte planifikuar përdorimi i automjeteve që prodhojnë ndotje atmosferike dhe dridhje destruktive;
3. Ndërtimi i ndërtesave të larta të cilat "ua zënë frymën" qendrave historike urbane, duke e ndryshuar edhe mikroklimën e tyre;
4. Ndryshimi i llojit dhe vëllimit të aktiviteteve komerciale që ndikojnë mbi funksionet ekonomike të zonës historike;
5. Mosmirëmbajtja e ndërtesave të vjetra dhe keqkuptimi i vlerave të tyre kulturore dhe funksionale, gjë që e rrit rrezikun e shembjes dhe prishjes;
6. Transformimet e shumta në hapësirë që ndikojnë negativisht mbi mundësinë për t'i njohur vlerat dhe potencialet;
7. Ndërgjegjësimi i përgjithshëm i zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme për vlerat dhe potencialet e hapësirës në tërësi, si dhe niveli i pamjaftueshëm i vetëdijes për vlerat arkitektonike dhe artistike të trashëgimisë së ndërtimit dhe trashëgimisë tjetër kulturore;
8. Ndërtimi i një numri të madh objektesh përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit që çon në ndryshimin e vazhdueshëm të strukturës ekzistuese të vendbanimeve dhe peizazhit bregdetar;
9. Mospërshtatja e koncepteve të zhvillimit të degëve të caktuara ekonomike me potencialet hapësinore të Rajonit të Ohrit dhe me kufizimet që i përcaktojnë kriteret për mbrojtje (infrastruktura e komunikacionit dhe infrastruktura tjetër, komplekset e mëdha turistike, repartet e prodhimit, stabilimentet dhe objektet e ndryshme, stacionet, magazinat, depot);
10. Mospërshtatja e instrumenteve standarde të planifikimit për përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë së ndërtimit me kriteret e përcaktuara për mbrojtje;
11. Trajnimi i pamjaftueshëm dhe numri i pamjaftueshëm i kuadrove profesionale për kryerjen e punëve rreth planifikimit, hartimit dhe kryerjes së punëve ndërtimore dhe punëve të tjera në Rajonin e Ohrit nga aspekti i njohjes dhe integrimit të mekanizmave për mbrojtjen e trashëgimisë, si dhe numri i pamjaftueshëm i kuadrit profesional për kryerjen e punimeve në teknikat tradicionale, artizanale.

# 7 Vizioni dhe qëllimet e mbrojtjes

## 7.1 Vizioni

Rëndësia e vlerave natyrore dhe kulturore të së mirës është ngulitur thellësisht në traditën dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale, por edhe të qytetarëve në të gjithë shtetin.

Për shkak të vlerave urbanistike-arkitektonike dhe natyrore të Rajonit të Ohrit, zhvillimi hapësinor do të udhëhiqet nga parimet e mbrojtjes së integruar, përkatësisht respektimi i modeleve tradicionale urbanistike për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, peizazhin kulturor të Rajonit të Ohrit dhe gjithë integritetin e tij, si dhe vendosjen e ekuilibrit midis nevojave të jetës moderne dhe ruajtjes së vlerave tradicionale dhe universale.

Duke i pasur parasysh proceset e urbanizimit që ndikojnë ose mund të ndikojnë mbi trashëgiminë natyrore dhe kulturore, në territorin e të mirave të mbrojtura do të vendosen zona të përshtatshme të mbrojtura. Këto zona të mbrojtura dhe regjimet e duhura të mbrojtjes do të sigurojnë kthimin e plotë në afat të mesëm dhe afat të gjatë të funksionimit të bregut të liqenit.[18]

Rajoni i Ohrit si trashëgimi botërore do të paraqes destinacion tërheqës për të gjithë. Prandaj, me konsensus të gjerë të të gjithë faktorëve, kujdes i veçantë do të merret për t'i afirmuar dhe kultivuar vlerat kulturore, multikulturalizmin e tyre, manifestimet e shumta kulturore tradicionale, gjendjen shpirtërore dhe karakteristikën e lashtë. Zanatet e vjetra do të rikthehen dhe përsëri do të gjallërohen.

Për shkak të vlerave unike natyrore të Rajonit të Ohrit, me një kujdes të madh do të planifikohet dhe realizohet mbrojtja dhe ruajtja e gjeodiversitetit dhe biodiversitetit të saj. Nëpërmjet marrjes së masave për t'i mbrojtur llojet dhe habitatet e përfshira në listat kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtje, do të sigurohet stabiliteti i ekosistemeve.

Rajoni i Ohrit do të vazhdojë të jetë një vend aktiv dhe vend i gjallë që me mençuri do ta përdor statusin e vet të trashëgimisë botërore të UNESKO-s për njohjen dhe tërheqjen e tij të gjerë si vlerë unike kulturore dhe natyrore.

Vlera e jashtëzakonshme universale e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit do të bëhet pikënisja për krijimin e urave të bashkëpunimit me vendet fqinje, si dhe me vendet nga rajoni më i gjerë.

## 7.2. Qëllimet

Realizimi i Vizionit të Planit për menaxhim është i mundur vetëm me realizimin e këtyre qëllimeve të përgjithshme:

1. Urbanizimi i kontrolluar;
2. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore;
3. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore;
4. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik që nuk është në kundërshtim me vlerën e jashtëzakonshme universale të së mirës së mbrojtur;
5. Përforcimi i aftësive drejtuese të institucioneve kompetente;
6. Ndërgjegjësimi dhe edukimi;

---

[18] Bregu i liqenit, nëse është në gjendjen e tij natyrore (me një shkallë të lartë funksionaliteti), mund t'i kryejë funksionet e tij pozitive në biodiversitetin dhe cilësinë e ujit të liqenit, siç janë: filtrimi i sedimentimit dhe ndotjes; mbrojtja nga erozioni; heqja e nutrientëve; kontrolli i temperaturës së ujit; formimi dhe mirëmbajtja e habitateve natyrore; mbrojtja dhe mirëmbajtja e vlerës së lartë të zonës, të formuar nga atributet natyrore dhe kulturore që kanë vlerë historike.

# 8 Zonimi dhe masat e mbrojtjes në kufijtë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit

## 8.1. Nevoja nga vendosja e zonave të mbrojtura në kuadër të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit

Plani parashikon që zhvillimi i ardhshëm hapësinor i Rajonit të Ohrit të orientohet në vlerën e tij të jashtëzakonshme universale. Në këtë mënyrë, zonimi kryhet me masat e përcaktuara për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në secilën zonë. Me zbatimin e sistemit të vlerave dhe vendosjen e marrëdhënieve ndërmjet ekuilibrit ekologjik, social dhe ekonomik, janë përcaktuar kriteret e zonimit.

### 8.1.1 Karakteristikat e vlerave si bazë për zonimin

Kriteret për zonimin e trashëgimisë natyrore bazohen në vlerat natyrore të rajonit. Përveç kriterit (vii) të nevojshëm për t'u regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore që nënkupton "*...fenomene të jashtëzakonshme natyrore ose zona me bukuri të veçantë natyrore dhe rëndësi estetike"...*, janë përkufizuar edhe kriteret që lidhen me vetitë e tipareve natyrore, në baza të së cilave është bërë zonimi, siç janë:

1. *Autenticiteti,* i shprehur si shkallë e ruajtjes së vlerave origjinale, përkatësisht natyrore dhe kulturore me të cilat konfirmohet vlera e jashtëzakonshme universale e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit si trashëgimi botërore e UNESKO-s.
2. *Rariteti,* i shprehur si përfaqësim i llojit në më pak se pesë lokalitete në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zakonisht me sipërfaqe të vogla, në kuadër të arealit të tij më të gjerë.
3. *Shkalla e endemizmit,* e shprehur si prania e llojit ose nënllojit, shpërndarja e të cilit është i kufizuar në një zonë të caktuar. Stenoendemiti nënkupton lloj ose nënlloj, shpërndarja e të cilit është i kufizuar në një zonë shumë të ngushtë (maja e malit, gryka, etj.).
4. *Diversiteti,* i shprehur si larmi ndërmjet bimëve, kërpudhave dhe kafshëve me habitatet e tyre, materialin e tyre gjenetik dhe ekosistemet; larminë e elementeve të gjeodiversitetit.
5. *Integraliteti,* i shprehur përmes shkallës së unitetit të funksioneve dhe formave, përputhjes së strukturave ose përmbajtjeve, ndërveprimit me mjedisin, ndërlidhjen e pjesëve në tërësi dhe të ngjashme.
6. *Gjendja e ruajtjes së habitatit natyror,* e shprehur si përmbledhje e faktorëve që veprojnë në habitatin natyror dhe llojet e tij tipike që mund të ndikojnë mbi shpërndarjen e tij afatgjate natyrore, strukturën dhe funksionet e tij, si dhe mbi mbijetesën afatgjate të llojeve tipike.
7. *Reliktiteti,* i shprehur si prania e llojeve që kanë mbetur në një zonë të caktuar (zakonisht refugjiumi) nga ndonjë epokë (periudhë) e mëparshme gjeologjike, në të cilën ato ishin shumë më të përhapura dhe më karakteristike.
8. *Prania e llojeve dhe habitateve me rëndësi evropiane* (llojet Emerald, llojet Natura 2000 të Draft-listave të referencave kombëtare për shtojcat I dhe II të Direktivës së habitateve dhe shtojca I të Direktivës së Zogjve). Në bazë të pranisë së habitateve dhe llojeve të këtyre shtojcave në një zonë bëhet identifikimi i zonës së mundshme për rrjetin ekologjik Natura 2000.
9. *Shkalla e ndikimit të llojeve* (lloji i prekshëm, lloji i rrezikuar dhe lloji i rrezikuar në mënyrë kritike) në pajtim me IUCN Lista e Kuqe Globale dhe IUCN Lista e Kuqe Evropiane.

10. *Kërcënimi,* i shprehur përmes ndikimeve negative mbi vlerën e jashtëzakonshme universale të:



a) Projekteve të infrastrukturës
b) Ujërave të zeza
c) Mbeturinës së fortë
d) Ndërtimeve të reja në qendrat e vjetra të qytetit
e) Komunikacionit të dendur
f) Aktiviteteve bujqësore
g) Urbanizimit dhe ndërtimeve pa leje

11. *Indeksi i funksionalitetit të zonës bregdetare* (SFI) si indikator për atë se sa një zonë bregdetare mund t'i kryejë funksionet e saj të ndryshme ekologjike

Rezultatet e Indeksit të funksionalitetit bregdetar (SFI) mund të shfrytëzohen për t'i identifikuar lehtësisht vendet ku është i nevojshëm të drejtohen aktivitetet e mbrojtjes së rreptë, përkatësisht vendeve të mundshme për restaurimin e shiritit bregdetar[19].

## 8.2 Funksionaliteti bregdetar i Liqenit të Ohrit si kriter për mbrojtjen më të rreptë

Bregu i liqenit, nëse është në gjendjen e tij natyrore (me shkallë të lartë funksionaliteti), mund t'i kryejë funksionet e tij pozitive në biodiversitetin dhe cilësinë e ujit të liqenit, siç janë: filtrimi i sedimentimit dhe ndotjes; mbrojtja nga erozioni; heqja e nutrientëve; kontrolli i temperaturës së ujit; formimi dhe mirëmbajtja e habitateve natyrore; ruajtja dhe mirëmbajtja e vlerës së lartë të zonës, të formuar nga atributet natyrore dhe kulturore që kanë vlerë historike.

Të kuptuarit dhe vlerësimi i funksionalitetit të bregut të liqenit siguron bazë për zhvillimin e përmbledhjes së indikatorëve që mund të shfrytëzohen për të vlerësuar funksionalitetin e kësaj zone, si dhe për t'i mbështetur dhe drejtuar politikat e planifikimit të shfrytëzimit të tokës. Kjo qasje buron nga Direktiva Kornizë e Ujit e BE-së (WFD) 2000/60 / CE, sipas së cilës për t'u përcaktuar cilësia ekologjike merren parasysh evalvimet e parametrave. Hulumtimet e bëra në kuadër të projektit "Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në Liqenin e Prespës, Liqenin e Ohrit dhe Liqenin e Shkodrës" në vitin 2017 nga Shoqëria për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhanë të dhëna për indeksin e funksionalitetit bregdetar të Liqenit të Ohrit.

Parametrat e shfrytëzuara për të përcaktuar Indeksin janë: uzurpimi i bregdetit, mbulesa e tokës, ndërprerjet e bregdetit nga infrastruktura, pjerrësia e bregut, prania e rripit të kallamit, prania e llojeve arboreale, prania e infrastrukturës rrugore, heterogjeniteti i vegjetacionit arboreal dhe prania e llojeve johigrofile.

Rezultatet e statusit janë paraqitur në fotografinë 40, ndërsa në fotografinë 41 dhe 42 është paraqitur dedikimi i tokës dhe infrastruktura turistike përgjatë zonës bregdetare.

[19] Publication Shorezone Functionality Ohrid Lake Implementing the EU Water Framework Directive in South-Eastern Europe, GIZ 2017;




*Fotografia 5. Indeksi i funksionalitetit të bregut të Liqenit të Ohrit*




(Infrastruktura turistike)

*Fotografia 6. Infrastruktura e lidhur me turizmin (Madhësia: 0 = asnjë deri në 1 = 100% përgjatë gjatësisë së plotë) (0,1 = shtegu i këmbësorëve; 0.2 = një hotel; 0,5 = shtegu i biçikletave pranë liqenit; 1 = plazh ose infrastrukturë turistike)*




*Fotografia 7. Dedikimi i shfrytëzimit të shiritit bregdetar të liqenit (0 deri më 50 metra nga bregu)*

## 8.3 Kriteret për përcaktimin e kufijve të zonave të mbrojtura

Në bazë të kritereve të theksuara gjatë zonimit janë marrë parasysh karakteristikat hapësinore të rajonit, përkatësisht:

1. Karakteristikat hidrologjike (zona e pellgut e Liqenit të Ohrit;
2. Shpërndarja hapësinore e habitateve ripariane[20] dhe shiritave me kallamin autokton
3. Karakteristikat topografike të terrenit - lartësisë mbidetare;
4. Kufijtë e vendosur në zonat e identifikuara të mbrojtura (PK Galiçicë);
5. Kalimet natyrore, komunikacionet dhe të ngjashme;

[20] Zona bregdetare - shiriti vegjetativ i drunjve, kaçubeve dhe bimëve me bar përgjatë të dyja anëve të trupave të ujit që është në kontakt ose është nën ndikim të trupit të ujit. Ai paraqet kufi kalimtar midis tokës dhe mjedisit ujor. Në të përfshihen brigjet dhe toka përreth, si dhe sipërfaqet e ekspozuara ndaj përmbytjeve më të mëdha. Shembuj tipikë janë brigjet e lumenjve, plazhet, brigjet e liqenit dhe skajet e kënetës.

6. Ndërveprimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kontekstin tejkufitar me Republikën e Shqipërisë

## 8.4 Masat e mbrojtjes në zonat e vendosura në kuadër të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit

Për të menaxhuar dhe mirëmbajtur më mirë vlerën e jashtëzakonshme universale, përkatësisht kontrollin mbi aktivitetet e caktuara që mund të kenë ndikimet negative, janë krijuar tri zona të mbrojtjes, secila prej tyre përmban nën-zona të përshtatshme. Këto nën-zona janë futur për t'i pasqyruar masat e veçanta të mbrojtjes që janë të zbatueshme në këto zona.

Kufijtë e zonave të mbrojtura të trashëgimisë natyrore përcaktohen në bazë të:

- indeksit të funksionalitetit bregdetar të Liqenit të Ohrit (SFI)
- karakteristikave morfologjike-topografike të terrenit,
- degëzimit të lartësisë,
- shfrytëzimit të tokës në pajtim me Corine Land Cover,
- zonave të mbrojtura dhe përfaqësimit hapësinor të tyre,

Zona e parë e mbrojtur formohet në shiritin prej 50 metra e llogaritur nga kufiri i parcelës kadastrale 1/1 (PK Liqeni i Ohrit) dhe ka tri nën-zona (I a, I b dhe I c). Zona e parë e mbrojtur përfundon përgjatë vijës bregdetare në të cilën formohen zonat urbane, me përjashtim të zonës së përfshirë me tërësinë urbane të Strugës.

Zona e dytë e mbrojtur ka dy nën-zona (II a II b) të cilat janë të organizuara në zonat si vijon:

- II a - që i përfshin habitatet bregdetare (ripariane) pranë lumenjve
- II b - që i përfshin habitatet natyrore dhe gjysmënatyrore të vendosura mbi kuotën 866[21] m.l.m.

Zona e tretë e mbrojtur është formuar në pjesët nën kuotën 866 m.l.m, përkatësisht i përfshin hapësirat e dedikuara për qëllime joproduktive, ose kryesisht shfrytëzohen për prodhim bujqësor.

Zonat për mbrojtje të vendosura në zonat e mbrojtura (p.sh. Parku Kombëtar Galiçicë, Monumenti i Natyrës së Liqenit të Ohrit dhe Moçali i Studençishtës) zbatohen plotësisht në pajtim me planet përkatëse të menaxhimit të miratuara në bazë të Ligjit për mbrojtjen e natyrës.

[21] Kuota 866 m.l.m është vendosur si kufi midis habitateve antropogjene dhe natyrore / gjysëmnatyrore me dosjen nominale për Rezervatin e Biosferës së Ohrit-Prespës

- 


(ZONIMI I ZONËS SË UNESKO-s

LEGJENDA

Zona I-a

Zona I-b,v

Kufiri i UNESKO-s

Zona II-a

Zona II-b

Zona III

PK Galiçicë

Aglomeracionet

UNESKO Shqipëri)

- *Fotografia 8. Zonat e mbrojtura në kufijtë e trashëgimisë natyrore të Liqenit të Ohrit*

#### 8.4.1.1 Zona e parë e mbrojtur

**Zona e parë e mbrojtur** e përfshin Liqenin e Ohrit me vlera të larta natyrore dhe shiritin e tij bregdetar në projeksionin horizontal me gjerësi 50 m të llogaritur nga kufiri i PK1 / 1 Liqeni i Ohrit. Kjo zonë zgjerohet në PK 1/1 Liqeni i Ohrit për t'i përfshirë plazhet.

Kjo i përfshin pjesët e lokaliteteve me vlera natyrore të Rajonit të Ohrit të regjistruara si trashëgimi natyrore botërore. Në kuadër të kësaj zone përfshihen hapësirat në të cilat haset përqendrimi i lartë i popullsisë së llojeve që ndodhen në IUCN - Listën e Kuqe të Llojeve të kërcënuara në nivelin global dhe evropian, Konventa e Bernës, si dhe popullsitë amë dhe llojet endemike dhe relikte, pastaj burimet sublakustrike, vendet për pllenimin e krapit.

Zona e parë e mbrojtur përfundon përgjatë vijës bregdetare në të cilën formohen zonat urbane të Ohrit, vendbanimet bregdetare dhe zonat e veçanta jashtë vendbanimeve për të cilat ekziston dokumentacion i vlefshëm i planit urbanistik. Kështu, për shiritin bregdetar brenda kufijve të PPU-së për Ohrin, përkatësisht për vendbanimet bregdetare në Komunën e Ohrit dhe Komunën e Strugës, nuk do të zbatohen masat për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, përkatësisht do të zbatohen masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Për vijën bregdetare brenda kufijve të PPU-së së Strugës, si përjashtim, do të zbatohen masat e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore. Arsyeja e këtij përjashtimi është gjendja e bregdetit, përkatësisht koeficienti i lartë i funksionalitetit që duhet të mirëmbahet (ndërtimi i objekteve është i mundur vetëm nëse me mënyrën e zbatueshme dhe materialet e ndërtimit, përqindja e ndërtimit të parcelës së ndërtimit dhe kateve mundësohet mirëmbajtja e koeficientit të lartë funksional të bregdetit dhe vlerave të zonës).

Kufijtë e kësaj zone mund të përshtaten pasi do të përpilohet Studimi për valorizimin e Monumentit të Natyrës së Liqenit të Ohrit dhe miratohet Ligji për rishpalljen e Liqenit të Ohrit monument natyror dhe Plani për menaxhimin me Liqenin e Ohrit.

Zona e parë përmban tri nën-zona:

- **I-a** zonë e hapësirave natyrore origjinale, me SFI indeksin 1 dhe 2 (sipas DKU-së, kjo do të nënkuptojë status të shkëlqyeshëm dhe të mirë);
- **I-b** zonë me hapësira me ndërhyrje të kufizuar dhe është me SFI indeksin 3, 4 dhe 5 (statusi mesatar, i dobët, i keq);
- **I-c** zonë e plazheve - përcaktohen plazhet që janë brenda fushëveprimit të PK 1/1 KK Liqeni i Ohrit, si dhe plazhet që mbulojnë PK 1/1 KK Liqeni i Ohrit, ndërsa toka është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat për momentin ekzistojnë, ose do të parashihen me *dokumentacionin e veçantë urbanistik për plazhet. Shtrirjet e tyre do të përcaktohen me dokumentacionin e veçantë urbanistik për plazhet (për këtë qëllim është e domosdoshme të miratohen ndryshimet e Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik dhe Ligjit për ndërtim, Ligjit*

*për tokë ndërtimore dhe Strategjisë për turizëm të qëndrueshëm, si dhe aktet nënligjore, etj.).* Në zonën e plazheve lejohet vendosja vetëm e pajisjes së lëvizshme urbane siç janë: shezlonet, çadrat, dhomat e ndërrimit, dushet, vendi i mbikëqyrjes së shpëtuesve të ujit, shenjat për njoftime dhe ndalime, dhomat për dhënien e ndihmës së parë dhe shportat e mbeturinave. Rekomandimet për materialet prej të cilave duhet të bëhen pajisjet urbane të plazheve do të jepen në Strategjinë e turizmit të qëndrueshëm.




(Liqeni i Ohrit)

*Fotografia 9. Zona e parë e mbrojtur*

Në zonën e parë lejohen aktivitetet shkencore dhe kërkimore dhe mbikëqyrja e biodiversitetit, të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet parësore të mbrojtjes së rajonit. Për t'i ruajtur karakteristikat e zonës, subjekti i cili menaxhon me rajonin e mbrojtur është i detyruar të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme. Pritet që me zbatimin e masave përkatëse të mbrojtjes, dhe në interes të mbrojtjes së rajonit, hapësira brenda këtyre kufijve edhe më tutje ta ruajë gjendjen dhe qëllimin e saj origjinal. Mund të organizohen edhe vizita rekreative me një regjim të kontrolluar. Për këtë zonë të mbrojtur duhet të zbatohen parimet që kanë karakter më të rreptë se standardet dhe normativat e planifikimit urbanistik që janë në pajtim me ligjin ekzistues; harmonizimi i Ligjit për planifikimin urbanistik, Ligji për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit duhet të ndodhë përpara, ose menjëherë pas miratimit të Planit. Padyshim që duhet të ketë përjashtime nga aktivitetet në këtë zonë, të tilla si peshkimi, transporti me anije, interesi për mbrojtjen dhe të ngjashme.

Për secilën nga zonat e parashikuara janë përcaktuar masat përkatëse të mbrojtjes. Në vazhdim janë përshkruar aktivitetet e ndaluara për secilën zonë që duhet të rregullohen me akt të duhur juridik.

| **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur I-a të bregut** |
|---|
| ● futja e llojeve alohote (të huaja) bimore dhe shtazore; |
| ● degradimi dhe shkatërrimi i habitateve natyrore, veçanërisht në vendet kur kafshët migrojnë, shumohen ose banojnë; veçanërisht është e ndaluar të priten drunjtë, të hiqet vegjetacioni bregdetar, të digjet kallami, etj.; |
| ● toçitja e naftës dhe derivateve të naftës për objektet e lundrimit, përveç në lokacionet e përcaktuara për atë qëllim; |
| hapja e vendnxjerrjeve të rërës; |
| ● tamponimi i tamponit të madh ose të vogël dhe mbushja e rërës, si dhe ndërtimi i mureve prej betoni dhe guri, përveç lokacioneve ekzistuese të përcaktuara për atë qëllim; |
| ● ndërtimi i objekteve me karakter të përhershëm, përveç infrastrukturës për të mbështetur turizmin në afërsinë e qendrave urbane të qytetit dhe rikonstruksionin e sistemit të kolektorit; |
| ● vendosja e objekteve me karakter të përkohshëm që mund ta prishin zonën ose të kenë ndikime negative mbi proceset natyrore të liqenit; |
| ● vendosja e peshkoreve; |
| ● prodhimi bujqësor konvencional duke përdorur pleh organik, plehra kimike dhe pesticide që i ndotin ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë; |
| ● shkarkimi i ujërave të zeza urbane dhe industriale të patrajtuara; |
| ● gropat nëntokësore dhe / ose drenazhet e ujërave të zeza, përveç gjirizave të papërshkueshëm nga uji, në vendet ku nuk është ndërtuar kanalizimi; |
| ● depozitimi i mbeturinave; |
| ● lundrimi me objektet e lundrimit dhe instalimet të cilat lëvizin me motorët me djegie të brendshme në zonat e mbrojtura të burimeve. |

| ● **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur I-b të bregut** |
|---|
| ● degradimi dhe shkatërrimi i habitateve natyrore, veçanërisht në vendet kur kafshët migrojnë, shumohen ose banojnë; veçanërisht është e ndaluar të priten drunjtë, të hiqet vegjetacioni bregdetar, të digjet kallami, etj.; |
| ● toçitja e naftës dhe derivateve të naftës për objektet e lundrimit, përveç në lokacionet e përcaktuara për atë qëllim; |
| ● hapja e vendnxjerrjeve të rërës; |
| ● ndërtimi i objekteve me karakter të përhershëm ose të përkohshëm, përveç objekteve të infrastrukturës, si dhe rikonstruksioni, përshtatja dhe ridedikimi i objekteve ekzistuese |

| | |
|---|---|
| | me karakter të përhershëm, me ruajtjen e madhësisë dhe dyshemesë dhe në pajtim me Vizionin e Planit; |
| ● | vendosja e peshkoreve; |
| ● | prodhimi bujqësor konvencional duke përdorur pleh organik, plehra kimike dhe pesticide që i ndotin ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë; |
| ● | shkarkimi i ujërave të zeza urbane dhe industriale të patrajtuara; |
| ● | gropat nëntokësore dhe / ose drenazhet e ujërave të zeza, përveç gjirizave të papërshkueshëm nga uji; |

| Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur I-c të bregut | |
|---|---|
| ● | degradimi dhe shkatërrimi i habitateve natyrore, veçanërisht në vendet kur kafshët migrojnë, shumohen ose banojnë; veçanërisht është e ndaluar të priten drunjtë, të hiqet vegjetacioni bregdetar, të digjet kallami, etj.; |
| ● | toçitja e naftës dhe derivateve të naftës për objektet e lundrimit, përveç në lokacionet e përcaktuara për atë qëllim; |
| ● | ndërtimi i limaneve të reja, përveç rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së atyre ekzistuese, në pajtim me rekomandimet e Strategjisë së Turizmit të Qëndrueshëm; |
| ● | ndërtimi i objekteve me karakter të përhershëm ose të përkohshëm; |

#### 8.4.1.2Zona e dytë e mbrojtur

Në zonën e dytë të mbrojtur zbatohen masat që nënkuptojnë ruajtjen e gjendjes së natyrës në ato habitate ku fillohet ndikimi antropogjen, me qëllim që të zvogëlohet / minimizohet. Në këtë drejtim kjo zonë është e ndarë në nënzona - II-a dhe II-b. Zona II-a i përfshin habitatet ripariane jashtë zonave urbane, funksioni i të cilave është të mbrohen nga ndikimet mbi cilësinë e ujit në pellgun e Liqenit të Ohrit. Zona e mbrojtur II-b do të shtrihet kushtimisht në hapësirat që ndodhen jashtë zonave urbane dhe nuk guxon të përfshihen nga urbanizimi. Në zonën e dytë të mbrojtur ndalohen aktivitetet që kanë ndikim negativ mbi zonën dhe mjedisin jetësor, ndërsa do të ketë përjashtime nëse do të zbatohen projektet me rëndësi shtetërore. Lejohen aktivitetet rekreative me ndikime të parëndësishme mbi natyrën, të mbështetura nga infrastruktura më e thjeshtë. Zona e menaxhimit aktiv të PK Galiçicë është pjesë e kësaj zone. Për PK Galiçicë vlejnë zonat dhe masat e mbrojtura të përcaktuara me Planin për menaxhimin me PK Galiçicë.

| Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur II | |
|---|---|
| ● | eksploatimi i resurseve minerale; |
| ● | ndërtimi i objekteve për turizmin masiv; |
| ● | ndërtimi i objekteve të infrastrukturës, përveç kur projektet kanë interes publik dhe ku për to bëhet vlerësimi strategjik dhe / ose vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe aspektet sociale; |

#### 8.4.1.3Zona e tretë e mbrojtur

**Zona e tretë e mbrojtur** do t'i përfshijë hapësirat e urbanizuara ose do të urbanizohen, duke e përjashtuar zonën e mbrojtur të Liqenit të Ohrit. Në këtë zonë do të mundësohet zhvillimi i vendbanimeve, turizmit dhe infrastrukturës, por do të përcaktohen edhe kushtet e veçanta.

| Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur III |
|---|
| · ● prodhimi bujqësor konvencional duke përdorur pleh organik, plehra kimike dhe pesticide që i ndotin ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë; |
| ● rritja e zonave urbane të vendbanimeve për jo më tepër se 20%; |
| · ● aktivitetet e tjera që mund ta prishin zonën dhe t'i rrezikojnë vlerat e jashtëzakonshme; |

### 8.4.2 Masat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Rajonin e Ohrit

Trashëgimia kulturore është e përbërë nga lloje të ndryshme të të mirave të kushtëzuara nga shumëllojshmëria e rrethinës së tyre që nuk i përfshin vetëm monumentet e rëndësishme, por edhe rrethinat e tyre të afërta që përbëjnë një tërësi. Kjo mund të ketë vlera të ndryshme, në varësi të kontekstit, dhe për këtë arsye trajtimi i tij mund të ndryshojë nga rasti në rast. Në këtë drejtim, qëllimi i mbrojtjes është të ruhet cilësia dhe vlera e trashëgimisë kulturore, ta ruajë përmbajtjen e tij materiale dhe ta sigurojë integritetin e tij (i përfshinë ndërtesat e veçanta, hapësirat e hapura dhe parqet, rrugët, vijën bregdetare, mbetjet arkeologjike, etj.) për gjeneratat e ardhshme.

Presioni në rritje nga urbanizimi i hapësirave në të mirën e mbrojtur lehtë mund të shndërrohet në problem shumë të madh sesa rindërtimi i fondit të ndërtesës, meqë bëhet fjalë për urbanizimin joadekuat që krijon efekte plotësisht të kundërta. Shkalla e urbanizimit lëviz në drejtim kur vlerat mbi të cilat rajoni është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore mund të rrezikohen seriozisht.

Masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënkuptojnë sigurimin e mbrojtjes së drejtpërdrejtë në atë mënyrë që do t'i ruajë vlerat origjinale, historike, urbanistike-arkitektonike, artistike dhe estetike, përkatësisht ruajtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale të rajonit. Në kuptim më të gjerë, masat mbrojtëse do të mundësojnë edhe futjen e përmbajtjeve të reja brenda rajonit në pajtim me nevojat bashkëkohore të veprimtarive ekonomike, turistike, kulturore dhe veprimtarive të tjera, por me respekt maksimal për vlerën e jashtëzakonshme universale. Por, për t'i arritur përfitimet dhe për të siguruar që Rajoni i Ohrit e ruan vlerën e tij të jashtëzakonshme universale, nevojitet që proceset e reja të zhvillimit brenda kufijve të së mirës të menaxhohen dhe kontrollohen mirë. Strategjia për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet të bazohet në disa parime:

- Sigurimi i reverzibilitetit;
- Ruajtja e origjinalitetit (të mundësohet ruajtja maksimale e materialit ndërtimor origjinal, mos të lejohen ndërhyrjet e reja që të mbizotërojnë mbi indin origjinal, por të respektohet potenciali i tij);
- Në planet hapësinore për vendbanimet me tërësi të mbrojtura monumentale, është e nevojshme në masën më të madhe të mundshme të ruhet dhe revitalizohet qendra historike e tërësisë, ndërsa ndryshimi i strukturës dhe tipologjisë së objekteve ekzistuese me lidhjen e tyre

funksionale në tërësi më të mëdha hapësinore, për shkak të humbjes së identitetit hapësinor nuk është i arsyeshëm.

- Planifikimi urbanistik duhet të synojë arritjen e harmonisë, shmangien e funksioneve të padëshirueshme dhe ruajtjen e madhësisë ekzistuese të ndërtesave, si dhe vlerave të tyre funksionale dhe kulturore sipas parimit të mbrojtjes së integruar;
- Mbrojtja u referohet aktiviteteve të domosdoshme për krijimin e kushteve për mbijetesë të zonës / monumentit / lokalitetit, duke e përfshirë edhe rrezikimin vizual.
- **Përpilimi i detyrueshëm i Vlerësimit të ndikimit mbi trashëgiminë kulturore (HIA) kur do të planifikohen projektet e reja infrastrukturore në rajon**

Me rëndësi thelbësore për qytetet me trashëgimi botërore, të njohura për vlerën e tyre të jashtëzakonshme universale, është të sigurohet ruajtja e origjinalitetit dhe vlerës së tyre kulturore në mënyrë përkatëse. Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe larminë e trashëgimisë kulturore, ndërsa me qëllim të mbrojtjes së duhur të trashëgimisë kulturore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe urbanizimit të kontrolluar, në Rajonin e Ohrit përcaktohen disa zona të mbrojtura me kushtet dhe masat e tyre specifike për ruajtjen e tipareve të përmendura:

- Qendrat urbane të qytetit,
- Trashëgimia fetare,
- Fshatrat dhe vendbanimet bregdetare
- Lokalitetet arkeologjike,

#### 8.4.2.1Qendrat urbane të qytetit

Në **qendrat urbane të qytetit**, kriteri kryesor për të përcaktuar sistemin e masave të mbrojtjes është përqendrimi i konstatuar i të mirave të veçanta të mbrojtura dhe objekteve ambientale. Për këto shkaqe janë përcaktuar tri zona me specifikat e tyre:

**Zona e parë** u referohet tërësive monumentale (në Ohër[22] dhe Strugë[23]) të cilat përmbajnë ndërtesa të rëndësishme kulturore dhe historike. Me masat e mbrojtjes në këtë zonë parashihet mbrojtja e plotë e të gjitha vlerave kulturore dhe historike me respektimin më të lartë të mundshëm për traditën dhe funksionin e hapësirës dhe përmbajtjes së saj. Në hapësirën e kësaj zone duhet rreptësisht të kontrollohet futja e strukturave dhe përmbajtjeve të reja që nuk janë të natyrshme në vlerat kulturore. Përshtatja e funksioneve dhe përmbajtjeve historike ekzistuese me nevojat bashkëkohore mund të jetë e pranueshme me ndërhyrjet fizike minimale në strukturën historike. Metodat e pranueshme të mbrojtjes janë riparimi, konservimi, restaurimi, rindërtimi i konservimit dhe prezantimi. Çdo ndërmarrje e tillë duhet të bazohet në përpilimin e një dokumentacioni të detajuar nga shërbimet kompetente për mbrojtje.

Në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Ohrit, masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore do të zbatohen edhe sipas parametrave të përkufizuara hollësisht në planet e detajuara urbanistike nga neni 6 i Ligjit për shpalljen e qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë ("Gazeta

[22] Kufijtë e Zonës së Parë në Ohër përcaktohen me Ligjin për shpalljen e qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë si qendër e vjetër e qytetit;

[23] Kufijtë e Zonës së Parë në Strugë përcaktohen në pajtim me Bazat e Mbrojtjes dhe Konservimit (Nr. 13-1640 nga 01.12.2009);

Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/11 dhe 154/15), si dhe sipas bazave të mbrojtjes dhe konservimit të përpiluara në mënyrë të veçantë;

| **Masat e mbrojtjes në zonën e parë të mbrojtur janë:** |
|---|
| • Ruajtja e strukturës urbane: kufijtë e aglomeratave urbane si pjesë e urbanizmit organik, rrjeti rrugor, hyrjet në Liqen dhe të gjitha sipërfaqet e gjelbërta, që nënkupton edhe dendësinë e popullsisë të shoqëruar me ndërhyrjen e kontrolluar të lokacioneve të reja në hapësirat e hapura (në raste të jashtëzakonshme); |
| • Ruajtja e lartësisë dhe pamjes së fasadës së të mirave të mbrojtura të veçanta dhe objekteve ambientale; |
| • Ruajtja e madhësisë së të mirave të mbrojtura të veçanta; |
| • Ruajtja e të mirave monumentale të mbrojtura të veçanta në gjendjen e tyre origjinale përmes konservimit, restaurimit, sanimit; |
| • Mbajtja e fasadës së katit përdhes dhe kateve të larta prej guri gjysëm të përpunuar, ndërsa katet të suvatohen me gëlqere; |
| • Ruajtja e ngjyrës autentike të objekteve të ngritura në periudhën ndërmjet të dyja luftërave botërore. Ruajtja dhe mirëmbajtja e funksioneve themelore ekzistuese të qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit dhe Strugës, me mundësinë e kthimit të disa funksioneve origjinale (zanatet e vjetra), ose dhënien e funksioneve të reja moderne që janë kompatibile me natyrën dhe karakterin e tërësisë monumentale dhe nuk ndikojnë mbi prishjen e vërtetësisë dhe integritetit të së mirës (me mbikëqyrjen e siguruar nga institucionet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore); |
| • Kthimi i fondit të humbur të objekteve (përmes rikonstruksionit të tyre, ose restaurimit tipologjik) në vendet që janë të lira dhe për të cilat ekzistojnë plane të vjetra urbanistike, mbeturinat e objekteve ose dokumentacioni teknik dhe fotografik, mund të pranohen vetëm në bazë të analizave dhe studimeve të hollësishme të ekspertëve; |
| • Kthimi i pamjes autentike të fasadës në ato objekte që e kanë humbur dhe për të cilat ka informata të mjaftueshme për pamjen origjinale; |
| • Vlerat dhe fotografia ambientale e qendrës / tërësisë së mbrojtur t'i ruajnë elementet karakteristike të arkitekturës tradicionale të rajonit (qoshet prej druri, lëshimet erkere, shtyllat, strehët e zgjatur ose të profilizuar, etj.); |
| • Gjatë përshtatjes eventuale të enterierit të ndërtesave ambientale, dritaret e çatisë mund të lejohen vetëm në anën që nuk shihet nga rruga kryesore, me pëlqimin paraprak të institucionit kompetent të mbrojtjes; |
| • Kthimi i elementeve dhe përmbajtjeve të humbura të objekteve ambientale që kontribuojnë në vlerat dhe fotografinë ambientale në tërësi duhet t'i përmbajnë elementet karakteristike të arkitekturës tradicionale dhe periudhën e ndodhjes, por justifikimi i ndërhyrjeve duhet të mbështetet vetëm nga informatat me burime historike dhe dokumentacioni dhe të jetë me pëlqim dhe mbikëqyrje nga institucioni kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; |

| |
|---|
| ● Zbatimi i Projekteve të Konservimit të jetë në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara ligjore; |
| ● Nuk duhet të futen përmbajtje të reja në tërësitë monumentale pa i vlerësuar aftësitë e tyre për t'i pranuar, shfrytëzuar dhe mirëmbajtur, e as përmbajtjet që shkaktojnë zhurmë dhe ndotje të mjedisit (duhet të njihet se turizmi i pakontrolluar mund të ketë ndikim negativ mbi popullsinë lokale në kuptim të humbjes së privatësisë së popullsisë lokale, rrëmuja më të mëdha në komunikacion, dëmtimi i të mirave dhe prishja e mënyrës së jetesës); |
| ● Fshehja e të gjitha llojeve të linjave të infrastrukturës dhe instalimeve hapësinore nga qendrat e mbrojtura të qytetit të vjetër të Ohrit dhe Strugës; |
| ● Unifikimi i mbishkrimeve të firmave dhe mbishkrimeve të tjera, bilbordeve, reklamave neon dhe të tjera, shenjave të komunikacionit, sinjalistikës monumentale, ndriçimit, pajisjeve urbane në hapësirë të hapur në atë mënyrë që nuk do ta prishin vlerën vizuale dhe ambientale të hapësirës; |
| ● Mbrojtja nga dielli i hapësirave publike duhet të jetë e lëvizshme (çadra dielli), ndërsa përforcimi i tendeve duhet të jetë me kontroll të rreptë dhe i lejuar nga institucioni i mbrojtjes; |
| ● Duke pasur parasysh përqendrimin e lartë të mbetjeve arkeologjike në qendrat e vjetra të qytetit, çdo rindërtim thelbësor, punime ndërtimore ose punime të tjera duhet të kushtëzohen nga kërkimet dhe mbikëqyrja paraprake arkeologjike; |
| ● Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese kundër efekteve shkatërruese të zhurmës, goditjeve dhe dridhjeve të shkaktuara nga makinat dhe automjetet; |

| **Ndalimet në zonën e parë të mbrojtur:** |
|---|
| ● Dyshemetë e objekteve dhe specifikat e ndërtesave në qendrat e vjetra të qytetit të Ohrit dhe Strugës do të përcaktohen me përpilimin e bazave të mbrojtjes dhe konservimit (para përpilimit të planit urbanistik), por nuk duhet të ndërtohen objekte më të larta se katet P + 2 (në qendrën e vjetër të qytetit të Ohrit, bazat e mbrojtjes dhe të konservimit do të përpilohen për secilën nga 19 komplekset urbane veç e veç, dhe për secilin kompleks do të përcaktohen parametrat e veçantë); |
| ● Në qendrat e vjetra të qytetit të Ohrit dhe Strugës: nuk duhet të ndërtohen objekte të reja që si lartësi kanë galeri ose çati, pa ose me baxhë, ose të mbuluara me një tarracë të sheshtë; |
| ● Nuk duhet të ndërtohen garazhe si objekte të veçanta në parcelën ndërtimore; |
| ● Nuk duhet të vendosen mbështetës, antena televizive, repetitorë, pano të mëdha të reklamave, kolektorë diellorë dhe të ngjashme; |
| ● Ndalohet hedhja e mbeturinave komunale dhe vendosja e kontejnerëve pranë të mirave të mbrojtura; |
| ● Nuk lejohet parkimi, si dhe formimi i hapësirave të parkimit ngjitur me të mirat e mbrojtura; |
| ● Nuk duhet të rritet madhësia dhe lartësia e objekteve ekzistuese ndihmëse; |

| |
|---|
| ● Nuk duhet të ndryshohet përpunimi i shtigjeve të këmbësorëve dhe rrugëve të pllakave prej guri dhe blloqeve të granitit; |
| ● Nuk duhet të përdoren paver - elementet (bekatone) si përpunim i zonave të këmbësorëve; |

| **Masat e tjera të mbrojtjes në zonën e parë të mbrojtur janë:** |
|---|
| ● Në hapësirat publike është e lejuar, përveç funksioneve themelore që lidhen me komunikimin në qytet, përkohësisht të kryhen veprimtari dhe evenimente komerciale, kulturore dhe të tjera, me detyrimin për t'i hequr mbeturinat, pajisjet, etj., pas përfundimit të tyre; |
| ● Veprimtaritë komerciale nuk duhet t'i rrezikojnë komunikimet e këmbësorëve, si dhe pamjet e të mirave kulturore, dhe duhet të kufizohen në vendet e përcaktuara rreptësisht me miratimin paraprak të Këshillit të Komunës me kriteret e përcaktuara nga institucioni kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; |
| ● Veprimtaritë nuk duhet ta rrezikojnë trashëgiminë ndërtimore, lokalitetin e prezantuar arkeologjik, as ta pengojnë sigurinë dhe lëvizjen e qytetarëve; |
| ● Gjatë vizitave turistike të sigurohet ekzistimi i masave të domosdoshme për mbrojtjen e trashëgimisë; |
| ● Reduktimi (sipas mundësisë ndalimi) i komunikacionit të automjeteve në zonat e mbrojtura rreptësisht; |
| ● Reklamat mund të vendosen në vendet publike brenda qendrës së qytetit në përputhje me rregullat e veçanta për vendosjen e reklamave të cilat i miratojnë institucionet kompetente dhe me pëlqimin e institucioneve kompetente të mbrojtjes; |
| ● Mbishkrimet e reklamave nuk duhet të vendosen në ndërtesat e veçanta të mbrojtura, në kornizat prej guri dhe në dekorimin prej guri; |
| ● Fasadat ballore të hapësirave afariste në pjesën e mbrojtjes së rreptë duhet ta ruajnë pamjen tradicionale të vrimave; është e ndaluar të vendosni mallra dhe sende të tjera në dyert ose dritaret e hapësirave afariste, si dhe në fasadën ballore të ndërtesës me çka bëhet fshehja e vlerave arkitektonike të të mirave; |
| ● Duhet të rregullohet fuqia e zhurmës dhe të sigurohet periudha ditore e pushimit; |
| ● Instalimi i pajisjeve të tjera urbane si dhe elementet e pajisjeve urbane duhet të jenë të dizajnuara me kujdes, ndërsa për instalimin e tyre është i nevojshëm miratimi i komunës kompetente dhe pëlqimi nga enti kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; |
| ● Njësitë e jashtme të kondicionerëve nuk duhet të montohen në fasadën e rrugës, e as nuk duhet të prishen / dëmtohen ndërtesat e mbrojtura për montimin e tyre; |
| ● Me "prezantimin e lokaliteteve arkeologjike" nënkuptohen ato pjesë të hapësirave publike në të cilat prezantohet trashëgimia arkeologjike, qofshin ato mbetje apo arkitekturë historike që me |

| | |
|---|---|
| | ndërhyrjet e konservimit është prezantuar në mënyrën që të theksohet vlera e tyre arkeologjike dhe arkitektonike; |
| ● | Nuk duhet të lëshohen lejet e ndërtimit pa kontroll të rreptë nga institucionet kompetente të shprehjes arkitektonike të ndërtesave; |

**Zona e dytë**[24] paraqet zonë që përmban elemente të rëndësishme të strukturës historike dhe trashëgimisë kulturore me shkallë të ndryshme të ruajtjes. Me masat e mbrojtjes në këtë zonë zbatohet mbrojtja e elementeve themelore të qendrës së planit urbanistik dhe grupeve karakteristike të ndërtesave, të mirave të mbrojtura të veçanta, kryesisht për sa i përket madhësisë dhe përmbajtjes historike. Në territorin e kësaj zone do të kushtëzohen ndërhyrjet në drejtim të përshtatjes së funksionit dhe përmbajtjes së nevojave moderne, por pa ndryshime të rëndësishme në elementet arkitektonike-estetike të ruajtura të të mirave të mbrojtura. Metodat e pranueshme të mbrojtjes janë konservimi, rindërtimi, ndërhyrja, rikompozimi dhe integrimi në drejtim të lidhjes së të mirave kulturore me strukturat dhe përmbajtjet e reja që rrjedhin nga nevojat e reja. Në territorin e kësaj zone, duke pasur parasysh kontekstin historik specifik të zhvillimit, të gjitha ndërhyrjet (tokësore / ndërtimore) kushtëzohen edhe nga kërkimet arkeologjike ose mbikëqyrja. Për sa i përket dyshemesë, në zonën e dytë nuk guxojnë të ndërtohen objekte më të larta se katet P + 3 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit prej 50%.

**Zona e tretë** është zonë me më pak përqendrim të trashëgimisë kulturore. Në këtë territor, të gjitha ndërhyrjet pranohen duke iu përmbajtur parimeve themelore të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Në këtë zonë duhet të zbatohet masa e rindërtimit urban, përkatësisht vendosja e gjendjes e cila do t'i përmirësojë kushtet e jetesës dhe të punës. Gjatë rregullimit të hapësirës, metodat e pranueshme janë rindërtimi i ndërtesave ekzistuese dhe ndërtimi i ndërtesave të reja duke i respektuar karakteristikat ambientale të tërësisë, format tradicionale, tiparet e peizazhit dhe përputhjen harmonike të tërësisë.

Për të mirat e mbrojtura në mënyrë të veçantë që ndodhen **në zonën e dyta dhe të tretë** të aglomeratave të qytetit parashihet:

| **Masat e mbrojtjes në zonën e dytë dhe të tretë të mbrojtur:** | |
|---|---|
| ● | Ruajtja e lartësisë dhe pamjes së fasadës si për të mirat e mbrojtura të veçanta ashtu edhe për objektet ambientale; |
| ● | Ruajtja e madhësisë së të mirave të mbrojtura të veçanta; |
| ● | Ruajtja e gjendjes burimore të të mirave të mbrojtura të veçanta duke i realizuar aktivitetet, të tilla si: konservimi, restaurimi, riparimi etj.; |

[24] Kufijtë e zonës së dytë në Ohër përcaktohen me Ligjin për shpalljen e qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë si zonë e kontaktit të qendrës së vjetër të qytetit; Kufijtë e zonës së dytë në Strugë përcaktohen në pajtim me bazat e mbrojtjes dhe konservimit (nr. 13-1640, nga 01.12.2009) si zonë e kontaktit e tërësisë monumentale;

| |
|---|
| • Nuk duhet të kryhen ndërhyrje që mund ta rrezikojnë integritetin e të mirave të mbrojtura të veçanta; |

***Ndërtesat e reja*** në zonën e dytë dhe të tretë urbane duhet t'i përmbushin aspektet specifike me të cilat do të respektohen vlerat kulturore dhe traditat e zonës historike, si dhe kushtet e strukturave ekzistuese***. Në të, është e ndaluar të ndërtohet përkatësisht të krijohet kombinimi artificial i disa parcelave se si do të ndërtohet një ndërtesë e madhe.***

| **Ndërtesat e reja duhet të kenë:** |
|---|
| • Ritëm që është në harmoni me ritmin urbanistik dhe modelin morfologjik të ndërtesave përreth nëse janë të mira të mbrojtura të veçanta ose kanë vlera ambientale; |
| • Madhësia që është në përputhje me kontekstin - jo shumë e madhe, ta prish dimensionin intim njerëzor të qendrës historike dhe nuk do ta prish perceptimin vizual të qendrës së vjetër të qytetit; |
| • Linja kufitare e rrugës që e ndjek linjën e objekteve ekzistuese; |
| • Silueta që e respekton karakterin lokal tradicional dhe silueta e hapësirës ku ndërtohen; |
| • Cilësia e lartë e ndërtesave dhe dizajnit, që arrihet me një vëmendje të madhe të proporcioneve. |

Në pajtim me nevojat për zhvillim urban, me qëllim të arritjes së aspekteve të theksuara, por me respektim maksimal të vlerave të trashëgimisë kulturore që ata e posedojnë, zona e tretë e mbrojtur është e ndarë në tri nënzona në kuadër të PPU-së (të paraqitur në shtojcën grafike), si dhe dy zona shtesë jashtë qytetit: zona III-ç (i përfshin fshatrat) dhe zona III-d (zonat urbane jashtë qytetit dhe jashtë fshatrave). Zonat e reja urbane (zona III-d) të formohen si tërësi logjike rreth objekteve tashmë ekzistuese me planin urbanistik jashtë vendbanimit.

| **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur III-a** |
|---|
| • ndërtimi i objekteve më të larta se katet P + 3 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit se 50% brenda kufijve të PPU-së; |
| • prodhimi bujqësor intensiv me përdorim të tepërt të pesticideve / plehrave që ndotin; |
| • aktivitetet e tjera që mund ta prishin zonën dhe ta rrezikojnë vlerën e jashtëzakonshme; |
| **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur III-b** |

| |
|---|
| • prodhimi bujqësor intensiv me përdorim të tepërt të pesticideve / plehrave që ndotin; |
| • ndërtimi i objekteve më të larta se katet P + 4 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit se 50%; |
| • aktivitetet e tjera që mund ta prishin zonën dhe ta rrezikojnë vlerën e jashtëzakonshme; |
| **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur III-c** |
| • prodhimi bujqësor intensiv me përdorim të tepërt të pesticideve / plehrave që ndotin; |
| • ndërtimi i objekteve më të larta se katet P + 5 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit se 50%; |
| • aktivitetet e tjera që mund ta prishin zonën dhe ta rrezikojnë vlerën e jashtëzakonshme; |
| **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur III-ç** |
| • prodhimi bujqësor intensiv me përdorim të tepërt të pesticideve / plehrave që ndotin; |
| • ndërtimi i objekteve me dedikim banimi familjar më të larta se katet P + 2 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit se 50%, përveç për fshatrat e llojit kompakt; |
| • ndërtimi i objekteve më të larta se katet P + 3 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit se 50%; |
| • rritja e zonave urbane të fshatrave për më tepër se 20%; |
| • aktivitetet e tjera që mund ta prishin zonën dhe ta rrezikojnë vlerën e jashtëzakonshme; |
| **Aktivitetet e ndaluara në zonën e mbrojtur III-d** |
| • prodhimi bujqësor intensiv me përdorim të tepërt të pesticideve / plehrave që ndotin; |
| • ndërtimi i objekteve më të larta se katet P + 3 dhe përqindja më e lartë e ndërtimit se 40%; |
| • aktivitetet e tjera që mund ta prishin zonën dhe ta rrezikojnë vlerën e jashtëzakonshme; |

Qëllimi i planifikimit të mbrojtjes, veçanërisht kur bëhet fjalë për rajonin që është trashëgimi botërore, është t'i jepet përparësi ruajtjes së ndërtesave historike ekzistuese me kontekstin e tyre. Ndërtesat e reja janë të nevojshme për të vendosur vazhdimësi funksionale dhe arkitektonike, por ky nuk është justifikim për prishjen e ndërtesave të vjetra. Ato duhet ta shprehin frymën e sotme, ndërsa dizajni i tyre duhet ta ketë parasysh kontekstin e tyre historik të bazuar në analizën e qartë dhe sistematike të morfologjisë historike të ndërtesave urbane ekzistuese dhe funksionit të tyre.

Në kontekstin e planifikimit urban, revitalizimi mund të shfrytëzohet për t'i përmirësuar aktivitetet shoqërore dhe ekonomike të pjesës kulturore dhe historike të qytetit që e ka humbur jetesën e vet origjinale funksionale, dhe si rezultat i kësaj, trashëgimia e ndërtimit dhe hapësirat urbane kanë filluar ta

humbasin rëndësinë e tyre. Qëllimi i revitalizimit në këto hapësira duhet të jetë vendosja e ekuilibrit midis mbrojtjes dhe zhvillimit.

#### 8.4.2.2 Trashëgimia fetare

**Trashëgimia fetare / komplekset** luajnë një rol të rëndësishëm në historinë e rajonit. Vlerat artistike të arkitekturës, pikturimi i mureve, të plotësuara nga vlerat shpirtërore të hapësirave, kërkojnë një qasje të veçantë në trajtimin, mbrojtjen dhe revitalizimin e tyre. Në këtë kontekst, **në zonën e trashëgimisë fetare / komplekseve** (kishat, manastiret, teqetë, xhamitë dhe vendet e tjera të shenjta...) masat e mbrojtjes bazohen në pranimin dhe respektimin e barabartë të vlerës kulturore dhe shpirtërore:

| **Masat e mbrojtjes:** |
|---|
| ● Nuk lejohet ndryshimi i madhësisë së komplekseve fetare; |
| ● Masat e mbrojtjes të zbatohen në pajtim me parimet e ruajtjes dhe restaurimit të njohura ndërkombëtarisht dhe në bashkëpunim me institucionet kompetente të mbrojtjes; |
| ● Kryerja e përkohshme e veprimtarive komerciale (shitja e suvenireve, librave, sendeve fetare...) mund të kryhet në komplekset fetare dhe rrethinat e tyre të afërta, në lokacionet dhe kushtet e përcaktuara saktësisht që nuk e cenojnë integritetin dhe gjendjen shpirtërore të kompleksit; |
| ● Në funksion të ruajtjes dhe vazhdimit të gjendjes shpirtërore të këtyre vendeve të shenjta, ndërhyrje të caktuara janë të pranueshme, por këto duhet të mbështeten vetëm nga informatat e burimeve historike dhe dokumentacioni dhe të jenë me pëlqimin dhe mbikëqyrjen e institucionit kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; |
| ● Rregullimi i fuqisë së zhurmës duke e marrë parasysh gjendjen shpirtërore të këtyre hapësirave / vendeve të shenjta; |

#### 8.4.2.3 Fshatrat dhe vendbanimet bregdetare

Gjatë revitalizimit të **fshatrave dhe vendbanimeve bregdetare** me vlera ambientale është e nevojshme të zbatohen format e mbrojtjes për t'i arritur efektet edukative, ekologjike dhe turistike dhe për ta inkurajuar kujdesin ndaj trashëgimisë për popullsinë lokale. Kjo vlen për vendbanimet rurale dhe vendbanimet në bregun e Liqenit të Ohrit që kanë nevojë nga qasja integrale në mbrojtjen dhe ruajtjen e zonës nga dedikimet agresive.

#### 8.4.2.4 Lokalitetet arkeologjike

Në **zonën e lokaliteteve arkeologjike** masat e mbrojtjes kanë të bëjnë me:

- Planifikimin e ndërtimeve të reja, rrugëve dhe projekteve të tjera të infrastrukturës, si dhe kryerjen e punimeve tokësore ose punimet e tjera ndërtimore nuk duhet të realizohen pa u kryer kërkimet arkeologjike të hapësirave për të cilat dihet se ekzistojnë lokalitete arkeologjike;
- Procedurat për zbatimin e masave të mbrojtjes gjatë zbulimeve të rastësishme të lokaliteteve arkeologjike rregullohen me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

Jashtë zonave të qytetit (jashtë përfshirjes së PPU-së) mund në pajtim me udhëzimet dhe kriteret e përcaktuara në Planin Hapësinor të Republikës së Maqedonisë dhe Planin Hapësinor të Rajonit të Ohrit dhe Prespës të planifikohen:

- Ndërtesat infrastrukturore (kryesisht me shfrytëzimin e trasesë dhe korridoreve ekzistuese se si do të mbrohen pyjet dhe toka bujqësore, përkatësisht shkatërrimi i integritetit të strukturave natyrore të bëra nga njeriu);
- Objektet banesore dhe shoqërore për nevojat personale dhe nevojat e turizmit rural (me pëlqimin paraprak të institucioneve kompetente);
- Rindërtimi i objekteve të banimit të ndërtuara në mënyrë ligjore në madhësinë ekzistuese;

Gjatë ndërtimit jashtë zonave të qytetit nuk lejohet:

- Formimi i vendbanimeve të reja në hapësirën e pandërtuar (hapësira e cila e përfshin zonën e mbrojtur 2-b në pjesën e trashëgimisë natyrore);
- Nxënia e shiritit bregdetar të Liqenit të Ohrit;
- Shfrytëzimi i tokës bujqësore me cilësi të lartë për ndërtim me ridedikim;

Në sipërfaqet malore dhe ujore, aktivitetet duhet të zhvillohen vetëm në funksion të përdorimit të kufizuar dhe të kontrolluar ekonomik të resurseve natyrore (pylltari, gjueti, rekreacion dhe eko-turizëm);

Në përgjithësi, masat mbrojtëse në bregun e Liqenit të Ohrit duhet të sigurojnë ruajtjen e përhershme të vlerave natyrore dhe kulturore dhe të parandalojnë ndryshime të rëndësishme të këtyre vlerave përmes aktiviteteve si vijon:

| |
|---|
| ● Të ruhet mjedisi natyror dhe të parandalohet ridedikimi dhe marrja e këtyre hapësirave për aktivitetet e ndërtimit që do ta prishin peizazhin bregdetar; Duhet shtuar se pamjet nga kulla panoramike e vrojtimit përmirësojnë në masë të madhe kuptimin e karakterit, vendosjen dhe paraqitjen e përgjithshme të së mirës; |
| ● Të parandalohet nxënia ndërtimore e ngritjeve të relievit, vendeve dominuese ku me ndërtimin e objekteve do të prishet peizazhi bregdetar; |
| ● Ndërtimi i objekteve jashtë kufijve të zonave të qytetit duhet të jetë me madhësinë e kontrolluar; Gjatë formësimit të ndërtesave duhet të shfrytëzohen materialet dhe ngjyrat e përshtatura me tiparet natyrore të hapësirës përreth dhe arkitekturës tradicionale; |
| ● Duhet të mbrohen pamjet e rëndësishme të ndërtimit të ndërtesave më të mëdha; |
| ● Trasetë e planifikuara të infrastrukturës (rrugët, etj.) duhet të jenë përgjatë morfologjisë natyrore të reliefit, dhe nëse nevojiten ndryshime të mëdha morfologjike (pendat, prerjet, etj.), rekomandohet që elementët e ndërtimit të ndahen nga terreni për të siguruar plotësinë dhe lidhshmërinë me zonën; |
| ● Tipologjia, madhësia dhe lartësia e ndërtesës për objektet e hotelierisë dhe turizmit, si dhe objektet për pushim dhe rekreacion jashtë vendbanimeve duhet të përcaktohen në bazë të analizës së paraqitjes vizuale dhe përshtatjes në mjedisin natyror ekzistues; |

Me qëllim të mbrojtjes së Trashëgimisë Botërore dhe për të ruajtur origjinalitetin dhe vlerat e trashëgimisë botërore (foto. 44, 45, 46), është e nevojshme të përcaktohen prioritetet në zgjedhjen e mbrojtjes fizike, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare. Secili vend nënshkrues, për t'i siguruar masat e duhura për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore që ndodhen në territorin e tij, duhet t'i zbatojë parimet e përcaktuara nga UNESKO.

Ruajtja e së mirës së mbrojtur nga Lista e Trashëgimisë Botërore duhet të ketë përparësi në të gjitha nivelet e planifikimit urban, nga master planet në nivel lokal deri tek strategjitë në nivel kombëtar.




(Liqeni i Ohrit

LEGJENDA

Lokalitetet arkeologjike

Objekti fetar

Arkitektura tradicionale e qytetit

Tërësia monumentale

Kufiri i zonës së mbrojtur

*Fotografia 10. Zonat e mbrojtura (trashëgimia kulturore)*




(LEGJENDA

Lokalitetet arkeologjike

Objekti fetar

Arkitektura tradicionale e qytetit

Tërësia monumentale

Kufiri i zonës I

Kufiri i zonës II

Kufiri i zonës III-a

Kufiri i zonës III-b

Kufiri i zonës III-c)

*Fotografia 11. Zonat e mbrojtura në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Ohrit (trashëgimia kulturore)*




(LEGJENDA

Objekti fetar

Arkitektura tradicionale e qytetit

Tërësia monumentale

Kufiri i zonës së tretë

Kufiri i zonës së dytë

Kufiri i zonës së parë)

*Fotografia 12. Zonat e mbrojtura në Qendrën e Vjetër të Qytetit të Strugës (trashëgimia kulturore)*

# 9 Plani i veprimit

Për t'i arritur qëllimet e këtij Plani, do të jetë e domosdoshme të ndërhyhet në kornizën juridike dhe institucionale, të përforcohen strukturat menaxhuese dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, të përmirësohet koordinimi midis institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të rritet ndërgjegjësimi për të gjithë të interesuarit mbi rëndësinë e vlerës së jashtëzakonshme universale, si dhe mbi rreziqet për mbrojtjen e saj.

Sistemi ekzistues i planifikimit urbanistik që zbatohet në territorin e vendit mund të çojë në copëzimin e hapësirës, rritjen e dendësisë së popullsisë, zgjerimin e vendbanimeve, prishjen e zonës dhe vlerave tradicionale dhe kulturore. Trendi i ndërtimeve pa leje mund të vazhdojë. Zhvillimi i projekteve të infrastrukturës zbatohet sipas sektorëve, pa u marrë parasysh ndikimet kumulative që mund të vijnë nga ndërveprimi i ndërsjellë ose nga disperzioni i tyre në hapësirë. Transformimi bregdetar mund të ketë ndikim negativ mbi cilësinë e ujërave të liqenit dhe biodiversitetin. Disa lokalitete me vlera natyrore të identifikuara në dosjen e emërimit janë të rrezikuara.

Për shkak të orientimit të zhvillimit dhe harmonizimit të të gjitha nevojave dhe dedikimeve të shfrytëzimit të tokës është i nevojshëm të përpilohet Plani Hapësinor për Rajonin. Në lidhje me planifikimin urbanistik subordinar, është e domosdoshme për Rajonin e Ohrit të parashihen standarde dhe normativa të veçanta për planifikimin urbanistik që do të sigurojnë një urbanizim të kontrolluar. Është e domosdoshme që vija bregdetare të planifikohet në mënyrë integrale në të gjithë gjatësinë e saj dhe t'u nënshtrohet regjimeve të përshtatshme të mbrojtjes. Si rrjedhojë, do të jetë e domosdoshme të ndërhyhet në rregullativën ligjore në mënyrë që dispozitat e këtij Plani të jenë të zbatueshme.

Kompetencat e institucioneve për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në Rajonin e Ohrit janë fragmentuar ose nuk ofrojnë mbrojtje adekuate. Nuk janë miratuar ligjet për shpalljen e Liqenit të Ohrit, Moçalit të Studençishtës dhe Parkut Kombëtar Jabllanicë zona të mbrojtura, as nuk janë formuar trupa për menaxhimin me këto zona, të cilat me vlerat e tyre natyrore kontribuojnë në vlerën e jashtëzakonshme universale të rajonit. Është e domosdoshme të intensifikohen aktivitetet për mbrojtjen e këtyre zonave të jashtëzakonshme dhe të përforcohen kapacitetet e menaxhimit dhe koordinimit të ndërsjellë, që do të sigurojë edhe përfshirjen e institucioneve përkatëse nga Shqipëria.

Trashëgimia kulturore mund të jetë trashëgimi vetëm kur atë e njohin komunitetet, grupet ose individët që e krijojnë, mirëmbajnë dhe e bartin te brezat e ardhshëm. Në këtë drejtim, mbrojtja e bazuar në komunitet si qendër e zhvillimit të qëndrueshëm të ardhshëm është e garantuar.

Plani i veprimit i prezantuar në vazhdim është hartuar në atë mënyrë që për secilin ndikim / problem të identifikuar dhe për secilin qëllim korrespondent, masat janë të identifikuara, institucionet kompetente janë të emëruara për zbatim, mjetet financiare të nevojshme janë të vlerësuara dhe burimi i tyre potencial dhe i përcaktuar është indikatori për ndjekjen e suksesit të zbatimit.

**SHËNIMI: Plani i veprimit është në shtojcë.**

# 10 Zbatimi i Planit për menaxhimin dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve të mbrojtjes

Zbatimi i Planit për menaxhim duhet të sigurojë bashkëpunim të vazhdueshëm të të gjitha palëve të përfshira në proces, nga të cilët pritet t'i marrin përgjegjësitë dhe funksionet e tyre për shkak të harmonizimit me qëllimet e planit. Në zbatimin e qëllimeve të Planit janë përfshirë një numër i madh institucionesh dhe individësh që kanë potencial të kontribuojnë në zbatimin e Planit, ndërsa një theks i veçantë i është dhënë përfshirjes së vetëqeverisjes lokale.

Për zbatimin e koordinuar të aktiviteteve të përcaktuara në Plan dhe për kryerjen e mbikëqyrjes së zbatimit të tij, kompetent është Komisioni për Menaxhimin me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit si trup këshillëdhënës, statusi i të cilit është veçanërisht i rëndësishëm për mbrojtjen dhe menaxhimin me Rajonin. Fushëveprimi i punës së Komisionit rregullohet me *Ligjin për menaxhimin me trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore të Rajonit të Ohrit*.

Komuna e Ohrit, Komuna e Strugës dhe Komuna e Debarcës dhe organet e tyre dhe shërbimet publike së bashku me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në fushën e kulturës janë përgjegjës për menaxhimin dhe për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në Rajonin e Ohrit në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër.

Pronarët e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore në Rajonin e Ohrit janë përgjegjës për mirëmbajtjen, ruajtjen, respektimin dhe shfrytëzimin e duhur të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Institucionet kombëtare - Qendra Kombëtare e Konservimit - Shkup dhe Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeu - Ohër janë kompetent për ndërmarrjen e masave të mbrojtjes dhe të ruajtjes së trashëgimisë kulturore botërore në Rajonin e Ohrit secila sipas kompetencave të tyre.

Muzeu "Dr. Nikolla Nezllobinski" - Strugë është kompetent për marrjen e masave mbrojtëse për trashëgiminë e tundshme kulturore dhe natyrore që është pjesë përbërëse e përmbledhjes së muzeut.

Institucioni Shkencor Publik - Enti Hidrobiologjik - Ohër është kompetent për propozimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore botërore në Rajonin e Ohrit, kërkimin dhe promovimin e tij shkencor dhe sigurimin e materialit gjenetik të llojeve.

Institucioni publik - Parku Kombëtar Galiçicë është kompetent për marrjen e masave për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore botërore në kuadër të zonës së Parkut Kombëtar Galiçicë dhe për të parandaluar degradimin e trashëgimisë natyrore dhe zonës së parkut kombëtar të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive dhe aktiviteteve të personave të tjerë fizikë dhe juridikë që zbatohen në kuadër të zonës së parkut kombëtar.

Menaxhimi tejkufitar me të mirën do të zbatohet me formimin e strukturës menaxhuese - mekanizëm (trupi menaxhues) që do të garantojë kryesisht funksionimin dhe mbrojtjen e plotë dhe gjithëpërfshirës të sistemit të Liqenit të Ohrit dhe trashëgimisë kulturore në tërësi. Në këtë mënyrë, do të përforcohen vlerat dhe integriteti i së mirës së mbrojtur si trashëgimi botërore.

Për bashkëpunimin kombëtar dhe tejkufitar për menaxhimin e integruar të së mirës është i domosdoshëm bashkëpunimi i të gjitha strukturave përgjegjëse të menaxhimit. Është i nevojshëm bashkëpunimi i përditshëm, duke e përfshirë shkëmbimin rutinë të informatave, takimeve, këshillimeve dhe pjesëmarrjeve të përbashkëta në projekt.

Kompetentët për menaxhimin me të mirën duhet të sigurojnë menaxhim të integruar dhe komunikim të rregullt me ata që janë përgjegjës për menaxhimin me pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit.

## 11 Plani për monitorim

Planifikimi i menaxhimit është proces dinamik dhe nuk përfundon me përpilimin e Planit të menaxhimit. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme që zbatimi i Planit të ndiqet dhe azhurnohet rregullisht. Për të siguruar mbrojtjen efektive të vlerës së jashtëzakonshme universale të së mirës, gjendja me mbrojtjen duhet të ndiqet vazhdimisht, ndërsa rezultatet e mbikëqyrjes së tillë duhet të reflektohen në procesin e rishikimit të Planit. Ndjekja e zbatimit të Planit do të mundësojë edhe ndjekjen e menaxhimit të mirë, ndërsa përvojat e fituara do të mundësojnë edhe përshtatjen e aktiviteteve të menaxhimit në të ardhmen.

Me qëllim të sigurohet që masat e përcaktuara në Planin e Veprimit zbatohen, është e domosdoshme të zbatohet mbikëqyrja e rregullt që do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave të nevojshme me të cilat do të ndiqet se cili është statusi i trupave ujorë, sa është numri i llojeve në fjalë, konservimi dhe ndërveprimi i ekosistemeve, etj., por edhe gjendja e të mirave kulturore. Ndjekja dhe matja e progresit në zbatimin e Planit të menaxhimit është me rëndësi thelbësore dhe që të mund ai të azhurnohet, përshtatet dhe përmirësohet.

Në këtë mënyrë do të dokumentohen vlerat e së mirës për të cilat kjo është shpallur, dhe do të dëshmohet nëse ato mirëmbahen dhe avancohen siç duhet. Mbikëqyrja në mënyrë plotësuese do të sigurojë informata që janë të nevojshme për njoftimin e rregullt në trupat e UNESKO-s.

Me këtë Plan të mbikëqyrjes bëhet zgjedhja e parametrave / indikatorëve që do të jenë lëndë e ndjekjes në mënyrën si vijon:

- Ato janë të rëndësishme, përkatësisht me ndjekjen e tyre është e mundur të përcaktohen ndryshimet e rëndësishme të vlerave në zonën e mbrojtur;
- Ato mund të ndiqen vazhdimisht, përkatësisht nuk ka pengesa që mund të shkaktojnë ndërprerjen e matjeve;
- Është e mundur që këto të kuantifikohen dhe janë mjaft të rëndomta, përkatësisht nuk kërkojnë kualifikime të veçanta të personave që do ta kryejnë mbikëqyrjen, e as që kërkojnë pajisje të shtrenjtë ose të sofistikuar;

Parametrat / indikatorët e zgjedhur për ndjekjen ndahen në aktivitete fizike (natyrë: numri i llojeve endemike, kulturë: origjinaliteti ose ruajtja e monumenteve kulturore sipas llojit, numri i tyre, dendësia e zonës së caktuar, etj.) dhe ndjekja e aktiviteteve të njeriut (p.sh. menaxhimi me vizitorët, shkarkimi i ujërave të zeza, sasitë e mbeturinave të depozituara, shfrytëzimi i pesticideve për mbrojtjen e bimëve, numri i objekteve të rrënuara që janë ndërtuar pa leje në zonën e mbrojtur, etj).

Parametrat fizikë që do të ndiqen për të vlerësuar shkallën e zbatimit të këtij Plani janë këto:

1. **Trashëgimia natyrore** – parametrat ekologjike dhe të zonës:

- Mbikëqyrja në zonat e mbrojtura në pajtim me programet e mbikëqyrjes dhe planet për menaxhim me këto zona të mbrojtura me të cilat përcaktohen parametrat dhe shpeshtësia e matjes;
- Mbikëqyrja e rreziqeve që mund të kenë ndikim negativ mbi vlerat natyrore:
  - Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara (me shpeshtësinë e matjes që do të harmonizohet me Entin Hidrobiologjik);
  - Sistemi i kolektorit i rikonstruktuar (km), (me shpeshtësinë e ndjekjes një herë në vjet);
  - ONB5 i ujërave të zeza të trajtuara të derdhur në Drinin e Zi (me shpeshtësinë e matjes një herë në ditë);
  - Sasitë e mbeturinave të depozitura në mënyrë të paligjshme (shpeshtësia e matjes një herë në muaj);
  - Numri i objekteve të rrënuara që janë ndërtuar pa leje në zonat e mbrojtura (shpeshtësia e ndjekjes një herë në muaj);
  - Depoziti eroziv nga Lumi i Sateskës (m3) me shpeshtësinë e matjes një herë në vjet;

2. **Trashëgimia kulturore**: Rajoni i Ohrit është zonë që ka plot lloje të ndryshme ndërtesash dhe monumentesh me specifikat e tyre për sa u përket konteksteve arkitektonike, ambientale dhe estetike dhe secila prej tyre duhet të ndiqet në një mënyrë të veçantë. Për të siguruar mbrojtje cilësore jo vetëm të trashëgimisë kulturore, por edhe të mjedisit të tij të përgjithshëm natyror, është e domosdoshme të ndërmerren aktivitete të vazhdueshme në aspekt të ndjekjes së gjendjes, duke përfshirë:

- Gjendjen e trashëgimisë kulturore që do të ndiqet përmes mbikëqyrjes në nivel vjetor si pjesë e programit vjetor të institucioneve të mbrojtjes, ndërsa do të përfshijë:

- ndjekjen e gjendjes fizike të ndërtesave;

- ndjekjen e rrënimeve të mundshme ambientale;

- ndikimin e së mirës nga vizita e turistëve;

- çdo mbikëqyrje duhet të rezultojë me njoftimin për progresin, por edhe identifikimin e prioriteteve për vitin e ardhshëm;

Mbikëqyrja do të fokusohet në progresin me:

- mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- konservimin e të mirave kulturore;
- prezantimin e trashëgimisë kulturore;

Mbikëqyrja e aktiviteteve të njeriut do të përfshijë:

1. Mbikëqyrjen e realizuar gjatë zbatimit të projekteve të infrastrukturës, në pajtim me planet e mbikëqyrjes që do të përcaktohen me studimet për vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor.

RIKI

2. Monitorimi i vizitorëve:
    - Numri i vizitorëve në park nacional, muze, plazh, vizitorë që përdorin objekte lundruese etj (matja një herë në muaj)
    - Numri i bujtjeve sipas llojit të akomodimit (hotel, kamp, akomodim privat në qytet, akomodim privat në fshat etj) (matja një herë në muaj)
    - Cilësia e interaksionit me dhënësit lokal të shërbimeve dhe opinionin e përgjithshëm (matja një herë në vit).

## 1. Plani për menaxhim e vizitorë

Hapat kyç gjatë përpunimit të Planit për menaxhim me vizitorë janë të përkufizuar në Doracakun e UNESKOS[25], e që janë:

- Identifikimi i kërkesë rrjedhëse dhe të ardhshme nga destinacioni turistik nga ana e vizitorëve;
- Identifikimi i lokacioneve kritike për trashëgiminë natyrore dhe kulturore për shkak të vizitimit të madh;
- Identifikimi i baticave dhe zbaticave për vizitimin e destinacionit;
- Analiza mujore dhe ditore të numrit të vizitorëve;
- Analizë e numrit të vizitorëve gjatë festave shtetërore apo manifestimeve (festivaleve, etj);
- Analizë e numri të vizitorëve gjatë ditës;
- Parashikimi i trendeve afatgjatë dhe afatshkurtë lidhur me numrin e vizitorëve dhe presioneve për trashëgiminë për periudhën prej 5-10 viteve;

Përmirësimi i arritjes dhe qasjes për të gjitha kategoritë e vizitorëve deri tek të mirat e mbrojtura individuale dhe tek arealet e rëndësishëm të të mirave do ta përmirësojë edhe përvojën e vizitorëve si dhe kuptimin e vlerave të kësaj trashëgimie botërore.

Ky Plan për vizitorë do të fokusohet edhe në sigurimin e përmbajtjeve me cilësi të lartë për vizitorët, promovim përkatës të trashëgimisë botërore dhe nevojën për rritjen e leverdisë nga turizmi për ekonominë lokale me respektim maksimal të vlerës universale të të mirave.

Që të mundësohet përpunimi i Planit të hollësishëm për vizitorët është e domosdoshme të vendosen mekanizma për mbledhjen e të dhënave. Nevojitet të vlerësohet gjendja e objekteve për vizitorë dhe sipas nevojës të bëhen plane për përmirësim eventual.

Në mungesë të të dhënave, rekomandohet si masë afatshkurtër të përpunohet Plan për menaxhim me vizitorë.

[25] http://whc.unesco.org/sustainabletourismtoolkit/sites/default/files/UNESCO%20toolkit%20PDFs%20guide%208C.pdf

## 2. Program për edukim

Një nga çështjet elementare për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit është ngrijtja e vetëdijes publike për vlerat e rajonit të të gjitha strukturat civile e politike, komunitetin lokal dhe në nivel nacional, si të vlerësohen në mënyrën e duhur nevojat dhe mundësitë e zhvillimit në raport me vlerat e tij.

Për shkak të njohjes së pamjaftueshme të vlerës të jashtëzakonshme universale të rajonit të Ohrit, imponohet nevoja për edukim. Qëllimi i tij është që të përfshihen grupet përkatëse të cakut dhe të rritet vetëdija e tyre për rëndësinë e vlerave në rajon, rreziqet e mundshme dhe roli i individit në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale të rajonit.

Që të ketë qasje deri tek grupet përkatëse të cakut dhe t'u përçohet mesazhi i nevojshëm, se si edhe ata të angazhohen në mbrojtjen e vlerave, është e domosdoshme të përpunohet Plan për komunikim, i cili do të përfshijë:

1. Selektimin e palëve të përfshira dhe grupeve të cakut sipas arsimit, gjinisë, moshës, interesit etj.
2. Sjellja e grupit apo individit që duhet të ndryshojë:
   - Interes për ndërtim në rajonin e mbrojtur
   - Përdorim të objekteve lundruese me motor me karburant fosilik
   - Deponim ilegal të mbeturinave
   - Motivim i dobët për të mësuar për vlerat natyrore dhe kulturore
   - Tjera
3. Përkufizimi i mesazhit apo mesazheve:
   - slogan
   - mesazhi sekondar
4. Mënyra e komunikimit:
   - Media elektronike
   - Media alternativa
   - Rrjete sociale
   - Tryeza të rrumbullakët, konferenca, ekskursione
   - Broshura, pamflete

### 2.1. Edukimi i të rinjve

Trashëgimia botërore përdoret edhe si resurs arsimor. Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme është detyrë serioze. Nxitja e vetëdijes për vlerën e tyre është çelësi për ruajtjen e tyre, kurse për këtë qëllim, mjeti më i fuqishëm dhe më efikas është arsimimi i të rinjve. Të rinjtë janë ata që në të ardhmen do të marrin vendime dhe do ta kenë detyrën t'i ruajnë vlerat e trashëgimisë. Arsimimi i të rinjve në fushatën e trashëgimisë tonë të përbashkët, u jep mundësi që më mirë të njohin veten dhe prejardhjen e tyre. Kjo gjithashtu, u ndihmon të mësojnë më shumë për të tjerët. Ndjenja për identitetin dhe plotësimin të cilin mund ta fitojmë përmes kulturës të cilës i takojmë, ka rëndësi elementare për vlerësimin e llojllojshmërisë së madhe të të mirave botërore, që duhet të përcillen gjeneratë pas gjenerate. Në këtë drejtim, shkollat kanë rol të rëndësishëm në nxitjen e të rinjve për ta kuptuar domethënien e

gjerë të të mirave nga Trashëgimia botërore, si dhe ndikimin që individë të caktuar mund ta kenë për gjendjen dhe të ardhmen e të mirave.

Vlera e jashtëzakonshme dhe rëndësia universale për ruajtjen e trashëgimisë botërore për gjeneratat e ardhshme, ofrojnë mundësi të shumtë, të rrallë dhe shpesh multidisiplinare dhe interdisiplinare për ligjërim dhe mësim. Duke pasur parasysh që në shumicën e shkollave, planet arsimore janë të ngarkuara ndërsa arsimtarët ballafaqohen me shumë kërkesa, ata që duan tek të rinjtë ta zhvillojnë ndjenjën për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë botërore, deri më tani janë vendosur për qasje të integruar.

Për këtë qëllim, në vitin 1999 UNESKO përgatiti Veglën arsimore mësimore "*Trashëgimia botërore në duart e të rinjve*"[26] qëllimi i secilës është që konceptimin e edukimit për fushën e trashëgimisë botërore ta inkorporoj në sistemin arsimor. Vegla synon përfshirjen e të rinjve në edukimin për trashëgiminë dhe në aktivitetet për ruajtjen e saj brenda dhe jashtë klasave, lokalitetet lokale dhe nacionale, në bashkëpunim me të gjithë faktorët, siç janë: drejtorët, komunat, sektori civil dhe pushteti relevant lokal dhe qendror.

Vegla arsimore ka vlerë të madhe, sepse është punuar mbi themelet e përvojës praktike dhe u dedikohet arsimtarëve të shkollave të mesme:

- që ligjërojnë gjithandej në botë në kushte të ndryshme, përfshirë edhe ato që janë të vështira (mungesë e infrastrukturës shkollore, mungesë të materialeve arsimore dhe pajisjes, numër të madh të nxënësve në klasë, planeve të stërngarkuara arsimore, etj), si dhe për ata që punojnë nëpër shkolla të pajisura me teknologji më të re në arsim (internet etj).
- ata që nxënësve të moshës 12-18 vjeç u ligjërojnë lëndë të ndryshme: gjeografi, histori, gjuhë amtare, shkenca natyrore, matematikë, art figurativ, etj.

Përmes qasjeve inovative arsimore ofrohet mbështetje për ruajtjen e **trashëgimisë botërore kurse me këtë të rinjve/ nxënësve u mundësohet:**

- të mësojnë më shumë për lokalitetet kulturore dhe natyrore në rajonet e shënuar në Listën e trashëgimisë botërore, që posedojnë vlerë të jashtëzakonshme universale;
- të fitojnë shkathtësi të reja, të nevojshme për t'u ruajtur këto lokalitete si trashëgimi botërore;
- të ndërtojnë qëndrime të reja dhe përkushtim ndaj ruajtjes së trashëgimisë tonë lokale, nacionale dhe botërore për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme;
- të luajnë rol kyç në ruajtjen e llojllojshmërisë së jashtëzakonshme kulturore në botë, përmes bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Vegla arsimore përmes formave të ndryshme të aktiviteteve, vizita të lokaliteteve e kështu me radhë, mundëson të rinjtë t'i përfitojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme në detektimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë botërore.

[26] www.unesco.org/whc/education; *Trashëgimia botërore në duart e të rinjve* - Shkup: Ministria e Kulturës në Republikën e Maqedonisë, Komisioni Nacional i UNESKO-s, 2012

### 2.2. Ngritja e vetëdijes publike të grupeve tjera të cakut

Organet e administratës shtetërore dhe kryetarëve të komunës Ohër, Strugë dhe Debërc, secili në suazat e kompetencave të tyre, janë të obliguar të ndërmarrin masa për nxitjen e arsimit dhe zbatimin e programeve informative me qëllim që të njihet popullata me vlerat e rajonit, nevoja dhe domethënia e respektimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyre në rajonin e Ohrit. Organet e administratës shtetërore, komunat si dhe persona juridik e fizik obligohen ta informojnë opinionin për vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, për rreziqet që i kërcënohen trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe për masat e ndërmarra për ruajtjen e saj.

### 2.3. Trajnimi i udhëheqësve turistik

Turizmi është një prej industrive me rritje më të shpejtë në rajonin e Ohrit dhe është burimi i të ardhurave për popullatën lokale. Si industri e orientuar për njerëzit, turizmi gjithashtu siguroj shumë vende pune, që ndihmon në ringjalljen e ekonomive lokale. Megjithatë, s i edhe format tjera të zhvillimit, turizmi gjithashtu mund të shkaktojë një pjesë të problemeve, siç është dislokimi social, humbja e trashëgimisë kulturore, varësia ekonomike dhe degradimi i mjedisit jetësorë. Pikërisht për këtë, nevojitet të ngrihet vetëdija tek udhëheqësit turistik rreth ndikimeve të mundshme që potencialisht i bën turizmi masovik dhe si ato të ndikojnë si edukatorë të turistëve, në drejtim të uljes së presioneve ndaj vlerave natyrore dhe kulturore nga vizitat turistike. Për këtë qëllim, ekziston një program i UNESKO-s[27] që ndihmon të identifikohen mënyrat me të cilat turizmi stabil mund t'u afrohet të gjithë atyre që bëjnë pjesë në sektorin turistik.

### 2.4. Trajnimi i nëpunësve administrativ dhe punonjësve të sektorit publik

Mos- ekzistimi i një sistemit në sistemin arsimor për edukim të vazhdueshëm dhe specializim të kuadrove nga fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, krijon atrofi të theksuar të shërbimeve për mbrojtën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Në suazat e Entit për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe Muzeu- Ohër (institucion kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rajon) ekziston repart arkitektonik, i pajisur me pajisjen e nevojshme për realizimin e punëve hulumtuese, përpunim të projekteve dhe studime për përparimin e trashëgimisë botërore kulturore. Ekziston edhe qendra e dokumentimit INDOS, ku është vendosur dokumentacioni i plotë që e ka institucioni për trashëgiminë të tundshme dhe të patundshme kulturore në territorin e rajonit të mbrojtur.

Me themelimin e Fakultetit të turizmit dhe hotelierisë në Ohër, është formuar kuadër i cili është i domosdoshëm për funksionimin e hotelierisë dhe turizmit. Kjo paraqet kusht për zhvillimin e të gjitha formave të turizmit, ku pushtetit lokal dhe popullata e shohin mundësinë e zhvillimit.

Ekzistimi i Institucionit publik shkencor, Instituti hidrobiologjik- Ohër (i themeluar në vitin 1934), dëshmon faktin që shkenca çdoherë ka qenë e interesuar për gjendjet me biodiversitetin e liqenit dhe rrethinës së tij më të afërt.

Njoftimi dhe promovimi përkatës për vlerat e vërteta, kontribuon në ngritjen e vetëdijes publike, para se gjithash të popullatës lokale si faktor bazë për ruajtjen e vlerave. Qëllimi është mbrojtja, ruajtja dhe prezantimi i të mirave integrale në funksion të jetës së përditshme dhe afirmimin e tij ndërkombëtarë.

[27] http://www.unesco.org/education/tlsf/mods/theme_c/mod16.html

**Gjatë përpunimit të Planit, në komunikim me palë të ndryshme të përfshira, është vërtetuar se djegia e kallamit nga popullata lokale dhe shërbimet, konsiderohet si mënyrë tradicionale për eliminimin e biomasës pas tharjes së kallamit në vjeshtë. Është e domosdoshme të përcillet mesazhi për dëmet që i sjell praktika e këtillë.**

Synimi kryesor është që të përmirësohet niveli i informimit, edukimit dhe promovimit për vlerat, zbatimin e aktiviteteve hulumtuese si dhe ngritjen e vetëdijes publike sidomos në komunat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës, me qëllim që të bashkëngjiten grupet e cakut në nivel nacional dhe lokal dhe të ngritet vetëdija e tyre për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të mira.

Për shkak të domethënies dhe përqendrimit të trashëgimisë kulturore në këtë rajon, është themeluar Institucion i posaçëm nacional për mbrojtje, Enti për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe Muzeu- Ohër, që në koordinim me Qendrën nacionale konservatore e kanë kompetencën në domenin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Për këtë, Institucioni nacional për mbrojtje, Enti për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe Muzeu- Ohër do të jetë e angazhuar për zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike për domethënien e trashëgimisë kulturore përmes organizimit të ngjarjeve edukative dhe publikimeve, që do të ndikojnë në sjelljen e qëndrueshme të opinionit ndaj përmendoreve kulturore- historike.

Promovimin e vlerave natyrore do ta bëjnë të punësuar në Institucionin publik, Parkun nacional Galiçica. Për këtë qëllim, ekzistojnë pika informative dhe materiale edukative që përkohësisht duhet të formohen për t'i ndjekur trendet e veglave komunikatave dhe të jenë në hap me rezultatet nga hetimet më të reja shkencore lidhur me llojllojshmërinë biologjike dhe shërbimet e sistemeve ekologjike.

## 2.5. Trajnimi u bujqve për prodhimtari të pranuar ekologjike

Për shkak të rrezikut për eutrofikimin e Liqenit e Ohrit, i shkaktuar para se gjithash nga bujqësia konvencionale, nevojitet edhe edukimi i pronarëve të tokave bujqësore. Edukimi do të ishte për mundësitë e prodhimit organik pa përdorim të kimikateve bujqësore, metoda efikase dhe të qëndrueshme të fertilizimit, ujitjes, grumbullimit të organizimit të mbeturinave bujqësore si dhe mundësinë për promovim/ plasim të këtyre produkteve. Përveç ligjëratave, nevojitet që të mbahen sesione informative dhe forume ku do të marrin pjesë përfaqësues të sektorit bujqësor, prodhues bujqësorë, përfaqësues të pikave blerëse për produktet bujqësore dhe shoqatat tregtare, prodhues të produkteve bujqësore nga rajoni.

Për zhvillimin e mjediseve rurale dhe ruajtjen e mjedisit jetësorë, nevojitet edukimi i bujqve në shfrytëzimin e teknologjive të IT-së, sipas shembullit të SMART VILLAGES në Republikën e Sllovenisë dhe vende tjera. Në fshatrat e mençura, rrjetat tradicional dhe të reja si dhe shërbimet do të forcoheshin përmes teknologjitë digjitale dhe të telekomunikimit, inovacioneve dhe përdorimit më të mirë të njohurive, në dobi të banorëve dhe biznesit. Teknologjitë digjitale dhe inovacionet mund të mbështesin cilësinë e jetës, standardin më të lartë jetësorë, shërbimet publike për qytetarët, përdorimin më të mirë të resurseve, e me këtë më pak ndikim ndaj mjedisit

jetësorë dhe mundësi të reja për zinxhirin rural të vlerave, në raport me produktet dhe proceset e përmirësuara[28].

Duke zhvilluar programe për koordinim të aktiviteteve të bujqve në fushat e interesit të përbashkët për ruajtjen dhe përparimin e llojllojshmërisë biologjike, do të mundësohet zhvilli i qëndrueshëm.

## 2.6. Mekanizma për përfshirjen e qytetarëve

Ngritja e vetëdijes publike nuk mund të ketë sukses vetëm me angazhim profesional, politik dhe të ekspertëve në sektorin publik, sepse domethënie e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në parim, ka të bëjë me të gjitha aspektet e jetës së përditshme të qytetarëve- punë, shërbime, sipërfaqe publike, objekte publike, shërbime publike, aspekti ekonomik, kultura etj. Për këtë, e tërë kjo nuk guxon të jetë në kundërshtim me synimet e vet mjedisit qytetar. Nevoja e komunikimit të vazhdueshëm me qytetarët dhe sektorin civil vlerësohet si shumë e rëndësishme. Mënyra e bashkëpunimit dhe përfshirja e tyre në aktivitetet në përgjithësi përmban pako të pasave (si model operativ i ofruar në *"Studimin për mbrojtje të integruar të Qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit*[29]*)*, edhe atë:

- Përfshirje të qytetarëve në aktivitetet e sektorit publik (komunale, shtetërore) për të fituar njohuri dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje në fazat e ndryshme të procesit të ruajtjes së trashëgimisë kulturore;
- Mundësi që në çdo fazë të procesit të revitalizimit të trashëgimisë të vlerësohet niveli i pranimit të projekteve individuale nga qytetarët dhe aftësimi i tyre të marrin pjesë në të njëjtat.
- Mekanizmat demokratik duhet të vendosen që në fillim që procesi të jetë kolektiv dhe të ketë sukses;
- Në proces duhet të përfshihen të gjitha komunitetet etnike, sociale, kulturore dhe fetare, në përputhje me parimin e mos- diskriminimit;
- Mekanizmat nuk do të jenë vetëm për pjesëmarrjen e qytetarisë së gjerë dhe ad- hoc, por për të gjithë palët e përfshira- pronarë, konsumatorë, tregtarë, hotelierë, OJQ etj.
- Faktorë tjerë ekonomik që mund të marrin pjesë në investim apo ndonjë lloj tjetër të theksimit dhe përparimit të vlerave kulturore;
- Pjesëmarrja e qytetarëve duhet të jetë e organizuar në të gjitha fazat e procesit të revitalizimit (analitike- diagnostike, planifikim strategjik, zbatim). Kjo do të nënkuptojë komunikim të vazhdueshëm me qytetarët dhe sektorin civil.

Mekanizmat për pjesëmarrje duhet të projektohen në atë mënyrë që të sigurojnë komunikime të vazhdueshme dhe relevante në dy drejtime (popullatë drejt ekipeve profesionale- operative dhe ekipe profesionale- operative drejt popullatës) përmes diskutimeve publike, konsultimeve, harmonizimit të qëndrimeve, marrëveshjeve, anketave, intervista, punëtorive, ekspozitave, buletineve etj.

Sipas Programit të mjedisit jetësorë të Kombeve të Bashkuara (UNEP), "Muzika është një prej mediave më të fuqishëm për përçimin e mesazhit për mbrojtjen e ambientit jetësorë deri tek miliardë njerëz në botë, pa marrë parasysh ngjyrën, religjionin, të ardhurat, gjininë ose moshën"

[28] https://biznisregulativa.mk

[29] Plan- Studim për mbrojtje të integruar të qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit, Komunës së Ohrit dhe Entit për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe Muzeu- Ohër, Ohër 2015;

(2014. Në periudhën e verës në rajonin e Ohrit ekziston tradita e mbajtjes së festivaleve të mëdha me artistë të mëdhenj botërorë, të cilët tërheqin numër të madh të vizitorëve siç është festivali katërditor "Ohrid calling festival", me minimum 20.000 vizitorë në ditë nga mbarë Evropa, festivali dyditor "Green beach festival" në Strugë me 10.000 vizitorë. Festivalet kanë shumë aspekt ku mund të përfshijnë edukimin për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe kulturore përmes: ndikimit ndaj furnizuesve të tyre, biseda me organizatorët, sponsorët, angazhimin e ndikuesve të cilët përmes rrjeteve sociale do të bëhen model për rolin e pjesëmarrësve, etj.

### 2.7. Mekanizma për ngritjen e vetëdijes përmes mediave sociale

Sot e pakontestueshme është fuqia e mediave digjitale, me theks të veçantë të rrjeteve sociale në këmbimin e informatave dhe ngritjen e vetëdijes publike. sipas hulumtimeve, mediat sociale janë mënyrë më praktike moderne për përdorim të suksesshëm të njohurive dhe krijimin e strategjisë për përparim.

Mediat sociale janë të shumtë në numër, mes të cilëve më të njohura janë: blogjet, mikro-blogjet (Twitter), rrjeti social (Facebook, LinkedIn, Instagram), faqet për shpërndarje (YouTube, Flickr,Pinterest), faqet sociale për selektim dhe votim (DIgg, Reddit), faqet për kërkim (Yelp, Trip advisor), forumet dhe botërat virtuale (Second Life).

Zhvillimi i rrjeteve sociale ke sjellë deri në paraqitjen e ndikuesve digjital- njerëz që krijojnë përmbajtje të mediave sociale apo blogjeve dhe që kanë përfituar numër të madh të ndjekësve, ata janë këshilltarët e gjeneratës së re. Përmes zhvillimit të fushatës së marketingut inovativ dhe social për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, vizioni i këtij Plani mundet në mënyrë tërheqëse të përcillet tek të gjithë.

## 3. Plani për menaxhimin me rreziqe nga katastrofat

Katastrofat dhe rreziqet nga katastrofat janë faktor i paevitueshëm që mund të ndikojë në prishjen apo shkatërrimin e vlerave të të mirave. Katastrofat janë pasojë nga rreziqet që mund të përkufizohen si natyrore apo të shkaktuar nga faktori njeri.

Rreziku nga katastrofat nënkuptohet si funksioni i "rrezikut".

Për këtë, Plani për menaxhimin me rrezikun nga katastrofat duhet t'i ketë parasysh llojet dhe burimet e rreziqeve që mund të ndikojnë ndaj të mirave dhe ekspozimi i të mirave natyrore dhe kulturore ndaj këtyre rreziqeve në nivele të ndryshme.

Zbatimi efikas i këtij plani do ta përforcojë ruajtjen dhe mbrojtjen e komponentëve natyror dhe kulturor të të mirave. Plani për menaxhimin me rreziqet nga katastrofat periodikisht duhet të shqyrtohet/ revidohet, me qëllim të miratimit të masave të reja si përgjigje ndaj dukurive të ndodhura dhe nevojat në të ardhmen.

## 4. Financimi i zbatimit të Planit për menaxhim

Aktivitetet e propozuara në plan do të koordinohen dhe realizohen nga subjekte të ndryshme, në përputhje me kompetencat e tyre. Në pjesën më të madhe të aktiviteteve, mjetet do të sigurohen nga buxhetet e komunave Ohër, Strugë dhe Debërc si dhe nga buxheti nacional. Mjetet për

aktivitetet e parapara në mënyrë alternative mund të sigurohen edhe nga mjete të fituara nga shfrytëzimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit si dhe burime tjera të financimi, donacione, grante, kredi, dhurata etj.

## 5. Revizioni i Planit për menaxhim

Plani për menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit miratohet për periudhë prej nëntë viteve.

Duke pasur parasysh që vizioni në Planin afatgjatë parashikon menaxhimin e trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit, në mënyrë konsekuente edhe synimet e planit janë relevante për periudhë më të gjatë kohore.

Njohuritë e reja, ndryshimi i rrethanave socio- ekonomike mund të ndikojnë në ndryshimin e prioriteteve menaxhuese dhe të obligojnë ndërmarrjen e masave shtesë nga palët e përfshira, sidomos duke pasur parasysh faktin që principi i menaxhimit është evolues dhe proces dinamik, që nuk ndërpritet me miratimin e Planit për menaxhimin e trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit.

Në këtë drejtim, revizioni i planit nevojitet të bëhet në çdo 3 (tre) vite kurse revizioni i zonave të kontaktit pas determinizmit të tyre në çdo 6 (gjashtë) vite.

Revizionin e Planit për menaxhim e bëjnë Komisioni për menaxhim me trashëgiminë natyrore dhe kulturore, Ministria e kulturës- Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë- Drejtoria për mjedis jetësorë (secili në domenin e kompetencave të veta) në bazë të të dhënave të përditësara për zbatimin e synimeve dhe zbatimin e Planit të veprimit të Planit për menaxhim.

## SHKURTESA

| | |
|---|---|
| **MK** | Ministria e Kulturës |
| **MMPH** | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| **MASH** | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| **VLO** | Vetëqeverisja lokale Ohër |
| **VLS** | Vetëqeverisja lokale Strugë |
| **VLD** | Vetëqeverisja Lokale Debërcë |
| **EMO** | Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut - Ohër |
| **ME** | IK Muzeu "Dr. Nikolla Nezlobinski" - Strugë |
| **MTL** | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve |
| **ME** | Ministria e Ekonomisë |
| **MBPEU** | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave |
| **MOB** | Ministria e Punëve të Brendshme |
| **AMK** | Agjencia e Menaxhimit me Kriza |
| **SHHM** | Shoqata e Hoteleve të Maqedonisë |
| **SHATM** | Shoqata e Agjencive Turistike në Maqedoni |
| **MEST** | Ministria e Ekonomisë - Sektori i Turizmit |

| | |
|---|---|
| **MVL** | Ministria e Vetëqeverisjes Lokale |
| **QKK** | Qendra Kombëtare e Konservimit - Shkup |
| **ELEM** | Elektrocentralet e Maqedonisë |
| **KOM** | Kisha Ortodokse Maqedonase |
| **BFI** | Bashkësia Fetare Islame |
| **FTH** | Fakulteti i Turizmit dhe Hotelierisë- Ohër |
| **PKG** | IP Parku Kombëtar "Galiçica" |
| **IHB** | Instituti Hidobiologjik - Ohër |
| **QRMV** | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| **DDRM** | Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë |
| **MF** | Ministria e Financave |
| **DMTK** | Drejtoria e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore |
| **DMJ** | Drejtoria e mjedisit jetësor |
| **APH** | Agjencia e Planifikimit Hapësinor |
| **AKPP** | Agjencia e Kadastrit të Pasurive të Patundshme |
| **ASPP** | Agjencitë e Sigurimeve të pronave dhe personave |
| **MPB** | Ministria e Punëve të Brendshme |

| | |
|---|---|
| **FRr** | Fondi Rrugor |
| **APMT** | Agjencia për promovimin dhe mbështetjen e turizmit |
| **OJQ** | Organizata joqeveritare |
| **SB** | Sektori i biznesit |
| **OERMV** | Oda ekonomike e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| **Komisioni** | Komisioni për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Rajonit të Ohrit |

## Shtojca 1: Vlerat natyrore

Trashëgimi botërore në rajonin e Ohrit përmban vlera të shumta natyrore që i përbëjnë veçoritë gjeografike- ambientale të rajonit, ku përfshihen motive nga natyre iskonike, para se gjithash të Liqenit të Ohrit. Me rëndësi të veçantë për shkencën janë 212 llojet endemike, prej të cilëve 182 janë lloje të kafshëve. Një pjesë e tyre paraqesin fosile të gjalla, thuajse të pandryshuara nga koha e tercierit, siç është shpuza, llojet relikte të kërmijve kurse prej peshqve, trofta dhe belushka.

Liqeni i Ohrit me 212 llojet endemike në sipërfaqe prej 358,2 $km^2$ paraqet liqenin me llojllojshmërinë më të madhe në botë, duke pasur parasysh sipërfaqen e tij.

Shfaqja më e eksplicite e llojllojshmërisë në Liqenin e Ohrit shihet te grupet e faunës bentale, ku ekzistojnë linja të tëra evolutive: rodhet (Hirudinea), gaforret (Crutacea), guacat (Bivalvia), kërmijtë (Gastropoda) dhe krimbat (Turbellaria). Tek disa nga këto grupe, krahas biodiversitetit të madh, veçori të veçantë paraqitet edhe niveli i endemizmit, që lëviz në kufijtë prej 54% tek grupi (Hirudinea) e deri në 79% tek grupi (Gastropoda). Vlen të përmendet edhe numri i madh i llojeve të algave relikte, në mesin e të cilave janë diatomet.

Taksonet e evidentuara në zonën pelagiale të Liqenit të Ohrit bëjnë pjesë në këto lloje të algave: Cuanophuta, Bacillariophuta, Chlorophuta, Chrusophuta dhe Purrophuta.

Me numër më të madh të llojeve (por me sasi të vogël) bëjnë pjesë algat e gjelbra, më pas algat blugjelbër ndërsa dominues për nga kuantiteti janë diatomet *Cyclotella fottii* dhe *Cyclotella hustedtii,* që përbëjnë diç më shumë se 40% të dendësisë së përgjithshme fitoplanktonike.

Në zonën litorale ekziston llojllojshmëri e dukshme më e madhe në grupin fitoplanktonik. Me numër më të madh bëjnë pjesë diatomet kurse pas tyre algat e gjelbra.

Hulumtimet e zooplanktonit, si pjesë e rëndësishme në zinxhirin e të ushqyerit në ekosistemet pelagiale akuatike, kanë rol të rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë së ujërave dhe stabilitetin e ekosistemeve të ujërave.

Në kuantitetin e përgjithshëm të zooplanktonit, si edhe sipas biomasës dominojnë përfaqësues nga Copepoda.

Në vendin e dytë për nga kuantiteti është grupi Rotifera, por ata kanë pjesëmarrje jo të rëndësishme në biomasën e përgjithshme të zooplanktonit.

Grupi Cladocera ka pjesëmarrje me një pjesë të vogël në zooplanktonin e përgjithshëm. Por, duke pasur parasysh biomasën e tyre të madhe individuale, si dhe përfaqësimin e tyre kuantitativ, sidomos në periudhën e verës kur në zooplankton bëjnë pjesë dy llojet aloktone: Diaphanosoma birgei lacustris dhe Leptodora kindtii (të evidentuara në dekadën e fundit), ato kanë pjesë të rëndësishme në biomasën e përgjithshme të Cladocera, gjegjësisht, në biomasën e përgjithshme të zooplanktonit.

Llojet endemike në Liqenin e Ohrit janë: A*rctodiaptomus steindachneri* Rich, 1897, *Cyclops ochridanus* Kiefer,1931 dhe sipas Lova dhe Starobogatov (1982) dhe stadet e larvave nga lloji *Dreissena (Carinodreissena) stankovici.*

Vegjetacioni makrofit i liqenit shtrihet në tre zona: e para është rripi i kallamit (Pgragmites), e dyta e llojit të potamogetonit (Potamogeton) dhe e treta është në vet rripin.

Bota bimore në Liqenin e Ohrit karakterizohet me llojllojshmëri të florës, me tre grupe karakteristike të makrofiteve; makrofite emergente, flotante (notuese) dhe submerse (zhytëse).

Nga numri i përgjithshëm i makrifoteve të evidentuara, me përqindja më të madhe bëjnë pjesë makrofitet submerse (zhytëse) me (rreth 75%), vijojnë makrofitet emergente me (rreth 16) dhe ato flotante me (vetëm 9%).

Nga bimët emergente dominon kallami, *Phragmites australis* e cila paraqet rripin rreth liqenit me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 4 ha (0,31% nga sipërfaqja e përgjithshme e liqenit) ndërsa nga bimët submerse dominon zambaku i ujit, *Potamogeton perfoliatus* (1021,13 ha - 4,28%) dhe hara *Chara tomentosa* si dhe lloje tjera të harës (1049,16 ha- 4,39 %) që së bashku mbulojnë rreth 2070,16 ha – gjegjësisht 8,67 % nga sipërfaqja e përgjithshme e liqenit.

Në Liqenin e Ohrit dominojnë edhe llojet makrofite që janë tregues për ujërat e kategorisë së dytë *(Nuphar lutea (L.) Smith, Polygonum amphibium L., Potamogeton perfoliatus L., Muriophullum spicatum L., Myriophyllum verticillatum L., Ceratophyllum demersum L., Elodea canadensis Rich.&Michh., Najas major All. dhe Lemna trisulca L.).*

Zakonisht, zona litorale është më e dendur. Është strehë e numrit më të madh të llojeve nga fauna bentale, me përjashtim të formave më të thella. Kështu, në këtë zonë përqendrohen llojet si:Turbellaria, Oligochaeta, Hirudinea, Bivalvia, Gastropoda, Amphipoda, Isopoda dhe Insecta.

Në zonën sublitorale në mënyrë kuantitative më i përhapur është lloji Dreissena prespensis. Kjo zonë është strehë e këtyre llojeve të makroozobentosit: Ochridospongia rotunda, Dendrocoelum lychnidicum, Peloscolex stankovici, Asellus arnautovici, Polinskiola polinskii etj.

Në zonën profundale i vërejmë këto lloje: *Criodrilus ochridensis, Macedopyrgula wagneri, Micropyrgula stankovici, Stankovicia baicaliiformis, Nimphargus foreli ochridanus* etj.

Në raport me përfaqësimin procentual të llojeve në veçanti në faunën e përgjithshme bentale, në profilin e EHB f. Radozhdë është vërtetuar se (në të tre zonat e thella), Amphipoda ka përqindje më të madhe gjegjësisht 31%. Vijojnë Oligochaeta me 24%, Bivalvia me 20%, Insecta me 9%, Hirudinea me 8%, Isopoda me 5%, Gastropoda me 3% dhe përqindje më të ulët ka Turbellaria me vetëm 1% (Trajanovski, S., 2004).

Për shkak të ekzistencës së gjatë të vazhdueshme në Liqenit të Ohrit nga tercieri e deri më sot, përmes rrugës natyrore dhe evolutive, në të është formuar dhe përqendruar iktiofaunë e jashtëzakonshme. Ndryshe, në kontekst të kësaj, të përmendim se pjesa më e madhe e llojeve janë endemike gjegjësisht ekzistojnë vetëm këtu dhe në asnjë vend tjetër në botë. Në mesin e tyre janë edhe llojet relikte, që janë ruajtur si formë jetësore nga koha e ardhjes së tyre në liqen.

Llojet e evidentuara autoktone i takojnë katër familjeve nga peshqit eshtëror edhe atë:

Llojet autoktone të evidentuara bëjnë pjesë në katër familjet e peshqëve me koc edhe atë: Salmodae, Cyprinidae, Cobitidae dhe Anguillidae. Familja Salmonidae (trofta) përmban dylloje gjegjësisht *Salmo troftë (Karaman) trofta dhe belushka e Ohrit – Acantholinqua ochridana (Steind.). Në familjen Cyprinidae të llojit të krapit bëjnë pjesë 12 lloje, edhe atë: Cyprinus carpio (L.)-krapi, Rutilus rubilio ochridanus (Karamana) -gruneci, Pachyhilon pictus (Heck. et Kner) -moraneci, Phoxinellus minutus (Karaman) -grunci, Leuciscus cephalus (Bonap.) -klen, Phoxinus phoxinus (L.) -pijori, Scardinus erythrophthalmus scardafa n. ochridanus (Vlad. et Petit) -lloska, Chondrostoma nasus ochridanum (Karaman) -njila, Gobio gobio ochridanus (Karaman) -*

*mreneci, Barbus meridionalis petenyi Heck. -mrena, Alburnus alburnus alborella (Filippi) -cironka, Alburnoides bipunctatus ochridanus (Karaman) -ranushi.*

Nga familja e gaforreve (Cobitidae) dallohen dy lloje: *kleni– Nemachilus barbatulus sturanyi (Steind.) dhe ngjala Cobitis taenia meridionalis (Karaman).*

Nga familja Anguillidae dallohet njëlloj gjegjësisht ngjala Anguilla anguilla (L.).

Në Liqenin e Ohrit, përveç peshqve autokton, takojmë edhe lloje peshq alokton edhe atë: trofta ylbere *Oncorhynchus mykiss* (Wal.) dhe forma e tij albinë (ngjyrë ari), *peshku i artë Carassius carassius (L.), korani Rhodeus sericeus,sharoku Lepomis gibbosus* (L.), *notaku Pseudorasbora parva (L.), si dhe formë peshku të krapit (krapi lakuriq).*

Kur jemi tek biodiversiteti, i rëndësishëm është lokaliteti[30] - moçali i Studençishtës, i valorizuar si fenomen natyror i ruajtur me mileniume, që para jo shumë kohë, ka qenë pjesë integrale e Liqenit të Ohrit.

Në hapësirën e moçalit të Studençishtës në dekadën e fundit janë evidentuar pesë komunitete të moçaleve:

1. Asociacioni Scirpeto-Phragmitetum W. Koch 1926

2. Asociacioni Oenantheto- Roripetum Lohm. 1950

3. Asociacioni Sparganio-Glycerietum fluitantis Br.-Bl. 1925

4. Asociacioni Caricetum elatae W. Koch 1926

5. Asociacioni Cyperetum longi Mic. 1957

Me valorizimin e kryer në lokalitetin e moçalit të Studençishtës në vitin 2012 dhe në bazë të të dhënave ekzistuese shkencore, është vërtetuar prezenca e 89 llojeve të algave silikate (diatome). Pjesa më e madhe e këtyre llojeve gjegjësisht rreth 62 bëjnë pjesë në grupin e llojeve me përhapje kozmopolite. Është vërtetuar prezenca e 11 llojeve endemike dhe katër lloje të rralla të florës në Maqedoni (me dy deri në pesë lokalitete) dhe një lloj për të cilin ky moçal është gjetje e parë për Maqedoninë.

Florën e përbëjnë llojet e moçaleve me përhapje të gjerë, prej të cilëve do të përmendim llojet e rralla siç janë *Ceratophylum submersum L.,Nuphar lutea L.*, *Polygonum amphibium* L., *Cyperus longus L.* etj.

Për florën e livadheve nënujore mund të gjenden të dhëna në studimet e Talevskës (2005) dhe Trajanovskës (2002,2009). Sipas Talevskës (2005), në këto lokalitete mund të vërehen 11 hidrofite vaskulare dhe gjashtë theka.

Nga fauna pakurrizore në moçalin e Studençishtës, sipas të dhënave të (Filevskës 1954; Peters & Hackethal 1986; Jović & Mihajlova 2009) dhe hulumtimet në terren mund të nënvizohen 34 lloje të kuajve të zanave. Në rajonin e Ohrit gjatë tërë vitit mund të takohen 138 lloje të fluturave ditore, që paraqet 68% nga numri i përgjithshëm i llojeve në shtet (Scheider & Jakšić, 1989; Krpač & Mihajlova, 1997; Melovski, 2004; Verovnik & Micevski, 2008). Si lloje më të rëndësihme që gjenden në rajonin e Ohrit janë: *Gegenes nostradamus, Cupido argiades, Cupido*

[30] Lokalitetet me vlera natyrore në rajonin e Ohrit janë shënuar në hartën me kufijtë të trashëgimisë kulturore dhe ntyrore të rajonit të Ohrit (shtojcë)

*alcetas, Polygonia egea, Melitaea diamina* dhe *Neptis rivularis.* Për moçalin e Studençishtës të rëndësishëm janë këto lloje të fluturave ditore (*Lycaena dispar*, Maculinea *arion*, *Parnassius mnemosyne* dhe *Zerynthia polyxena*) që kanë interes të veçantë të konservimit për BE-në. Në vitin 2010, nga familja e garuesve (Coleoptera Carabidae) regjistrohen 39 lloje, por disa prej tyre janë të rralla për faunën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Si lloje të rralla janë: Agonum *lugens, Apiceum, Amara convexiuscula, Stenolophus skrimshiranus, Brachinus elegans, Stenolophus proximus, Pterostichus elongatus Oodes helopioides* dhe O.*Gracilis.* Për burimet në afërsi të moçalit të Studençishtës, janë të njohura nëntë lloje të (Plathelminthes, Turbelaria, Tricladida).

Për shkak të afërsisë së moçalit të Studençishtës dhe lidhjes të drejtpërdrejtë me Liqenin e Ohrit, fauna e kurrizorëve të moçalit çdoherë është shqyrtuar në përbërje të faunës së Liqenit të Ohrit. Në kanalin e Studençishtës, si një nga furnizuesit e moçalit me ujë sot, në periudha të caktuara të vitit, vërehen 14 (nga 17 gjithsej) lloje autoktone të peshqve në liqenin e Ohrit si dhe tre lloje aloktone. Nga ujëtokësorët, vërehen të paktën nëntë lloje, të gjitha të përfshira në anekset 2 dhe 3 të Konventës së Bernit. Më të rëndësishëm në nivel evropian janë marmoti maqedonas dhe picërraku i verdhë, dy lloje me shtrirje të gjerë në mbarë territorin e vendit. Në moçalin e Studençishtës, vërehen të paktën katër lloje të zvarranikëve. Bolla me katër vija (*Elaphe quatorlineata*) vjen në moçal nga vendet përreth në kërkim të gjahut kurse kjo mund të jetë rast edhe me disa lloje tjera të shigjetave të shkurtra. Breshka e moçalit është lloji më i rëndësishëm i zvarranikëve që vërehen në moçal, por edhe ajo ka shtrirje të gjerë në vend. Në moçal, vërehen rreth 50 lloje të zogjve, por me numër të vogël të njësive apo çifteve (shpesh vetëm disa). Me përjashtim të disa llojeve të bilbilthëve me mustaqe, pulat e barit *dhe demi i vogël i ujit*, praktikisht nuk ka çerdhe tjera në moçal ndërsa ekzistojnë të dhëna për çerdhe të mjellmës me sqep të kuq (*Cygnus olor*). Nga gjitarët, më e rëndësishme është lundërza ndërsa ka edhe lloje tjerë të brejtësve, dhelpra (*Vulpes vulpes*), qelbësi (*Mustela putorius*), shqarthi (*Martes foina*) etj.

Vlerat e biodiversitetit të liqenit të Ohrit janë treguar në tabela.

Në territorin e rajonit të Ohrit, si trashëgimi botërore identifikohen këto lokalitete me vlerë natyrore:

1. Shën Mëria Kalishka- burime sublakustrike;

2. Kalishtë- vendbanimi i vetëm natyror i zambakut të verdhë të ujit (*Nuphar Lutea*) në liqenin e Ohrit;

3. Podmole- rripi më i përhapur i kallamit *(Phragmites australis*) në liqenin e Ohrit, vendbanimi natyror i llojeve të rrezikuara të zogjve dhe vendeve për shumimin e krapit;

4. Mazia- vendbanim i revitalizuar natyror i zambakut të verdhë të ujit (*Nuphar lutea*), vendeve për shumimin e krapit dhe çerdheve të zogjve;

5. Moçali i Studençishtës- vegjetacion makrofit dhe vendeve ku shumohen peshqit e llojit të krapit;

6. Veli Dab- burime sublakustrike, vendi i shumimit të troftës dhe biodiversitetit të faunës bentose;

7. Vela Pesh- burime sublakustrike, vendi i shumimit të troftës dhe biodiversitetit të faunës bentose;

8. Shën Pjetri- burime bregore dhe sublakustrike, vendi i shumimit të troftës dhe biodiversitetit të faunës bentose;

9. Burimet e Shën Naumit- burimi më i pasur në liqenin e Ohrit, vendi ku shumohet trofta dhe llojit e krapit dhe biodiversiteti i faunës bentose

Lokalitetet me vlera natyrore në rajonin e Ohrit janë të shënuara në hartën me kufij të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit.

*Vlerat e Parkut nacional Galiçica*

Pjesa tokësore e rajonit të Ohrit përfshin më shumë se dy të tretat e Parkut nacional Galiçica apo 18000 ha dhe karakterizohet me diversitet të madh të llojeve, vendbanimeve dhe sistemeve ekologjike.

*Pyjet*

Pyjet në këtë park kanë rëndësi të madhe ekologjike dhe përfshijnë më shumë lloje të vendbanimeve që konsiderohen si të rrezikuara apo të rralla në Evropë gjegjësisht janë të rëndësishme për ruajtjen e më shumë llojeve, që gjithashtu konsiderohen për vlera kyçe.

Sipas EUNIS[31] klasifikimi i llojeve të vendbanimeve nga viti 2004, në park vërehen dhjetë lloje të vendbanimeve (me gjithsej 13 bashkësi bimore) që janë të mbrojtur me Direktivën e BE-së për ruajtjen e vendbanimeve natyrore dhe të faunës e florës të egër. Mes tjerash, për nga domethënia veçohen pyjet nga foja (pyjet peonike me fojë, EUNIS 2004:G3.933) që në park përfshijnë tre bashkësi bimore Pruneto-Celtetum (Em 1989), Biaro tenuifolii-Juniperetum excelsae Em, dhe Querco- Juniperetum excelsae Matevski.

*Vegjetacioni i shkurreve*

Në këtë vërehen dy lloje të vendbanimeve me shkurre që konsiderohen të rrezikuara apo të rralla në Evropë gjegjësisht janë të rëndësishme për ruajtjen e disa llojeve kyçe. Këtu bëjnë pjesë vendbanimet me shkurre bushe (vendbanime me shkurre nga *Buxus sempervirens,* EUNIS 2004: F 3.12) dhe vendbanime me shkurre nga dëllinja e kaltër (vendbanime para- mediteranit me shkurre nga dëllinja e kaltër, EUNIS 2004: F 3.164).

*Kullota*

Në këtë park, sipas klasifikimit të EUNIS nga viti 2004, vërehen katër lloje të këtyre vendbanimeve, me gjithsej tetë bashkësi bimore, që konsiderohen të rrezikuara apo të rralla në Evropë. Mes tyre, kullotat e kodrave (stepet elino- ballkanike me Satureja montana, EUNIS 2004: F 1.21 ) janë më se të rëndësishëm për numrin më të madh të llojeve të orkideve në park. Kullotat kanë edhe vlerë socio- ekonomike për popullatën në park, por edhe më gjerë.

*Vegjetacioni kazmofit dhe vegjetacioni i bregut*

Sipas klasifikimit të EUNIS nga viti 2004, vërehen dy lloje të vegjetacionit kazmofit (EUNIS 2004: H3.2A1 dhe EUNIS 2004: H3.2A11, me katër bashkësi bimore) dhe një lloj i vegjetacionit të bregut (EUNIS 2004: H2.6, një bashkësi bimore) që konsiderohen të rrezikuara apo të rralla në Evropë.

*Vendbanimet ujore*

[31] EUNIS – European nature information system (Sistemi evropian informativ për natyrën).

Për shkak të karakterit gëlqeror të malit, sistemet ujore në park kanë domethënie të madhe ekologjike për numër të madh të llojeve kyç. Mes tyre dallohen dy lloje të vendbanimeve që janë të rralla apo të rrezikuara në Evropë (rrjedha të përkohshme sipërfaqësore- faza e lagësht)- EUNIS 2004: C2.26 dhe vegjetacioni i përrenjve të shpejtë oligotrofe të pasura me gëlqere- EUNIS 2004: C2.5). Krahas tyre, vërejmë të paktën pesë lloje të vendbanimeve ujore që kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen e një numrit të madh të llojeve kyç të jokurrizorëve dhe kurrizorëve dhe. Prej tyre, me rëndësi të veçantë është burimi Shën Naumi, Pellgu i Kuq, pellgje tjera natyrore dhe artificiale si dhe burime tjera malore.

*Shpella*

Karakteri gëlqeror i malit është shkak për pasurinë e formave nëntokësore gjeomorfologjike, si për shembull shpellat që paraqesin vendbanime të rëndësishme për shumë lloje kyçe.

Sipas klasifikimit të EUNIS nga viti 2004, në këtë park vërehen tre lloje të vendbanimeve që janë të rralla apo rrezikohen në Evropë (EUNIS 2004: H1.1, H1.221 dhe H1.231). Nga shpellat, si vendime më të rëndësishme veçohen Meçkina Dupka, Voila, Leskoska Peshtera etj.

Vendbanimet e sipërpërmendura janë shkak që një pjesë e parkut të shpallet si zonë i posaçëm për ruajtje në suazat e Rrjetit natyror evropian NATURA 2000.

*Llojet e rrezikuara globale*

Sipas kritereve të IUCN, në këtë park vërehen më shumë lloje që konsiderohen si globalisht të rrezikuara (status “endangered”) prej të cilave katër lloje të pa- kurrizorëve dhe 13 lloje të kurrizorëve. Në këtë grup mund të shtohen edhe 19 bimë tjera të parkut që numërohen mes lloje të rralla të bimëve globalisht si dhe 15 lloje të kërpudhave me rëndësi globale.

*Popullatë e rëndësishme nga llojet që janë të rralla apo të rrezikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut në Evropë ose globalisht*

Prej algave, shtatë taksone që janë të rralla tek ne dhe në park përfaqësohen me popullatë të rëndësishme. Nga bimët e larta vërehen 56 taksone, që janë të rralla tek ne (deri në 10 vende). Numrit të tyre duhet t’ua shtojmë edhe endemitët lokal. Nga markomicetet, në park vërehen 47 lloje që janë të rralla ose të rrezikuara, jo vetëm tek ne, por edhe në Evropë. Prej tyre 38 kanë domethënie nacionale, 22 domethënie evropiane kurse dhjetë kanë domethënie globale.

Nga jokurrizorët që janë të mbrojtur në Evropë, në këtë park vërejmë 11 lloje, popullata e të cilave është e rëndësishme në nivel nacional. Mes tyre është edhe një lloj, popullata e të cilit në këtë park ka domethënie evropiane. Nga jokurrizorët e rrallë vërehen 15 lloje të rralla që kanë domethënie në nivel nacional. Mes tyre është edhe një lloj, popullata e të cilit në këtë park ka domethënie evropiane. Numrit të tyre duhet t’ua shtojmë edhe endemitët lokal.

Nga kafshët kurrizore që janë të mbrojtura në Evropë, në park vërejmë 77 taksone, popullata e të cilëve ka domethënie në nivel nacional kurse tetë prej tyre kanë domethënie evropiane ose globale. Numrit të tyre duhet t’ua shtojmë edhe dy lloje të zogjve, popullata e të cilëve konsiderohet si e rëndësishme për shkak të karakterit të tyre relikt.

## Shtojca 2: Vlerat kulturore

Sipas parimeve të përgjithshme të Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore, vlera e jashtëzakonshme universale e rajonit kulturor- historik ku bëjnë pjesë tërësitë e simboleve të qyteteve të Ohrit dhe Strugës, qendrat më të rëndësishme shpirtërore, siç janë manastiret Shën Arhangjel Mihail- Shën Naum, Shën Mëria Zahumska, Shën Mëria- Kalishta dhe Shën Gjoni i Bekuar- Kaneo dhe numër i madh të vendbanimeve, qëndron në cilësinë e arkitekturës specifike dhe realizimit të suksesshëm të barazisë mes qyteteve, vendbanimeve dhe rrethinës natyrore të liqenit.

Duke pasur parasysh vlerat e pasura kulturore- historike, arkitektonike, arkeologjike dhe etnologjike, që rajonin i japin veçanti, posaçmëri, përfaqësim, autenticitet, me ruajtjen e tyre, llojllojshmërinë dhe integralitetin, janë krijuar mundësitë që rajoni të jetë e mirë me domethënie të lartë nacionale, me vlerë universale për njerëzimin dhe historia, kultura, arti dhe shkenca e tij.

*Zona kulturore*

Territori i rajonit të Ohrit si trashëgimi botërore paraqet të mirë integrale nga vlerat e trashëguara natyrore dhe kulturore ku llojllojshmëria dhe trashëgimia e pasur arkitektonike ndërthuret me natyrën dhe është e pandashme prej saj. Pikërisht kjo veçori e vendos rajonin e mbrojtur në kategorinë e zonës kulturore ku në mënyrë të pandashme janë të ndërlidhura historia, vazhdimësia e traditave kulturore, vlerave shoqërore dhe përpjekjet me bukurinë iskonike natyrore të rajonit. Vlera e këtij lloji identifikohet sidomos tek manastiri Shën Mëria- Zahumska, kastrumin romak, vendbanimeve e bregut Tërpejc dhe Peshtan, lagja Kaneo mbi të cilën ngritët kisha Shën Gjoni i Bekuar- Kaneo, kompleksi i manastirit Kalishtë, etj.,

*Trashëgimia kulturore*

Vlerat elementare monumentale të rajonit të Ohrit paraqesin përmbledhje të qendrave të mbrojtura historike të qytetit, strukturave urbane natyrore, liqen- breg, qendrave shpirtërore dhe strukturave organike urbane, të pozicionuara afër bregut të liqenit, me mënyrë specifike të jetës dhe lagje rurale, të vendosura në mjedise të ruajtura ekologjike natyrore. Bërthama e definuar urbanistike e qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit, shquhet me lokalitete të shumtë arkeologjike, qendra shpirtërore dhe arkitekturë specifike, karakteristike për këto hapësira (të mbetura nga koha a para- historisë deri në shekullin XIX) si dhe arkitekturë e mbetur nën ndikimin e neoklasicizmit evropian. Në kufijtë e tërësisë së mbrojtur monumentale të qytetit të Ohrit, për të mira monumentale janë shpallur 23 ndërtime sakrale krishtere, 74 objekte profane, shtatë objekte nga arkitektura islame dhe dhjetë lokalitete arkeologjike ndërsa në kufijtë e tërësisë së mbrojtur monumentale të qytetit të Strugës për të mira monumentale janë shpallur 24 objekte profane, tre objekte nga arkitektura islame dhe një objekt sakral nga krishterimi.

*Vlerat kulturore- artistike*

Vlerat kulturore- artistike të të mirave të mbrojtura, me të gjitha atributet e njohura në suazat botërore, përfshijnë:

- Arti figurativ: mozaikë, freska- piktura, ikona, dekorime muri, iluminacione të dorëshkrimeve, grafik, piktura në pëlhurë;
- Skulptura dhe gdhendja: skulptura, plastikë guri, ikonostase, frone për peshkopë dhe punime tjera kishtare, zbukurime të gdhendura prej druri;
- Artet e aplikuara: objekte nga qeramike, qelq, dru, metal, tekstil, lëkurë, letër dhe vepra tjera të zejeve tradicionale artistike;

- Trashëgimia kulturore jomateriale: zakone tradicionale dhe manifestime fetare e kulturore.

*Vlerat urbanistike- arkitektonike*

Në territorin e rajonit të Ohrit janë formuar aglomeracione urbane që krijojnë urbanizëm specifik organik, me formimin e dy qendrave të qytetit, disa lagje bregore, më shumë qendra të rëndësishme shpirtërore, dhe më shumë lagje rurale, të vendosura në masivet e natyrës iskonike, edhe më tej e paprekur nga veprimtaria njerëzore.

Duke i analizuar ndërtimet, duke filluar nga para- historia me ekzistimin e numri të madh të lagjeve nakolike palafite, mbetjet e të cilave janë të dukshme edhe sot në thellësinë e liqenit, përmes antikës e deri më sot, theksohet urbanizmi që nuk është i rregulluar me plane dhe rregulla. Ky është urbanizmi organ, ku qeliza urbane rritet dhe zhvillohet sipas ligjeve rigoroze dhe nevojave njerëzore.

Përkundër kësaj, vendosja e qendrave shpirtërore është kushtëzuar nga vlerat e mëdha të peizazhit natyror, me vizura të papërsëritshme drejt liqenit, duke i shfrytëzuar luginat e pasura të gjelbra të maleve, burimet natyrore, rrëzën e viseve të thepisura shkëmbore dhe misticitetin e hapësirës.

Në kohën më të re, kur urbanizimi në mënyrë agresive sulmoi pjesën e bregut rreth Liqenit të Ohrit, e vetmja e paprekur mbetet projeksioni vertikal i qendrës së vjetër të qytetit të Ohrit, që mbaron me Citadelën në kalanë e Samoilit, në maje të kodrës si dhe muri i ruajtur perimetral me porta të qytetit, ku është ruajtur terreni jo i ndërtuar i pyllëzuar, i cili sipas izokipseve të terrenit, është zhvilluar qendra e qytetit, në mënyrë teatrale duke u lëshuar drejt bregut të liqenit.

Si përfaqësues më të shquar me vlerat arkitektonike- urbanistike veçohen qendrat e vjetra urbane të Ohrit dhe Strugës, manastiri Shën Arhangjeli Mikaili (Shën Naumi) në pjesë jugore të bregut të Ohrit, manastiri Shën Mëria Zahumska-Zaum në f. Tërpejc dhe manastiri Shën Mëria-Kalishta në bregun perëndimor të Liqenit të Ohrit.

*Lagje rurale bregore (Tërpejca, Peshtani, Radozhda dhe Kalishti)*

Fshati Tërpejc gjendet 17 km në jug të qytetit të Ohrit dhe gjendet në rrëzën e malit Galiçicë, në gropë natyrore mes shkëmbinjve në bregun lindor të liqenit të Ohrit, në lartësi mbidetare prej 695-750 metra. Nëpër fshat kalon rruga Ohër- Shën Naum. Ndër shekuj popullata është marrë me peshkatari, si burim elementar për ekzistencë. Rol të veçantë ka pasur edhe blegtoria kurse bujqësia ka qenë e kufizuar në sipërfaqe të vogël përpunuese në fushën e thatë të Tërpejcës. Fshati ka 370 banorë- maqedonas. Në afërsi të fshatit gjendet kisha më e vjetur e ruajtur, Shën Mëria- Zahumska prej shekullit XIV.

12 km në jug të qytetit të Ohrit, në rrëzën e malit Galiçicë, në bregun lindor të liqenit të Ohrit, në lartësi mbidetare prej 966 metra, në rrugën Ohër- Shën Naum, gjendet fshati Peshtani. Ndër shekuj, banorët janë marrë me peshkatari dhe blegtori, por dekadat e fundit janë orientuar në zhvillimin e turizmit, me veprimtari mirë të zhvilluara të shërbimeve siç janë tregtia dhe hotelieria. Kjo ka bërë që shtëpitë e vjetra të fshatit të shndërrohen në objekte moderne bashkëkohore për nevojat e turizmit dhe hotelierisë dhe paraqesin mjedise të revitalizuara rurale.

Fshati Radozhdë paraqet fshat tipik për peshkim dhe gjendet në pjesën e rrafshët të bregut të liqenit, që gradualisht po shndërrohet në lagje rurale turistike, me mundësi ideale për zhvillimin e turizmit fshatar. Fshati gradualisht po shndërrohet në lagje bashkëkohore turistike duke zhvilluar

veprimtarisë si: tregtia, hotelieria dhe turizmi. Mbi fshat gjendet kisha shpellore Arhangjel Mikaili, me pikturë të ruajtur të vlefshme.

Në afërsi të qytetit të Strugës, buzë bregut të liqenit gjendet fshati Kalishtë. Fshati paraqet fshat tipik për peshkim, ku viteve të fundit me të madhe ndërtohen objekte të vogla hotelierike, në këtë mënyrë duke u zhvilluar hotelieria dhe turizmi. Në afërsi të fshatit gjendet manastiri Shën Mëria me tempullin shpellor Lindja e Mërisë. Kisha e manastirit si dhe konakët, janë ndërtuar në kohën më të re dhe janë aktiv sot e kësaj dite.

## Shtojca 3: Vlera tjera:

*Vlerat shoqërore*

